



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve në
“Trombon dhe Mësuesi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të
Lartë**

“Universiteti i Arteve”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.asoc.Mimoza Pajaziti (Drançolli)

Drançolli

2. Prof.as.Tidita Abdurrahmani

Abdurrahmani

Qershor 2023

Drançolli

Për Programin e studimit Master i Arteve në “Trombon dhe Mësuesi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Arteve”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Arteve
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Interpretimit (Fakulteti i Muzikës)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Arteve në “Trombon dhe Mësuesi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 821, datë 26.12.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Programi është riorganizuar nga programi Master i Arteve të Bukura në “Trombon”, licensuar me UMASH Nr. 397, datë 10.08.2011.
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 144, datë 19.09.2018
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikël i Dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë të Plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10 PAE/1 PAK v.a. 2021-2022 7 PAE/2 PAK v.a. 2020-2021 8 PAE/4 PAK v.a. 2019-2020
18	Numri i studentëve:	1 student v.a. 2019 – 2020 1 student v.a. 2020 – 2021 1 student v.a. 2021 – 2022
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës;

Universiteti i Arteve është një institucion publik i arsimit të lartë, i licensuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 234, datë. 23.03.2011.2011. Universitetit të Arteve i është akorduar akreditimi i pare institucional me Urdher Nr. 223, datë 04.06.2013. Universiteti i Arteve është riakredituar nga ASCAL me ane te Vendimit te BA Nr. 17, datë 24.03.2022. Universiteti i Arteve përbëhet nga tre njësi kryesore/fakultete qe janë Fakulteti i Muzikës, Fakulteti i Artit Skenik dhe Fakulteti i Arteve të Bukura. Programi i Studimit Master i Arteve në "Trombon dhe Mësuesi" ofrohet nga Departamenti i Interpretimit, Fakulteti i Muzikës të Universitetit të Arteve. Programi i Studimit Master i Arteve në "Trombon dhe Mësuesi" është licensuar nga UMASR Nr. 821, datë 26.12.2018. Programi është riorganizuar nga programi Master i Arteve të Bukura në "Trombon", licensuar me UMASH Nr. 397, datë 10.08.2011.

Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Interpretimit, njësi përbërëse e Fakultetit të Muzikës. Programi i studimit Master i Arteve në "Trombon dhe Mësuesi" ofrohet me kohë të plotë në gjuhën shqipe, me kohëzgjatje 2 vite akademike të ndara në 4 semestra dhe është organizuar në bazë të sistemit European të transferimit të krediteve në 120 kredite ECTS. Çdo vit akademik përmban 60 kredite të ndara nga 30 kredite në semestër. Universiteti i Arteve është i vetmi institucion i arsimit të lartë më profil artistik në Republikën e Shqipërisë dhe misioni i tij përfshin ofrimin e arsimit të lartë profesional dhe veprimtarisë interprete në fushën e artit dhe të kulturës, zhvillimin dhe mbrojtjen e dijes nëpërmjet mësimdhënies dhe veprimtarisë artistike dhe formimin e studjuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit të artit dhe kulturës, kryerjen e studimeve artistike-kërkimore-shkencore etj. Programi i studimit ka në filozofinë e punës studentin në qendër që do të thotë që gjithçka ndodh në departament që nga procesi mësimor, shërbimet aktivitetet etj. Kjo bëhet e mundur nëpërmjet një stafi dinamik të zgjedhur dhe të përkushtuar i cili ndërthur teorinë me praktikën me trajnimin e vazhdueshëm dhe që mundësojnë organizimin së bashku me studentët të veprimtarive të larmishme mësimore, artistike dhe shkencore. Universiteti i Arteve ka aplikuar në ASCAL për akreditimin e programit të studimit Master i Arteve në "Trombon dhe Mësuesi" me shkresë 11.02.2022 (Shkresë e IAL Nr. 146 Prot -regjistruar në protokollin e Ascal nr. 85 Prot. Dt. 11.02. 2022.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Burimi parësor i informacionit për GVJ-ne ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i përgatitur në periudhën Shkurt-Shtator 2022. Ky raport siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur UART për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. UART, po ashtu, nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL, vuri në dispozicion të vlerësuesve një numër evidencash mbështetëse. Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashikuara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr.531, datë 11.9.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr. 370, VKM Nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin e MASR Nr. 1, datë 14.1.2020, për “Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë”, Udhëzimin e MASR Nr. 22, datë 3.9.2020, Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr. 1, datë 14.1.2020, “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e Institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë” si dhe gjithë aktet e tjera nënligjore që kanë të bëjnë me organizimin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) e nisi punën që në dhjetor të vitit 2022, në komunikim të përbashkët për përcaktimin e detyrave kryesore që do të realizoheshin gjatë procesit të vlerësimit. Në bashkërendim midis dy ekspertëve të jashtëm të vlerësimit dhe stafit të ASCAL u përcaktuan edhe datat e vizitave. Vizitat u realizuan dy ditë konkretisht me datat 14 dhe 15 dhjetor 2022.

GVJ u njoh me të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni në proces akreditimi përmes platformës dhe kredencialet që secili nga vlerësuesit e jashtëm ka në www.ascal.al

Gjatë dy ditëve të takimeve Grupi i vlerësimit të Jashtëm i përbërë nga Prof.asoc. Mimoza Pajaziti-Drançolli dhe Prof.as.Dr.Tidita Abdurrahmani zhvilluan takime sipas programit të miratuar paraprakisht nga ASCAL. Takimet konsistuan në zhvillimin e diskutimeve me Dekanin e Fakultetit të Muzikës dhe Përgjegjës të Departamentit të Trombons, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik, studentët, përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (më saktë Komisionit Ad Hoc të Sigurimit të Cilësisë), përfaqësues të Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, përfaqësues të Drejtorisë së Menaxhimit dhe Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Sektorit të Projekteve Artistike dhe Shkencore . Gjithashtu u zhvillua edhe një vizitë e auditorëve, laboratorëve, sallat e lektoriumeve,salla e digjitalizuar dhe salla e ndëgjimit e pajisur me kompjuter.Për shkak të punimeve të restaurimit të hapësirave në përgjithësi nuk ishte e mundur të vizitohen sallat e koncerteve.

Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve, vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet shtesë që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura.

GVJ gjatë takimeve me grupet e caktuara u fokusua në bashkëbisedime konkrete për tema të caktuara si mekanizmi dhe fuqizimi i Njësisë për sigurimin e brendshëm të cilësisë, procesimin e mëtejshëm të pyetësorëve, për aktivitetet koncertale të stafit dhe studentëve, për projektet ndërkombëtare të fituara, për planin mësimor, kualifikimin e stafit etj.

Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve, vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet shtesë që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura.

Gjatë gjithë këtij procesi vlerësimi ka pasur një bashkëpunim shumë korrekt dhe mirëkuptues midis grupit të vlerësimit të jashtëm dhe stafit të UART. Koordinator teknik dhe shumë bashkëpunues me GVJ nga ASCAL në këtë vlerësim ka qenë Msc. Arjana Alija.

Më datë 29.03.2023, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 52/23 Prot, Datë 29.03.203, dërgohet në Institucion Draft-Raporti i Vlersimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 338/6 Prot, Datë 24.04.2023.

KOMENTET MBI DRAFT-RAPORTIN PËR PROGRAMIN MASTER I ARTEVE NË TROMBON DHE MËSUESI

GVJ pasi u njoh me komentet e Institucionit mbi Draft- Raportin, sqaron si vijon:

GVJ në FUSHA I – Standardi I.3 – Kriteri 2

Komente fillestare GVJ

Si evidencë të marrëveshjeve janë sjellë marrëveshjet e UART në kuadër të Erasmus +, por nuk janë sjellë si evidenca marrëveshjet konkrete të firmosura dhe të protokolluara nga palët pjesëmarrëse dhe përfituese

Komente nga GVB

Marrëveshjet e bashkëpunimit ndërinstytucional realizohen në rang universiteti dhe kanë të detajuara periudhën e vlefshmërisë dhe numrat e mobilitetev. Në periudhën e marrë në analizë nga grupi i vlerësimit të jashtëm nuk ka pasur realisht asnjë student të programit të studimit Master i Arteve në Trombon dhe Mësuesi që të ketë realizuar mobilitet brenda këtyre marrëveshjeve. GVB gjithashtu ka dhënë një listë të marrëveshjeve ndërinstytucionale

Komente nga GVJ- Për sa më sipër, vlerësohet shpjegimi i GVB në lidhje me numrin e marrëveshjeve institucionale të lidhura dhe raportimi në lidhje me faktin që asnjë mobilitet nuk është kryer gjatë kësaj periudhe

Komenti merret parasysht nga GVJ dhe reflektohet edhe në raport

GVJ në FUSHA I – Standardi I.3 – Kriteri 4

Komente fillestare GVJ

Në relatinin mbi përmbushjen e këtij kriteri nga GVB nuk është qartësuar në çfarë mënyrë njësia përgjegjëse për programin harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit

Komente nga GVB

Departamenti i interpretimit në mënyrë periodike harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit duke u bazuar në të dhënat e grumbulluara që nga fillimi i zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërinstytucional. Aktualisht nga viti akademik 2018-2019 sipas raportit analitik nuk është aprovuar asnjë mobilitet për studentët e programit Master në Trombon dhe Mësuesi. Nuk ka pasur realisht asnjë student që të ketë realizuar një mobilitet brenda këtyre marrëveshjeve. Kështu që numri i kampionit për t'u analizuar është i pamjaftueshëm për të arritur në përfundime domethënëse.

Komente nga GVJ- Për sa më sipër, vlerësohet shpjegimi i GVB në lidhje me mungesën e raporteve analitike por duhet pasur parasysht që në të ardhmen kur numri i mobiliteteve të mundshme të jetë edhe më i lartë, institucioni dhe departamenti duhet të zhvillojë një kulturë sistematike hartimi dhe procesimi të dhënash analitike në lidhje me mobilitetet.

Komenti merret parasysht nga GVJ dhe reflektohet edhe në raport

GVJ në FUSHA II – Standardi II.4 – Kriteri 5 - Fq.31:



Megjithatë nga kontrolli i syllabuseve u konstatua që jo të gjitha syllabuset janë të përditësuara sipas formatit të parashikuar në këtë VKM. Syllabuset në përgjithësi janë të përditësuara sipas kërkesave të tregut të punës po ashtu edhe literaturë bazë është e përditësuar. Konstatohet se nuk ka mjaftueshëm literaturë shqiptare në veçanti vepra solistike për instrumentin.

Komente nga GVB: Duke vlerësuar dhe mirëkuptuar gjetjen e GVJ vlerësojmë se Grupi Mësimor I Instrumenteve të Frymës, ku bënë pjesë instrumenti i Trombës, do të punojë me personelin akademik të kompozicionit dhe të tjerë, duke i nxitur vepra të reja si dhe transkriptime të veprave ekzistuese.

Theksojmë se po punohet sistematikisht nga Institucioni ynë që Biblioteka e UART të pasurohet Akoma më shumë me vepra të kompozitorëve shqiptare.

Komente nga GVJ- Për sa më sipër, vlerësohet angazhimi i Institucionit për iniciativa të tilla dhe pasurim të Bibliotekës me sa më shumë vepra të kompozitorëve shqiptarë.

Komenti merret parasysh nga GVJ.

GVJ në FUSHA II – Standardi II.5 – Kriteri 1 - Fq.32:

Gjatë vizitës në institucion GVJ ka sygjerruar që në grupin punues për hartimin e përmbajtjes së programit të ketë një anëtar nga tregu i punës ose anëtar nga institucionet partnere Rekomandohet të ketë e kontakt më të shpeshtë dhe të sigurt me institucionet partnere për treg pune.

Komente nga GVB: Duke vlerësuar dhe mirëkuptuar gjetjen e GVJ theksojmë se në hartimin e programit është marrë edhe mendimi edhe kontributi nga anëtarnga tregu I punës ose anëtar nga institucionet partnere (Reinold Foci-Trombist pranë Orkestrës së Radiotelevizionit Shqiptar) njëkohësisht edhe ALUMNI I vetë Fakultetit të Muzikës, I cili ka kontribuar edhe si pedagog I ftuar.

Komente nga GVJ- Për sa më sipër, vlerësohet angazhimi i studentëve Alumni për të kontribuar në zhvillimin e programeve dhe shpreson me më shumë angazhime gjatë hartimit të programeve studimore.

Komenti merret parasysh nga GVJ.

GVJ në FUSHA II – Standardi II.5 – Kriteri 2 - Fq.33:

Krahas formularit nuk ka ndonjë mënyrë të mirëfilltë për të marrë të dhënat personale. Pedagogët ndihmojnë në përditësimin e të dhënave personale për ALUMNI. Kjo realizohet falë natyrës së punës individuale që kanë me studentë.

Mendimi i studentëve rreth programit të mësimit realizohet nëpërmjet pyetësorit në fund të vitit mësimor.

Rekomandohet databaza ALUMNI të ketë të dhëna më të detajuara rreth studentëve të diplomuar dhe të përditësohen. GVJ gjatë takimit me zyrën Alumni sugjeron të ketë më tepër angazhim për student alumni në përfshirjen e tyre në aktivitetet që organizohen nga Fakulteti.

Komente nga GVB: Duke vlerësuar dhe mirëkuptuar gjetjen e GVJ bëjmë me dije se databaza ALUMNI ashtu siç u sqarua edhe gjatë vizitës së GVJ në Institucion, është në përditësim të përhershëm dhe të dhënat janë të detajuara rreth studentëve të diplomuar, falë edhe projektit

Erasmus-CBHE-GRADUA. Vlen të theksohet se numri i studentëve të diplomuar, për shkak të specifikës së instrumentit, është shumë i kufizuar. Theksojmë se një përqindje shumë e lartë e të diplomuarve në këtë program studimi janë tashmë të punësuar në këtë profesion.

Komente nga GVJ- *Për sa më sipër, vlerësohet angazhimi i Institucionit se databaza ALUMNI është në përditësim të përhershëm.*

Komenti merret parasysh nga GVJ.

GVJ në FUSHA II – Standardi II.5 – Konkluzionet e standardit- Fq.33:

Konstatohet që Njësia Bazë Departamenti i Interpretimit është përgjegjëse për përditësimin dhe përshtatjen e programit. Realizohet me propozimet e marra nga pedagogët dhe studentët. Studentët plotësojnë pyetësor për programin mësimor në fundvit akademik. Rekomandohet të ketë kontakt më të sigurtë me institucionet partnere për treg pune si dhe databaza ALUMNI të ketë të dhëna më të detajuara rreth studentëve të diplomuar. Ky standard përmbushet kryesisht.

Komente nga GVB: *Periudha e marrë në shqyrtim për arsye të akreditimit, që korrespondon edhe me riorganizimin e programeve të studimit pranë Fakultetit të Muzikës është ajo e 3 viteve të fundit (2019-2020, 2020-2021, 2021-2022).*

Procesi i përditësimit dhe i përshtatjes së programit, ka nevojë për një cikël të arsyeshëm kohor, pasi ndryshimi i përvitshëm do të sillte konfuzion, jo vetëm te studentët aktualë, por edhe tek ata që do të donin të studionin pranë Institucionit tone dhe për rrjedhojë edhe në programin e studimit Master në Trombon dhe Mësuesi do të ishte i panatyrshëm, pasi ky program studimi nuk është i lidhur me zhvillime teknologjike apo transformime digjitale.

Bazuar në përgjigjen që GVB ka dhënë për gjetjet dhe rekomandimet në standardin II.5, kërkojmë mirëkuptimin tuaj në rishikimin dhe plotësimin në 'plotësisht' të standardit.

Komente nga GVJ- *Për sa më sipër, vlerësohet angazhimi i Institucionit dhe mirëkupton se nevojitet kohë për zhvillime teknologjike dhe transformime digjitale.*

Komenti merret parasysh dhe GVJ ndryshon vlerësimin.

GVJ në FUSHA II – Standardi II.6 – Kriteri 4 - Fq.35:

Rekomandohet të ketë përkrahje më tepër në realizimin e punimeve kërkimore dhe mbështetje për pjesëmarrje të stafit akademik në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.

Komente nga GVB- *Duke vlerësuar dhe mirëkuptuar gjetjen e GVJ shprehim dakordësinë me sugjerimin tuaj dhe po e adresojmë.*

Komente nga GVJ- *Për sa më sipër, vlerësohet angazhimi për adresimin e çështjes së përkrahje më të madhe për stafin akademik.*

Komenti merret parasysh nga GVJ.

GVJ në FUSHA II – Standardi II.7 – Kriteri 1 - Fq.36:

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

GVJ sugjeron të fuqizohen më tepër aktivitetet e përbashkëta të bashkëpunimit me Universitetet/Fakultetet e Arteve shqipfolëse në Rajon.

Komente nga GVB- Duke vlerësuar dhe mirëkuptuar gjetjen e GVJ shprehem se aktivitetet e përbashkëta të bashkëpunimit me Universitetet/Fakultetet e Arteve shqipfolëse në Rajon nuk kanë munguar.

-Edicionet e përvitshme të Ura me tri harqe mes UART, Fakulteti I Arteve-Universiteti Shtetëror I Tetovës dhe Fakulteti I Arteve -Universiteti I Prishtinës, për të cilën kemi folur gjatë vizitës së GVJ në Institucionin tone apo

-aktivitete te tjera të orkestrës simfonike të UART në Universitetin e Pejës, Dëshmojnë për një vëmendje të Universitetit të Arteve kundrejt institucioneve homologe shqipfolëse në Rajon.

Besojmë që para këtyre fakteve, GVJ të mund të regjistrojë të dhëna pozitive në raport me sugjerimin e dërguar.

Komente nga GVJ- Për sa më sipër, vlerësohen faktet se UART ka vëmendje në bashkëpunime për aktivitete të ndryshme me Institucionet homologe shqipfolëse në Rajon dhe uron se ato aktivitete do të intensifikohen edhe më shumë.

Komenti merret parasysh nga GVJ.

GVJ në FUSHA III – Standardi III.1 – Kriteri 3- Fq.40.

GVJ sugjeron që të ketë më tepër trajnime pedagogjike për metodologjinë e avancuar të mësimdhënies.

Komente nga GVB- Duke vlerësuar dhe mirëkuptuar gjetjen e GVJ theksojmë se pjesa e mësuesisë mbulohet nga I njëjti staf akademik për të gjitha programet e studimit në UART.

Kësisoj në bashkëpunim me të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë (në total 32 programe) do të shikojmë mundësinë për më tepër trajnime.

Komente nga GVJ- Për sa më sipër, vlerësohet angazhimi i Institucionit për të zhvilluar më tepër trajnime për metodologjinë e avancuar të mësimdhënies.

Komenti merret parasysh nga GVJ.

GVJ në FUSHA III – Standardi III.3 – Kriteri 5 - Fq.44-

GVJ sugjeron që ky sistem antiplagjiat të rifunksionalizohet.

Komente nga GVB- Duke vlerësuar dhe mirëkuptuar gjetjen e GVJ theksojmë se për vetë specifikën e programit të studimit Master në Trombon dhe Mësuesi I cili në lëndët me interpretim muzikor në kohë reale I realizon provimet me lojë live, para komisionit të provimit apo diplomës, me presence publiku (pra, jo me dyer të mbyllura) pamundësohet objektivisht dukuria e kopjes apo plagjiaturës në provime dhe detyra.

Në lidhje me punimin teorik të tezës së diplomës, duhet nënvizuar fakti që ai është një material analize formës muzikore, specifikave të kompozitorit, idesë kompozicionale dhe elementeve

stilistikor [dhe estetikë mbi veprën e përzgjedhur për t'u interpretuar live gjatë provimit të diplomës, I cili zbërthen dhe ndërton logjikën dhe etapat interpretative në tërë kohëzgjatjen e saj. Jemi në fazën përfundimtare të detajimeve të Marrëveshjesë për rivendosjen e sistemit antiplagjiaturës me Platforma Akademia SH.P.K /CrossplagL.L.C.

Komente nga GVJ- Për sa më sipër, vlerësohet angazhimi i Institucionit për të rivendosjen e sistemit antiplagjiaturë në Platformë.

Komenti merret parasysh nga GVJ.

GVJ në FUSHA III – Standardi III. 4– Kriteri 4 - Fq.48-

Tek Plani mësimor nuk është i qartë fondi I orëve 2.5 orë në javë për lëndët Metodologji e mësimdhënies dhe Teoritë e të nxënit dhe Menaxhim klase dhe fondi i orëve 1,1 tek lënda Histori muzike (gjysma e dytë e shek. XX).

GVJ sugjeron të ketë fond të orëve të plota tek këto lëndë.

Komente nga GVB- Duke vlerësuar dhe mirëkuptuar gjetjen e GVJ shprehemi se ky fond është I njëjtë për të gjitha programet e studimit në UART, plani mësimor është vlerësuar nga një grup ekspertësh të vlerësimit në vitin 2018 kur u riorganizuan dhe nuk u konstatua një gjë e tillë. Lutemi merreni parasysh këtë fakt duke hequr sygjërimin.

Komente nga GVJ- Për sa më sipër vlerëson mendimin e ekspertëve për hartimin e programit por është shumë e paqartë se si studenti mban 2 ore e gjysëm ligjërata,

GVJ nuk ndryshon vlerësimin aktual.

GVJ në FUSHA III – Standardi III. 4– Kriteri 6 - Fq.48-

Gjatë vizitës GVJ sugjeron të institucioni të nxitë personelin akademik interpret/kompozitorët të krijojnë vepra solistike për instrumente enkas për programin e studimit.

Komente nga GVB- Duke vlerësuar dhe mirëkuptuar gjetjen e GVJ vlerësojmë se Katedra e Tunxhit do të punojë me personelin akademik të kompozicionit dhe të tjerë, duke i nxitur të krijojnë vepra të reja solistike dhe transkriptime të veprave ekzistuese.

Komente nga GVJ- Për sa më sipër, vlerësohet angazhimi i Institucionit se do te punojë me personelin akademik të kompozicionit dhe te tjerë, duke i nxitur të krijojnë vepra të reja.

Komenti merret parasysh nga GVJ.

GVJ në FUSHA III – Standardi III.4 – Konkluzionet e standardit - Fq.48:

Konstatojmë se programi i studimit Master i Arteve “Trombon dhe Mësuesi” garanton rritjen e aftësive interpretative e hulumtuese tek studentët dhe synon zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek studentët.

Tek Plani mësimor nuk është i qartë fondi I orëve 2.5 orë në javë për lëndët Metodologji e mësimdhënies dhe Teoritë e të nxëniet dhe menaxhim klase dhe fondi i orëve 1,1 tek lënda Histori muzike (gjysma e dytë e shek. XX).

GVJ sugjeron të ketë fond të orëve të plota tek këto lëndë.

Gjatë vizitës GVJ sugjeron të institucioni të nxitë personelin akademik interpret/kompozitorët të krijojnë vepra solistike për instrumente enkas për programin e studimit.

Ky standard përmbushet kryesisht

Komente nga GVB: Duke vlerësuar dhe mirëkuptuar gjetjen e GVJ nisur nga përgjigjet e dhëna sa më lartë, kërkohet mirëkuptimin tuaj për plotësimin Plotësisht të standardit.

Komente nga GVJ- Për sa më sipër, vlerësohet angazhimi i Institucionit për kriteret e mësipërme por ende është i paqartë fondi i orëve 2.5 orë në javë në lëndët e lartëpërmendura andaj komenti merret parasysht për të ardhmen por GVJ nuk ndryshon vlerësimin aktual përderisa mbetet i pambështetur me dokumentacion në këtë rast me përmirësimin e fondit të orëve.

GVJ nuk ndryshon vlerësimin aktual.

GVJ në FUSHA IV – Standardi IV.3 - Kriteri 1 - Fq.59:

GVJ sugjeron që në të ardhmen Biblioteka të pasurohet edhe më tepër me literaturë të kompozitorëve shqipëtar.

Komente nga GVB: Duke vlerësuar dhe mirëkuptuar gjetjen e GVJ siç jemi shprehur edhe më sipër, theksojmë se po punohet sistematikisht nga Institucioni ynë që Biblioteka e UART të pasurohet akoma më shumë me vepra të kompozitorëve shqipëtarë.

Komente nga GVJ- Për sa më sipër, vlerësohet angazhimi i Institucionit se do të punojë për pasurimin e Bibliotekës me vepra të kompozitorëve shqiptarë.

Komenti merret parasysht nga GVJ.

GVJ në FUSHA IV – Standardi IV.5 - Kriteri 1 - Fq.67:

Departamenti i interpretimit ku edhe ofrohet program Master i Arteve në Trombon dhe Mësuesi ka një plan për mbështetje financiare dhe raport financiar të kostos së njësisë.

GVJ gjatë vizitës ka sugjeruar se duhet të ketë mbështetje më të madhe financiare për veprimtari dhe aktivitete artistike sidomos për aktivitete ndërkombëtare.

Komente nga GVB- Duke vlerësuar dhe mirëkuptuar gjetjen e GVJ shprehim dakordësinë me sugjerimin tuaj dhe po e adresojmë.

Komente nga GVJ- Për sa më sipër, vlerësohet angazhimi për adresimin e çështjes së përkrahje më të madhe për aktivitetet ndërkombëtare.

Komenti merret parasysht nga GVJ.

GVJ në FUSHA IV – Standardi IV.5 - Kriteri 3 - Fq.67:

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43428

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Këto tri vitet e fundit Institucioni nuk iu ka nënshtuar ndonjë auditimi periodik mbi vlerësimin e gjendjes financiare. Konstatuam që, UART, nuk I është nënshtuar një auditimi financiar, për shkak se disponon një procedurë të posaçme për realizimin e Auditit të brendshëm, siç parashikon VKM Nr. 83, Datë 03.02.2016 "Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin financiar".

Komente nga GVB- Duke vlerësuar dhe mirëkuptuar gjetjen e GVJ konfirmojmë që Universiteti mund të auditohet periodikisht sipas akteve ligjore në fuqi nga Institucione eprorë dhe të specializuara dhe që janë pikërisht këto institucione eprorë dhe të specializuara që përcaktojnë kohën dhe modalitetet e auditimit.

Me fjalë të tjera, iniciativa për të nisur auditimin për Universitetin e Arteve i takon VETËM institucioneve eprorë dhe të specializuara sipas akteve ligjore.

Komente nga GVJ- për sa më sipër GVJ mirëkupton se auditimi nuk është proces që varet nga Institucioni dhe në kriter e ka paraqitur vetëm si gjetje por jo si rekomandim apo sugjerim.

Komenti merret parasysh nga GVJ.

GVJ në FUSHA V– Standardi V.4– Kriteri 5

Konstatime fillestare GVJ

Raporti vjetor i punës artistike, mësimore dhe shkencore i stafit akademik të departamentit të Interpretimit si shembull i sjellë nuk jep të dhëna analitike në lidhje me cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve dhe aq më pak në lidhje me punësimin e tyre. Në asnjërin prej dokumenteve nuk jepen një plan masash me synim shtimin e studentëve apo rritjen e cilësisë apo të performancës së studentëve,

Komente nga GVB

Numrat e kufizuar të studentëve dhe kampionit i marrë për analizë nuk mundësojnë nxjerrjen e rezultateve domethënëse për shkak të numrit të reduktuar. Në lidhje me punësimin e tyre mund të demonstronhet me krenari se jo vetëm të diplomuarit por edhe dy diplomantë kanë filluar punë në orkestrën filharmonike të Forcave të Armatosura të Shqipërisë

Komente nga GVJ- Për sa më sipër, vlerësohet shpjegimi i GVB por GVJ gjykon dhe vlerëson që raportet vjetore të njësive bazë përkundrazi për shkak të pasjes së një numri të kufizuar studentësh kanë më shumë hapësira për të dhënë të dhëna të detajuara mbi cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje, performancën e tyre dhe punësimin. Dhënia e të dhënave analitike nuk ka të bëjë me pasjen e një kampioni të mjaftueshëm, këtu nuk po aplikohen pyetësorë apo studim, kërkohet dhënia e të dhënave analitike individuale për studentët.

Komenti nuk merret parasysh nga GVJ

GVJ në FUSHA V– Standardi V.4– Konkluzionet e standardit

Konstatime fillestare GVJ

Standardi përmbushet kryesisht

Komente nga GVB

Rishikim i vlerësimit nga kryesisht në plotësisht. Standardi përmbushet plotësisht

Komente nga GVJ

Vlerësimi nuk ndryshon standardi përmbushet kryesisht

GVJ në FUSHA V– Standardi V.5– Kriteri 3

Konstatime fillestare GVJ

Mungojnë evidenca në lidhje me përfshirjen e studentëve në mbledhje të departamentit. Të pyetur nga anetaret e GVJ studentët nuk pohojnë të kenë qenë të pranishëm në mbledhje të njësisë bazë. Mungojnë evidenca të përfshirjeve studentore në grupe fokusimi. Gjatë vizitës në institucion qartësohet se grupet e fokusimit organizohen në mënyrë informale ku pedagogu i speciales njëkohësisht edhe këshillues akademik i studentit përmes diskutimeve të lira vjel mendimet e studentëve në lidhje me çështje të caktuara që kanë të bëjnë me programin e studimit

Komente nga GVB

Nisur nga specifika e programit të studimit dhe vetë numrat e studentëve, siç e kemi shpjeguar edhe gjatë vizitës në institucioni. marrëdhënia e pedagogut me studentët është kryesisht individuale në auditor por edhe në ansamblet, orkestrat profesioniste apo gjysëm profesioniste brenda dhe jashtë shkollës ku orientimi, këshillimi dhe informacioni i jepet studentëve në kohë reale nga studentët tek pedagogët dhe tek përgjegjësat e grupeve dhe departamenti. Pas shqyrtimit të pyetësorëve nuk ka rezultuar të ketë pasur sugjerime për hartimin, rishikimin apo përmirësimin e programit të studimit. Si rrjedhojë krijimi i grupeve të fokusimit do të ishte pa bazë reale.

Komente nga GVJ- Për sa më sipër, vlerësohet shpjegimi i GVB por GVJ gjykon dhe vlerëson që rezultatet e pyetësorit DVV. Evid. II.5.2.1. të sjella si evidencë japin të dhëna në lidhje me kënaqësinë e studentëve për programet e studimit dhe mësimdhënien e infrastrukturën në nivel fakulteti në të dy ciklet e studimit. Të dhënat e përpunuara nga pyetësor dëshmojnë që ka studentë të pakënaqur apo mesatarisht të kënaqur, të cilët nuk është e lehtë të identifikohen kujt njësia dhe cilit program studimi i përkasin. Departamenti i Interpretimit vetë duhet të sigurojë mënyra për të marrë feedback formal të qenësishëm dhe të vlefshëm nga studentët në mënyrë që të marrë masa në vijim për përmirësimin e programit të studimit, të mësimdhënies apo të infrastrukturës aty ku është e nevojshme. Komunikimi informal me studentët dhe pyetësorët në nivel fakulteti nuk zëvendësojnë funksionin e organizimit të fokus grupeve.

Komenti nuk merret parasysh nga GVJ

GVJ në FUSHA V– Standardi V.5– Konkluzionet


Konstatime fillestare GVJ

Të pyetur rreth pjesëmarrjes së tyre aktive në përmirësimin e një program studimi studentët pranojnë të jenë anëtarë të organeve kolegjiale por jo pjesëmarrës aktivë, studentët nuk dinë të japin raste konkrete kur janë pyetur nga departamenti në lidhje me programin e studimit.

Komente nga GVB

Pëmes plotësimin të pyetësorëve dhe përgjigjes së tyre rreth programeve të studimit studentët janë faktikisht aktivë në proces

Komente nga GVJ- Për sa më sipër, vlerësohet shpjegimi i GVB por GVJ gjykon dhe vlerëson që përpunimi rezultateve të pyetësorit dëshmon që ka studentë të pakënaqur me programin e studimit dhe me mësimdhënien dhe nuk ka asnjë ndërhyrje të zyrtarizuar formale për ta përmirësuar atë. Pyetësorët përpunohen në nivel fakulteti. Është e nevojshme marrja e mendimit të studentëve për



program studimi në nivel njësie bazë. Pyetësorët dhe përpunimi i tyre nuk zëvendësojnë as fokus grupet dhe as pjesëmarrjen reale të studentëve në mbledhje të njëjësive bazë.

Komenti nuk merret parasysh nga GVJ

GVJ në FUSHA VI– Standardi VI.I– kriteri 1

Konstatime fillestare GVJ

Institucioni nuk disponon një udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Institucioni ka hartuar gjatë pandemisë vetëm një udhëzues institucional mbi përdorimin efektiv të Microsoft Teams

Komente nga GVB

Për specifikën e programit të studimit dhe të lëndëve të interpretimit individual apo në grup është atribut i pedagogut të lëndës që të krijojë për secilin student trombist apo grup ku bën pjesë instrumenti i Trombons një metodë të personalizuar dhe inovative të mësimdhënies pasi nuk mund të aplikohet në mënyrë të unifikuar tek të gjithë studentët trombistë

Komente nga GVJ-

Për sa më sipër GVJ mirëkupton se hartimi i një udhëzuesi mësimdhënieje inovative në kushtet e një diversiteti individual të theksuar të artistëve përsa i përket aspektit stilistikor, të estetikës muzikore për secilin individ student, karakteristikave të tyre psiko-motore, bagazhit kulturor të krijuar dhe ndjeshmërisë muzikore individuale nuk është i mundshëm dhe i zbatueshëm në mënyrë të unifikuar.

Komenti merret parasysh nga GVJ dhe reflektohet në raport

GVJ në FUSHA VI– Standardi VI.I– kriteri 3

Konstatime fillestare GVJ

Përfshirja e studentëve në vlerësimet periodike të programeve të studimit nuk dokumentohet apo evidentohet me anë të procesverbaleve të mbledhjeve apo procesverbaleve të organizimit të fokus grupeve.

Komente nga GVB

Studentët shprehen përmes pyetësorëve. Po ashtu për çështjet e konsideruara të rëndësishme dhe që i interesojnë departamenteve të fakultetit të Muzikës. Mbledhjes organizohen në rang fakulteti pasi problematikat janë transversalisht të njëjta.

GVJ në FUSHA VI– Standardi VI.I– kriteri 4

Konstatime fillestare GVJ

Në faqen e sitit të internetit të UART nuk bëhen publike rezultatet e monitorimit të cilësisë së programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve të vjela kryesisht përmes pyetësorëve

Komente nga GVB

Rezultatet e pyetësorëve janë për përdorim të brendshëm. Me to njihet rektori i UART dhe Zv Rektori për anën mësimore. Rastet specifike adresohen në fakultetin përkatës

Komente nga GVJ

Duhet respektuar parimi i transparencës në arsimin e lartë dhe të bëhen publike ato të dhëna të pyetësorëve që nuk kanë përmbajtje sensitive apo në respekt të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Komenti nuk merret parasysh nga GVJ

GVJ në FUSHA VI– Standardi VI.I– Konkluzionet

Konstatime fillestare GVJ

Institucioni nuk disponon një udhëzues në nivel institucional për zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies, mungojnë evidenca organizimi fokus grupe apo procesverbale mbledhje departamenti me pjesëmarrje të studentëve. Standardi përmbushet kryesisht

Komente nga GVB

Nuk është e mundur unifikimi i udhëzimeve metodologjike për studentët e arteve përmes një udhëzuesi të vetëm, vjelja e mendimeve të studentëve mbi programin e studimit bëhet kryesisht përmes pyetësorëve.

Komente nga GVJ- Për sa më sipër, vlerësohet shpjegimi i GVB por GVJ gjykon dhe vlerëson që është e nevojshme vjelja e mendimeve individuale të studentëve me bazë njësie dhe programi studimi bazuar në fokus grupe apo takime diskutime tryeza të rrumbullakëta

Komenti nuk merret parasysh nga GVJ

GVJ në FUSHA VI– Standardi VI.2– Kriteri 1

Konstatime fillestare GVJ

Institucioni nuk ka një njësi të përhershme sigurimi cilësie, funksionet e kësaj njësie kryhen nga një komision i përkohshëm. Nuk janë sjellë evidenca për ekzistencën e komisioneve të tjera të përhershme

Komente nga GVB

Komisioni ad hoc i cili ruan rolin e njësisë së sigurimit të cilësisë ka në përbërjen e tij 8 anëtarë 2 zv rektorët, tre përgj. e departamenteve, përfaqësues të çdo fakulteti si dhe sektori mësimor dhe i kurrikulës. Me këtë përbërje komisioni ka mbuluar më së miri sigurimin e cilësisë. Po punohet për ngritjen e komisionit të përhershëm të sigurimit të cilësisë. **Komente nga GVJ-** Për sa më sipër, vlerësohet shpjegimi i GVB por GVJ gjykon dhe vlerëson mbi gjendjen aktuale të strukturave në momentin e depozitimit të DVV dhe në momentin e vizitës në institucion. Një strukturë e përhershme e tillë mungon bazuar në konstatimet e GVJ.

Komenti nuk merret parasysh nga GVJ

GVJ në FUSHA VI– Standardi VI.2– Kriteri 4

Konstatime fillestare GVJ


Në evidencat e vëna në dispozicion në kuadër të VJ nuk është përfshirë një praktikë e qartë ku evidentohet procedura e marrjes në konsideratë të mendimeve të aktorëve të jashtëm në lidhje me cilësinë e programit.

Komente nga GVB

Praktika që ndiqet për ndryshime dhe përmirësime të programeve të studimit në funksion të rritjes së cilësisë në institucion lidhet me promovimin nxitës për arritje më të mira përsa i përket aspekteve të origjinaliteti, kreativitetit dhe bagazhit kulturor e shpirtëror të studentëve interpretë të programeve të studimit master. >Sigurisht që këto praktika e procedura në një institucion me status të veçantë mund dhe duhet të jenë të ndryshme nga universitete me numra masive studentësh ku cilësia e programeve matet nga analiza e dokumentacionit të prodhuar.

Komente nga GVJ- Për sa më sipër, vlerësohet shpjegimi i GVB por GVJ gjykon dhe vlerëson që si universitete me status të veçantë si UART ashtu edhe universitete të tjera me një numër masiv studentësh duhet të aplikojnë forma të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta të marrjes së mendimit të studentëve mbi cilësinë e programit të studimit dhe përmirësimin e saj në vazhdimësi. Numri i pakët i studentëve nuk përbën një justifikim për mosmarrjen e feedback nga aktorë të jashtëm të tregut.

Komenti nuk merret parasysh nga GVJ



GVJ në FUSHA VI– Standardi VI.2– Konkluzionet

Komente nga GVJ

Meqë asnjë prej komentëve të bëra nga GVB nuk janë marrë parasysh, vlerësimi për këtë kriter nuk ndryshon dhe Standardi konsiderohet i përmbushur kryesisht

GVJ në FUSHA VI– Standardi VI.3– Kriteri 1, 2, Konkluzionet

Konstatime fillestare GVJ

Nuk vihet në dispozicion të GVJ një raport vlerësimi që të artikulojë rezultatet e pritshme të vlerësimit. Mangësitë dhe nevojat për përmirësim, mekanizmat për motivimin e arritjeve më të mira dhe planin e masave për adresimin e mangësive të konstatuara në programin e studimit

Komente nga GVB

Programi Master i nënshtrohet akreditimit për herë të parë marrja e modeleve të institucioneve europiane është bërë krahas ruajtjes së të gjitha parametrave të normativave shtetërore si dhe të rregulloreve përkatëse. Periudha që nga nisja e procesit të riorganizimit dhe nisja e procesit të akreditimit është shumë e shkurtër dhe nuk ka pasur nevojë për rishikim programi.

Komente nga GVJ- *Për sa më sipër, vlerësohet shpjegimi i GVB por GVJ gjykon dhe vlerëson që periudha e shkurtër kohore mes riorganizimit të programeve dhe akreditimit të programit nuk përbën justifikim për mos monitorimin e cilësisë së tij apo dhe përmirësimin e tij. Monitorimi dhe sigurimi i brendshëm i cilësisë për programet duhet bërë në mënyrë të vazhdueshme dhe nuk ka të bëjë me periodicitetin e akreditimeve.*

GVJ në FUSHA VI– Standardi VI.4– Kriteri 1, 2, 3 Konkluzionet

Konstatime fillestare GVJ

Në politikat dhe procedurat e brendshme të garantimit të cilësisë si dhe në dokumentet rregullatorë të UART parashikohet qartë përfshirja e stafit të brendshëm dhe përfshirja studentore por nuk garantohet apo parashikohet asgjëkundi përfshirja e aktorëve të jashtëm, bashkëpunëtorëve të jashtëm apo përfaqësuesve nga tregu i punës. Nga ana tjetër për nga struktura komplekse dhe me pak burime njerëzore e Zyrës mësimore, Kurrikulës, Informimit të Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës ngelen të paqarta përgjegjësitë dhe detyrat që ka secili anëtar.

Komente nga GVB

Është marrë mendimi i një pedagogu të jashtëm Trombist pranë orkestrës së RTSh si pedagog i ftuar dhe njëkohësisht Alumni i FM. Përfshirja e aktorëve të tjerë të jashtëm në fokus grupe mbledhje njësie bazë, apo kryesore dhe diskutime për përmirësimin e cilësisë së programit do të takonte një periudhë tjetër pas mbylljes së kësaj procedure akreditimi.

Komente nga GVJ- *Për sa më sipër, vlerësohet shpjegimi i GVB por GVJ gjykon dhe vlerëson që periudha e shkurtër kohore mes riorganizimit të programeve dhe akreditimit të programit nuk përbën justifikim për mos monitorimin e cilësisë së tij apo dhe përmirësimin e tij. Monitorimi dhe sigurimi i brendshëm i cilësisë për programet duhet bërë në mënyrë të vazhdueshme dhe nuk ka të bëjë me periodicitetin e akreditimeve.*

GVJ në FUSHA VI– Standardi VI.5– Kriteri 3, 4, 5 Konkluzionet

Konstatime fillestare GVJ

Institucioni i arsimit të lartë nuk ka vënë në dispozicion një plan masash që adreson dhe synon përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara. Nuk ofrohet asnjë evidencë e cila dëshmon si ndërhyrje institucioni në përmirësimin e cilësisë kur konstatohen problematika në mbarëvajtjen e programit qoftë gjatë një vlerësimi të brendshëm apo të jashtëm të cilësisë.

Komente nga GVB

Ndërhyrja në përmirësimin e cilësisë do të ndodhte në një etapë të mëvonshme vetëm pasi të jetë përmbyllur procesi i akreditimit dhe bazuar në rregullimet përkatëse.


Komente nga GVJ- *Për sa më sipër, vlerësohet shpjegimi i GVB por GVJ gjykon dhe vlerëson që monitorimi dhe sigurimi i brendshëm i cilësisë për programet duhet bërë në mënyrë të vazhdueshme dhe nuk ka të bëjë me periodicitetin e akreditimeve.*




Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve në "Trombon dhe Mësuesi" ofruar nga "Universitetin e Arteve"

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Universiteti i Arteve është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me karakter akademik, artistik dhe shkencor me veprimtari në fushën e arteve. Programet e studimit të ciklit të dytë master që ofron Departamenti I Interpretimit në Fakultetin e Muzikës jo vetëm që nuk bien ndesh me interesat kombëtare por synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Ata reflektojnë prezantimin e ofertës akademike në përputhje me prioritetet zhvillimore të vendit. Në kuptim të ruajtjes dhe konsolidimit të vlerave akademike dhe kulturore kombëtare</p> <p>Në programin e studimit dhe në syllabuset e lëndëve përfshihen forma të shkurtëra me autorë botërorë apo shqiptarë, personeli akademik i angazhuar me kohë të plotë dhe të pjesshme përmbushin nivele të larta të përfaqësimit të vlerave akademike kombëtare dhe të përcuarjes së tyre në vite.</p> <p>Departamenti I Interpretimit ka strukturuar në vijimsi dy nivelet e studimeve Bachelor dhe Master. Studentët trombonistë kanë studiuar, përvetësuar dhe praktikuar vlerat akademike e kulturore kombëtare përmes disiplinave si Folklor Muzikor Shqiptar, Histori Muzike, estetikë Muzikore.</p> <p>Syllabusi i lëndës së orkestrës Simfonike përfshin dhe intepretimim e veprave muzikore origjinale të autorëve shqiptarë të pasura me element tipikë kombëtarë të muzikës shqiptare.</p> <p>Sjellja e evidencave nga ana e grupit të vlerësimit të brendshëm është e plotë dhe shterruese. Grupi i vlerësimit të brendshëm(GVB) citon si evidence 4 dokumente mes të cilave</p> <p>DVV Evid.Nr.I.1.1.1.1 Ligji për Arsimin e Lartë 80/2015 Evid.Nr.I.1.1.1.4 PLani Mësimor Bachelor në Trombon Evid.Nr.I.1.1.1.5 Plani Mësimor Master Trombon Evid.Nr.I.1.1.1.6 Jetëshkrimet e personelit DI Evid.Nr.I.1.1.1.7 Tituj e Grada të Personelit Akademik të DI Evid.Nr.I.1.1.1.8 Syllabus Orkestra Simfonike</p>

<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në "Trombon dhe Mësuesi" ka për qëllim kryesor të tij ofrimin e një arsimit të lartë profesional dhe veprimtari interprete artistike kërkimore dhe shkencore në fushën e artit dhe të kulturës dhe kjo është në përputhje me fushën e veprimtarisë të institucionit të arsimit të lartë.</p> <p>Në përputhje me atë çfarë artikullohet në statut program është krijuar me qëllimin <i>a) Per te krijuar, zhvilluar, përcuar dhe mbrojtur dijet përmes mësimdhënies, në fushen e artit dhe te kulturës, si dhe te nxisë dhe zhvillojë kerkimin artistik/shkencor. b) Për të formuar specialiste te lartë në fushat e arteve dhe për te përgatitur artistet e rinj ne perputhje me prioritetet e zhvillimit te vendi</i></p> <p>Programi i studimit Master i Arteve në "Trombon dhe Mesuesi" i Departamentit te Interpretimit është hartuar dhe ofrohet në perputhje me fushen e veprimtarisë së Universitetit te Arteve, qe është Arti dhe në mënyrë me specifike, me fushën e Artit Muzikor</p> <p>Si evidencë për këtë pikë janë sjellë</p> <p>1.1 1.2.1 Statuti i Universitetit te Arteve, Neni 4 http://www.uart.edu.al/media/Statuti_uart_202_I.PDF</p> <p>1.1.1 2.2. Ligj 80/2015, Neni 75 https://llqbz.gov.al/eli/figi/2015107/22/80</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimit akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në "Trombon dhe Mësuesi" ofrohet në përputhje me planin strategjik të UART për vitin 2018-2025 DVV Evid. Për miratimin e planit strategjik të UART, në përputhje me standardet më të mira, në përputhje me statutin e UART DVV. Evid. Statuti I UART, Rregulloren e institucionit Evid. Rregullore mësimore e Programit të Studimit, të njësisë kryesore, rregulloren e cikleve të studimit Evid Rregullore Mësimore e Ciklit të Dytë dhe një sërë aktesh të tjera rregullatore të UART. Në vizionin strategjik të programit dhe të vetë institucionit të arsimit të lartë është integrimi, rajonal europian dhe global duke çuar më tej atë që është kthyer tashmë në traditë. Programi synon qasjet më cilësore të edukimit universitar, artistik dhe trajnimit për përgatitjen profesionale të specialistëve të fushës së artit dhe në veçanti të specialitetit të Trombons.</p> <p>Në strategjinë e UART për Zhvillim pika 2 dhe pika 2.1, ku nderthuren ne menyre transversale dhe sipas fushave dhe drejtimeve akademike te institucionit: zgjerimi i aksesit pëmes programeve të reja të studimit, me aspekte te tjera të ofertës akademike, forcimi i mësimdhënies përmes ndërtimit të laboratorëve të rinj bashkëkohore, shtimi i numrit të projekteve artistike e shkencore si edhe rritjen e kontributit në jetën kulturore e artistike të vendit.</p> <p>Evidence DVV</p>






	<p>Il.1.3.1 Ligjin per Arsimin e Larte nr.80/2015 si dhe kuadrin nenligjor ne zbatim te ketiJ ligji,</p> <p>Il.1.3.2 VKM Nr. 145, date 10.03.2021 Per dhenien e Statusit te veçantë Universitetit te Arteve</p> <p>Il.1.3.3 VSA VSA Nr. 39, date 11.10.2017 "Mbi miratimin e planit te zhvillimit strategjik te UART per vitin akademik 2018-2025"</p> <p>Il.1.3.4. VKM Nr. 15/1, 24.10.2017 "Mbi miratimin e planit te zhvillimit strategjik te UART per vitet akademike 2018-2025"</p> <p>I 1.1.3.5 VKM nr.234, date 23.3.2011, te Keshillit te Ministrave, "Per krijimin e Universitetit te Arteve"</p> <p>1.1.1.3.6 Statuti i UART</p> <p>1.1.1.3.7 Rregullore e UART</p> <p>1.1.1.3.8 Rregullore mesimore e programit te studimeve te Ciklit te Dyte Master</p> <p>1.1.1.3.9 Rregullore e Programit te Studimit Master ne Arte Trombe dhe Mesuesi</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit është konceptuar që në hartimin dhe në zhvillimin e tij që të jetë në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesin kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit. Këto elementë parashikohen në Statutin e UART dhe në artikullimin e misionit të tij. GVB citon në mënyrë specifike dokumenta strategjike reference kombëtarë dhe ndërkombëtarë të tillë si Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026 dhe Unesco Unpacking Sustainable Development Goal Education 2030,</p> <p>Strategjia Kombëtare për zhvillim dhe Integrim 2015-2020 Shtylla 3 parashikon Investimi në Kapitalin njerëzor dhe kohezionin social/Arsimi i Lartë/ objektivat strategjike/ përmiresimi i cilësisë në Arsimin e Lartë; mbështetja dhe zgjerimi i numrit të programeve të studimit me qëllim përputhjen me kërkesat e tregut të punës;</p> <p>UART bashkepunon ngushte me IAL-te e huaja për njohjen e lëvizshmërisë (mobilitetit) dhe diplomave të huaja të studenteve, Sektori i projekteve të UART mbulon zbatimin e marreveshjeve bilaterale dhe shumëpaleshe dhe zbatimin e projekteve ndërkombëtare.</p> <p>Unpacking Sustainable Development Goal Education 2030, Objektivi 4 i Agjendes 2030 përcmban garantimin e edukimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimin e mundësive për mesim gjatë gjithë jetës.</p> <p>Të gjithë këto dokumente gjejnë mishërim në punën e kryer nga UART.</p> <p>I.1.1.4.1 Strategjine Kombetare per zhvillim dhe Integrim 2015-2020</p>
	<p>I.1.1.4.2 Draft Strategjia Kombetare e Arsimit 2021-2026</p> <p>I.1.1.4.3 Akreditimi i institucionit Vendim BA Nr.68, date 21.09.2017</p> <p>I.1.1.4.4 Akreditimi i institucionit Vendim BA Nr.17, date 24.03.2022.</p> <p>I.1.1.4.5 VKM nr. 781/ date 26.12.2018 Per garantimin e transparences ne institucionet publike te arsimit te larte.</p>





	I.1.1.4.6 VKM nr.777/2018 I.1.1.4. 7 Ligji per Arsimin e Larte I.1.1.4.8 Guida e UNESCO per arsimin: Unpacking Sustainable Development Goal 4 Fducation 2010			
Konkluzione	<p><i>Universiteti i Arteve është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me karakter akademik, artistik dhe shkencor me veprimtari në fushën e arteve. Programet e studimit të ciklit të dytë master që ofron Departamenti i Interpretimit në Fakultetin e Muzikës jo vetëm që nuk bien ndesh me interesat kombëtare por synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Programi i studimit Master i Arteve në "Trombon dhe Mësuesi" ka për qëllim kryesor të tij ofrimin e një arsimit të lartë profesional dhe veprimtari interprete artistike kërkimore dhe shkencore në fushën e artit dhe të kulturës dhe kjo është në përputhje me fushën e veprimtarisë të institucionit të arsimit të lartë. Programi i studimit ofrohet në përputhje me planin strategjik të UART për vitin 2018-2025, në përputhje me standardet më të mira, në përputhje me Rregulloren e institucionit, të njësisë kryesore, rregulloren e cikleve të studimit dhe një sërë aktesh të tjera rregullatore të UART. Programi i studimit është konceptuar që në hartimin dhe në zhvillimin e tij që të jetë në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit</i></p> <p><i>Standardi përmbushet plotësisht</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	


Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Universiteti i Arteve, konkretisht Fakulteti i Muzikës ka 60 vite që ushtron aktivitetin e tij në fushën e arsimit të lartë dhe demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura njerëzore për ofrimin e programit të studimit. Në përputhje me organikën e prezantuar të Departamentit të Interpretimit në këtë program studimi janë angazhuar pedagogë me përvojën dhe profilizimin e duhur për ofrimin e programit të studimit.</p> <p>Programi i studimit Master i Arteve në "Trombon dhe Mësuesi", ofrohet nga Njesia Baze</p>

	<p>- Departamenti i Interpretimit - DI, në bashkëpunim për modulet A dhe C të planit mësimor edhe me Departamentin KMDP, si pjesë të Fakultetit të Muzikës</p> <p>Në Departamentin e Interpretimit në vitin 2021-2022 janë të rekrutuar me kohë të plotë 50 pedagogë nga të cilët 1 të kategorisë Prof.Dr., 10 Prof., 1 Prof.Assoc.Dr., 11 Prof.Assoc, 5 Dr., 5 Lektorë dhe 17 asistentë lektorë. Shpërndarja në përqindje në mes të lektorëve të brendshëm PAE/Pak është në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p>Evid. DVV.</p> <p>I.I.2.1.1 Planifikimi i personelit të FM nga DI</p> <p>I.I.2.1.2 Kërkese për miratim strukture organizative të FM,</p> <p>I.I.2.1.3 Tabelat e personelit akademik</p> <p>I.I.2.1.4 Organigrama</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën e njësisë kryesore sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve dhe udhëzimeve në fuqi. Fakulteti I Muzikës kryen veprimtarinë mësimore, kërkimore artistike dhe shkencore në fushën e arteve, shkencë humane kodi 02, atë të përgjithshme arte kodi 021 dhe specifike Muzikë dhe Arte performuese kodi 0215. Veprimtaria mësimdhënëse në Fakultetin e Muzikës ofrohet edhe në fushën e dukimit 01 dhe atë specifike të formimit të mësuesve 0114.</p> <p>Evid. DVV</p> <p>I.I.2.2.1 "International Standard Classification of Education: Fields of Education and Training 2013" UNESCO</p> <p>I.I.2.2.2 VKM 41 date 24/01/2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara në institucionet e Arsimit të Lartë"</p> <p>I.I.2.2.3 Informacion Interpretimit</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë</p>	<p>Fusha e përgjithshme e programit të studimit është fusha e muzikës. Kjo fushë është në përputhje me fushën akademike dhe studimore të Departamentit të Interpretimit i cili ka për qëllim organizimin e procesit të mësimdhënies dhe kërkimit artistiko-shkencor dhe përhapjen e dijes në fushën e Muzikës. Pas riorganizimit veprimtaria mësimdhënëse e programeve të studimit master ofrohet në fushën e edukimit dhe atë specifike të formimit të mësuesve me specializim të vecantë.</p> <p>Analiza e planeve mesimore dhe syllabuseve të lendeve të parashikuara për t'u zhvilluar gjatë 2 viteve akademike për fitimin e diplomes Master</p>





<p>bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>në "Trombon dhe Mësuesi", demonstron një përputhje në strukturë me planet mesimore dhe syllabuset e fushës akademike e kërkimore të Departamentit të Interpretimit.</p> <p>Programi i Studimit Master i Arteve në "Trombe dhe Mesuesi" kryen veprimtarinë mësimore dhe atë kërkimore artistike-shkencore a) Arte dhe Shkenca Humane (kodi 02) - si fushë kryesore b) Arte (kodi 021) - si fushë e përgjithshme c) Muzikë dhe Arte Performuese (kodi 0215) - si fushë specifike.</p> <p>Me riorganizimin e Programeve të studimit Master (përmban dhe integron edhe lëndë që i përkasin fushës së a) Edukimit (kodi 01) - si fushë kryesore b) Formimit të mësuesve me specializim të vecante (kodi 0114)</p> <p>DVV. Evidenca</p> <p>I.I.2.3.1 Statistikat UNESCO International Standard Classification of Education: Fields of Education and Training</p> <p>J.I.2.3.2 Informacion Departamenti I Interpretimit</p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi pasi programi i studimit në fjalë është Master i Arteve dhe jo Master Profesional.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Departamenti i Interpretimit nuk ofron trajnime specifike të mëtjshme për Alumni të tij, dhe kjo pranohet edhe nga vetë argumentimi i dhënë në lidhje me nivelin e përmbushjes së kriterit të sjellë nga GVB.</p> <p>Por në bashkërendim me punëdhënësit potenciale për natyrën e instrumentit të Trombons dhe të specifikës së lojës instrumentale në ansamble dhe/ose orkestra studentëve iu ofrohen disa mundësi, si produksione artistike të ofruara nga institucione publike të fushës së muzikës; produksione artistike të ofruara nga sektori jopublik si OJF. Këto marrin formën e trajnimeve praktike të tipologjisë "learning by doing", ku shkëmbimet e përvojave me grupet e profesionistëve, shërbejnë si një shkollë e trajnim i vazhdueshëm për të rinjtë tromboniste pas diplomimit.</p> <p>Si evidencë janë sjellë foto dhe poster të aktiviteteve të organizuara bashkarisht nga studentët dhe alumni të programit.</p> <p>DVV. Evid.</p>


	<p>1.1.2.5.1 Foto Nr. 1, 2, 3. Koncert ne Vivo Sezon Koncertor</p> <p>J.1.2.5.2 Foto Nr. 4 Koncert ne Muzeun Arkeologjik Durres</p> <p>J.1.2.5.3.Foto Nr. 5 Koncert ne Kompleksin Kulturor te Katedrales Orthodoxke</p> <p>I.I.2.5.4 Foto Nr. 6 Koncert ne Sheshin para UART</p> <p>1.1.2. 5.5 Foto Nr. 7 Workshop me VitoLoRe</p>						
Konkluzione	<p><i>Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura njerëzore për ofrimin e programit të studimit. Në përputhje me organikën e prezantuar të Departamentit të Interpretimit në këtë program studimi janë angazhuar pedagogë me përvijën dhe profilizimin e duhur për ofrimin e programit të studimit. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën e njësisë kryesore sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve dhe udhëzimeve në fuqi. Fusha e përgjithshme e programit të studimit është Fusha e Muzikës. Kjo fushë është në përputhje me fushën akademike dhe studimore të Departamentit të Interpretimit. Departamenti i Interpretimit nuk ofron trajnime specifike të mëtejshme për Alumni të tij, por mbështetet thëllësisht në bashkërendimin e punës midis studentëve alumni dhe institucioneve publike dhe jopublike për organizimin e eventeve artistike. Evidentohen disa mangësi metodologjike në citimin e referencave apo evidenca të munguara.</i></p> <p><i>Standardi përmbushet plotësisht</i></p>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi I.3	
<p>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së</p>	<p>Institucioni siguron një bashkëpunim dhe bashkërendim të brendshëm të përmes një ndarje të detyrave mes njësive përkatëse dhe marrjen e përgjegjësisë përkatëse. Ndarja e detyrave bëhet duke marrë për bazë respektimin e hierarkisë institucionale, respektimin e tipologjive të aktivitetit specifik të përditshëm të personelit akademik dhe administrativ në tërësi, bashkërendimit të aktivitetit të njësive kryesore dhe bazë të UART. Marrja e përgjegjësisë përkatëse mes njësive dhe personelit:</p>

<p>përgjegjësi përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Marrëdhëniet mes njësive të Fakultetit të Muzikes brenda Universitetit të Arteve janë të përshkuara përmes:</p> <p>a) Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor 80/2015,</p> <p>b) Statutit të Universitetit të Arteve, Nenet mbi UART dhe njësitë përbërëse të tij, Organet dhe autoritetet drejtuese, Struktura administrative e UART, Personeli akademik</p> <p>c) Rregulloreve përkatëse të Fakultetit të Muzikës,</p> <p>d) Kodit të Etikës,</p> <p>Nga dokumentet e sjella si evidencë mund të gjurmohet një bashkëpunim dhe ndarje detyrash dhe përgjegjësish, por do të ishte me vend që si evidence të silleshin edhe procesverbalet e një mbledhjeje apo minuta takimi ku qartazi ndahen përgjegjësitë mes njësive përkatëse akademike dhe administrative dhe bëhen publike rezultatet e analizës vjetore.</p> <p>Në bazë të përcaktimeve të Statutit të UART dhe Rregulloreve përkatëse, në përfundim të çdo viti akademik realizohen analizat vjetore të punës mes njësive dhe personelit.</p> <p>DVV Evidence:</p> <p>1.1.3.1.1 Urdhër Rektori Mbi bursat dhe reduktimet e tarifave të shkollimit</p> <p>1.1.3.1.2 Urdhër Rektori Mbi perjashtimet nga tarifat e shkollimit</p> <p>1.1.3.1.3 Urdhër Dekani mbi Procedurat e zhvillimit të Konkursit të Pranimeve 2022 në Fakultetin e Muzikës</p> <p>1.1.3.1.4 Urdhër Dekani mbi Procedurat e zhvillimit të Konkursit të Pranimeve 2022 në Fakultetin e Muzikes</p> <p>1.1.3.1.5 VSA Nr. 11, 02.02.2022 për Miratimin e rregulloreve dhe kritereve të konkurseve të pranimit në Master</p> <p>1.1.3.1.6 Urdhër i Dekanit të FM për ngritjen e komisionit për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve që aplikojnë për program të dytë studimi</p> <p>1.1.3.1.7 Urdhër i Dekanit të FM për marrjen e masave organizative të konkurseve të pranimit në programet e studimit me karakter profesional në Fakultetin e Muzikës</p> <p>1.1.3.1.8 Urdhër i Dekanit të FM për ngritjen e komisioneve dhe zhvillimin e konkurseve të pranimit të Programeve të Studimit të Ciklit të Dytë, në Departamentin e Interpretimit.</p> <p>1.1.3.1.9 Ligj për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor 80/2015</p> <p>1.1.3.1.10 Statuti i Universitetit të Arteve</p> <p>1.1.3.1.11 Rregullore UART</p>
--	---





	<p>1.1.3.1.12 Rregullore FM</p> <p>J.I.3.1.13 Kodi i Etikes i UART</p> <p>1.1.3.1.14 Urdhër Rektori për zhvillimin e analizës vietore 1.1.3.1.15 Analize vjetore nga DI dhe/ose Fakulteti i Muzikës</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Universiteti i Arteve ka zhvilluar dhe zhvillon marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendi, në fushën e krijtarisë artistike si dhe në fushën e edukimit për krijimtari artistike. Këto marrëveshje janë formalizuar me marrëveshjet e bashkëpunimit dypalëshe me Universitetet, akademitë apo konservatorët me të cilët bashkëpunon UART.</p> <p>Marreveshjet ndërinstitucionale të nënshkruara janë të dy kategorive:</p> <p>1) marreveshje me institucione homologe dhe</p> <p>2) marreveshje me aktorë biznesi brenda ose jashte vendi</p> <p>Marreveshjet me institucione homologe brenda e jashtë vendit përfshijnë marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucional, memorandum mirëkuptimi dhe marrëveshje për alokimin e diplomave të përbashkëta. Megjithatë mungojnë bashkëpunime rajonale në organizimin e përbashkët të konferencave, koncerteve apo aktiviteteve artistike të përbashkëta. Marrëveshjet me aktore të biznesit vendas dhe të huaj janë marreveshje të drejtpërdrejta për pjesëmarrje të biznesit vendas apo të huaj në investimet madhore të Universitetit të Arteve apo marreveshje jo të drejtpërdrejta (indirekte) për pjesëmarrje të biznesit vendas apo të huaj në produksionet artistike të Departamentit të Interpretimit të Fakultetit të Muzikës.</p> <p>Si evidence të marrëveshjeve është sjellë DVV. Marrëveshjet e UART në kuadër të projektit Erasmus+. Në argumentimin e GVB janë përmendur marrëveshjet e tjera ndërinstitucionale DVV. Evid. Raport Marrëveshje Bashkëpunimi Ndërinstitucional në Kuadër të Erasmus +, por nuk janë sjellë si evidenca marrëveshjet konkrete të firmosura dhe protokolluara nga palët pjesëmarrëse dhe përfituese.</p> <p><i>Për sa më sipër, vlerësohet shpjegimi i GVB në lidhje me numrin e marrëveshjeve institucionale të lidhura dhe raportimi në lidhje me faktin që asnjë mobilitet nuk është kryer gjatë kësaj periudhe</i></p> <p>Komenti merret parasysh nga GVJ dhe reflektohet edhe në raport</p>
	<p>Evidenca DVV</p>

	<p>I.I.3.2.1 UART AGDER Marreveshja e bashkëpunimit në kuadër të programit Erasmus+ KA 107</p> <p>I.I.3.2.2 UART CSM VIGO Marrëveshja e bashkëpunimit në kuadër të programit Erasmus+ KA 107</p> <p>I.J.3.2.3 UART RCSM GRANADA Marrëveshja e bashkëpunimit në kuadër të programit Erasmus+ KA 107</p> <p>I.I.3.2.4 UART AGDER Marrëveshja e bashkëpunimit në kuadër të programit Erasmus+ KA 107</p> <p>I.J.3.2.5 MOU UART CNSMDP</p> <p>I.I.3.2.6 UART CSM I'IGO intent letter për Diplomat e përbashkëta</p> <p>I.I.3.2.7 UART DAMS UNIBA intent letter për Diplomat e përbashkëta</p> <p>I.J.3.2.8 UART UNI TOR VERGATA Marrëveshje për Doktorata të Përbashkëta</p> <p>I.I.3.2.9 Informacion zyrtar në faqen zyrtare të UART për TAP dhe AJCS</p> <p>I.I.3.2.10 Informacion zyrtar në faqen zyrtare të UART per Pianon e dhuruar prej financimit në modelin crowdfunding</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Universiteti i Arteve dhe njësia që ofron programin e studimit kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe dhe zyrat vendore arsimore me qëllim realizimin e praktikave profesionale DVV Marrëveshje bashkëpunimi të Fakultetit të Muzikës me ZVA për kryerjen e Praktikave Mësimore të Studentëve. ZVA-të janë Tirane, Vlore, Korçë, Elbasan, Berat dhe Kurbin duke krijuar kushtet e bashkëpunimit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale në mësimdhënie Ndërkohë gjatë vizitës në institucion nga ana e GVJ është qartësuar që marrëveshjet hartohen në mënyrë të përvitshme, pasi të tilla janë edhe detyrimet kontraktuale për pagesën e kontributeve të studentëve që parashikon kjo marrëveshje. Në raportimin mbi përmbushjen e këtij kriteri duhej saktësuar metodologjia e mbikëqyrjes së kryerjes së praktikës, target grupi i studentëve të përfshirë në praktikë, periodiciteti i praktikave etj. Megjithatë një dosje e plotë e ndjekjes së praktikave është vënë në dispozicion të GVJ nga pedagogu i lëndës që merret me ndjekjen e praktikave dhe kjo dëshmon për një seriozitet në ndjekjen e detyrave. Po ashtu, në funksion të mobilitetit të studentëve lidhur me realizimin e praktikave profesionale artistike, krahas angazhimit të përkohshëm të studentëve Trombonistë në sezona koncertale të TOB, risia e dy viteve lidhet me krijimin e mundësisë së bursave Erasmus me qëllim realizimin e internship-it pranë institucioneve artistike homologe të Spanjës.</p>
	<p>Evidence DVV:</p> <p>1.1.3.3.1 Tabela 5 Aneks RVB Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese</p> <p>II.3.3.2 Marreveshje me ZVA Vlore (model)</p> <p>I.I.3.3.3 Certifikate internship</p>

<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Në relativimin mbi përmbushjen e këtij kriteri GVB nuk ka qartësuar në çfarë mënyre njësia përgjegjëse për programin harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Evidenca e sjelle si evidencë mbështetëse nga grupi i punës është thjeshtë një përmbledhje jo zyrtare pa numrat e protokollit përkatëse dhe datat përkatëse të marrëveshjeve që UART ka me institucionet homologe. Mungojnë tërësisht të dhënat periodike dhe analitike mbi përfitimet institucionale nga marrëveshjet e bashkëpunimit.</p> <p>Gjithsesi nga vetë anëtarët e grupit të punës të angazhuar në hartimin e RVB pohohet se</p> <p>Jane aprovuar 3 mobilitete semestrale per studente Master në Trombon dhe Mësuesi,</p> <p>Janë realizuar 2 mobilitete semestrale për studentë Master në Trombon dhe Mësuesi,</p> <p>Nuk ka të dhëna analitike mbi praktikat pranë ZVA dhe liceve.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>I.I.3.4.1 I Statistikat e përgjithshme te International Credit Mobility</p> <p><u>Komente nga GVJ-</u> Për sa më sipër, vlerësohet shpjegimi i Gvb në lidhje me mungesën e raporteve analitike por duhet pasur parasysh që në të ardhmen kur numri i mobiliteteve të të mundshme të jetë edhe më i lartë, institucioni dhe departamenti duhet të zhvillojë një kulturë sistematike hartimi dhe procesimi të dhënash analitike në lidhje me mobilitetet.</p> <p>Komenti merret parasysh nga GVJ dhe reflektohet edhe në raport</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni siguron një bashkëpunim dhe bashkërendim të brendshëm të detyrave përmes një ndarjeje të detyrave mes njësive përkatëse dhe marrjen e përgjegjësive përkatëse, megjithatë ekzistojnë pak evidenca që të dëshmojnë për urdhëra apo vendimmarrje shpërndarje përgjegjësish në mes të njësive përkatëse. Institucioni ka zhvilluar dhe zhvillon marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendi, në fushën e krijmtarisë artistike si dhe në fushën e edukimit për krijimtari artistike. Këto marrëveshje janë formalizuar me marrëveshjet e bashkëpunimit dypalëshe. Universiteti i Arteve dhe njësia që ofron programin e studimit kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe dhe zyrat vendore arsimore me qëllim realizimin e praktikave profesionale. Nga vizitat në institucion GVJ është informuar mbi përfitimet e marrëveshjeve dypalëshe por nuk janë vënë në dispozicion nga institucioni raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Një dosje e plotë e ndjekjes së praktikave është vënë në dispozicion të GVJ nga pedagogu i lëndës që merret me ndjekjen e praktikave dhe kjo dëshmon për një seriozitet në ndjekjen e detyrave.</i></p> <p>Standardi përmbushet kryesisht</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="592 1825 790 1904">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="790 1825 989 1904">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="989 1825 1189 1904">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

			X	
--	--	--	---	--

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregulatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në DVV GVJ ka shqyrtuar dokumentacionin dhe evidencat përkatëse dhe konstaton se programi i studimit është mbështetur në legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit që programi të organizohet në lëndë dhe module.</p> <p>Ky organizim respekton sistemin Evropian të transferimit dhe grumbullimit të Krediteve.</p> <p>Më tej, plani mësimor i programit të studimit Master i Arteve në "Trombon dhe Mësuesi" është i organizuar në përputhje me VKM Nr. 41 e rishkuar dhe strukturohet sipas veprimtarive formuese A-E si më poshtë:</p> <p>Moduli - LËNDË BAZË - përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (24 ECTS ose perqind të ngarkesës)</p> <p>Moduli - LËNDË KARAKTERIZUESE -përgatitje për disiplinën shkencore - artistike (53 ECTS ose perqind të ngarkesës)</p> <p>Moduli - LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE - nëndisiplina, profile dhe gruplëndë me zgjedhje (9 ECTS ose perqind të ngarkesës)</p> <p>Moduli - LËNDË ME ZGJEDHJE (4 ECTS ose perqind të ngarkesës)</p> <p>Moduli - LËNDË PLOTËSUESE - praktika profesionale (8 ECTS ose perqind të ngarkesës)</p> <p>Moduli – DETYRIME PËRMBYLLËSE . (22 ECTS ose perqind të ngarkesës)</p> <p>Po ashtu edhe syllabuset përmbajnë informacione të detajuara , si më poshtë:</p> <p>Kodi i lëndës Emërtesa e lëndës Semestri/Cikli Programi studimor Statusi i lëndës Qëllimi i lëndës</p>




Korrespondenca dhe korrelacioni i programit
Përmbajtja e lëndës
Semestri I (saggio — mbrëmje muzikore) / Semestri II (Provim)
Mënyra e mësimdhënies
Kontrolli i Njohurive
Detyrimet e studentëve
Mësimdhënia dhe vlerësimi i studentëve
Kreditet dhe mënyra e zhvillimit të mësimdhënies për semestër
ECTS koeficienti i ngarkesës së studentit
Numri i orëve nëpër semestra
Literaturë themelore
Literaturë plotësuese

Gjatë vizitës nga ana e GVJ është konstatuar që jo të gjitha syllabuset janë në formatin e parashikuar nga VKM 41 e ndryshuar. Syllabuset duhet të sillen në format të njëjtë poashtu të vendosen edhe rezultatet e të nxëniet aty ku ata mungojnë.

Ngarkesa për një ECTS është 25 orë mësimore ku përshihen orën në auditor dhe orë mësimore për përgatitjen e studentit apo për punë individuale.

Plani mësimor, krahas lëndëve të ndara në veprimtari formuese, përbëhet nga të dhënat për


- Orë mësimore në auditor
- Orë pune individuale
- Forma e mësimdhënies
- Forma e kontrollit
- Orët javore për semestër
- Kredite/ECTS për lëndë
- Kredite/ECTS për modul

DVV Evid.

II.1.1.1 VKM Nr.41, datë 24.01.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, i ndryshuar.


II.1.1.2 Urdhri e MASR Nr. 821, datë 26.12.2018 “Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin e Arteve”

	<p>II.1.1.3.Rregullore mësimore e Ciklit të Dytë të studimeve Master</p> <p>II.1.1.4.Rregullore e Programit të Studimit Master në Arte Trombon dhe Mësuesi</p> <p>II.1.1.5.Syllabuset e programit të studimit Master në Arte Trombon dhe Mësuesi</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Në programin e studimit Master i Arteve në “Trombon dhe Mësuesi”, në bazë të planit mësimor dhe syllabuseve vërehet zhvillimi i mëtejshëm i njohurive paraprake në krijimtari dhe edukim të studentëve. Studentët zhvillojnë më tej kreativitetin e tyre në forma më komplekse me ndihmë të orëve individuale që kanë me pedagogun. Lëndët karakterizuese, ndihmojnë në zhvillimin e krijimtarisë tek profesionistët e rinj, si dhe ndihmojnë për t’ju përgjigjur kërkesave të tregut muzikor. Lëndët bazë metodologjike, ku përfshihen <i>Vlerësimi në arsim; Metodologjia e mësimdhënies; Teoria e të nxëniet dhe menaxhim klase; Zhvillim kurrikule; Psikologji zhvillimi</i>, ndihmojnë studentët që krahas krijimtarisë të jenë dhe mësues të ardhshëm të suksesshëm dhe të pajisen me njohuritë e duhura metodike dhe pedagogjike.</p> <p>GVJ ka analizuar Planin mësimor të Programit Master i Arteve në “Trombon dhe Mësuesi ” dhe ka evidentuar se Lëndët Karakterizuese kanë ngarkesën më të madhe të ECTS gjithsej 53 ECTS pa përfshirë Diplomën prej 22 ECTS të cilat realizojnë qëllimin kryesor për disiplinën shkencore -artistike dhe për formimin dhe zhvillimin e një instrumentisti interpretues. Lëndët Bazë kanë të integruar lëndët që përgatisin studentët për mësimdhënie në të gjitha nivelet arsimore (24ECTS kredite).</p> <p>Lëndët plotësuese, lëndët me zgjedhje ,dhe lëndët ndërdisiplinare janë lëndë ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës së studimit (21 ECTS kredite).</p> <p>Të gjitha këto lëndë mundësojnë zhvillimin dhe ngritjen akademike, profesionale dhe artistike për studentët.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.1.2.1 Plani mësimor i programit të studimit “Master i Arteve në “Trombon dhe Mësuesi”</p> <p>II.1.2.2Syllabuset e programit të studimit Master në Arte Trombon dhe Mësuesi</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës</p>	<p>Programi i studimit ka përcaktuar ngarkesën e krediteve/ECTS sipas Veprimtarive Formuese, Module A-E (VKM Nr.41 , datë 24.01.2018). Po ashtu, janë parashikuar edhe praktikat profesionale të ndara në ato profesionale artistike (interpretimi në koncerte dhe festivale nacionale</p>






<p>profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>dhe internacionale dhe praktika mësimore (zhvillohet pranë institucioneve arsimore parauniversitare. Praktikart artistike organizohen në formën e koncerteve dhe vlerësohen me 1 ECTS dhe praktikart mësimore vlerësohen me nga 3 kredite/ ECTS në vit).</p> <p>Departamenti i Interpretimit ku ofrohet programi e realizon praktikën e mësimdhënies së studentëve duke u bazuar në marrëveshje bashkëpunimi midis Fakultetit të Muzikës me Zyrat vendore arsimore ku studentët zhvillojnë praktikart nëpër shkolla.</p> <p>Praktika artistike 1 ECTS kredit -organizohet në formën e koncerteve ku studentët marrin pjesë në jetën koncertale dhe aktivitete tjera në përbërje të ansambleve të dhomës apo orkestrave të dhomës.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.1.3.1.Shtojca 1 të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL” e ndryshuar.</p> <p>II.1.3.2. Plani Mësimor i Programit të studimit “Trombon dhe Mësuesi”.</p> <p>II.1.3.3.Urdhër i MAS Nr. 821, datë 26.12.2018 Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin Arteve.</p> <p>II.1.3.4.Marrëveshje me Drejtoritë e Përgjithshme të ZVA / shembull /ZVA Vlorë.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>GVJ ka analizuar programin e studimit bachelor të Trombons dhe ka konstatuar se Programi studimit të ciklit dytë Master i Arteve në Trombon dhe Mësuesi është një vijim logjik në përmbajtje ,qëllim dhe objektiva të programit Bachelor të Trombons.</p> <p>Nga vizita në UART, takimi me studentët e Departamentit të Trombons u vërtetua se të gjithë i kishin përfunduar studimet Bachelor të cilat synojnë të pajisin studentët me njohuritë bazë mbi metoda artistike dhe ose shkencore profesionale, parime artistike të përgjithshme dhe formin e shprehive sipas fushës përkatëse.Vazhdimësia e studimeve, programit Master i Arteve “Trombon dhe Mësuesi” ku krahas zhvillimit artistik, mundëson zhvillimin e aspektit pedagogjik për mësimdhënie.</p> <p>Programi i studimit të ciklit të dytë "Master i Arteve në "Trombon dhe Mësuesi" është program i thelluar i studimeve universitare të formimit artistik të cilat, ofrojnë studime edhe në fushën e mësuesisë, duke i aftësuar dhe formuar studentët Trombonistë edhe me kapacitete e shprehi të punës në mësimdhënie, në sektorin e arsimit të mesëm të ulët ose të lartë.</p>

	<p>DVV Evid.</p> <p>II.1.4.1.Plani mësimor Trombon Bachelor</p> <p>II.1.4.2.Plani mësimor Master në Arte Trombon dhe Mësuesi.</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në “Trombon dhe Mësuesi” u riorganizua me UMASR Nr. 821, datë 26.12.2018 ku i janë shtuar lëndët e formimit psiko-pedagogjik. Programi ka kohëzgjatje prej dy vite studimi akademik me 120 kredite/ECTS.</p> <p>Sipas planit mësimor të programit të ciklit të dytë Master i Arteve në Trombon dhe Mësuesi organizohet me 120 ECTS kredi.</p> <p>Universiteti i Arteve është i vetmi institucion i arsimit të lartë publik ,i cili ofron studime Master në Arte për një disiplinë artistike dhe Mësuesi. Me lëndët bazë dhe lëndët plotësuese plotëson 25 % të kredive në shërbim të formimit të përgjithshëm psikopedagogjik. Pjesa tjetër ka të bëjë me formimin artistik dhe formimin pedagogjik .</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.1.5.1 Urdhër i MASR Nr. 821, datë 26.12.2018 “Për riorganizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin Arteve”</p> <p>II.1.5.2VKM 145 Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve</p> <p>II.1.5.3 Urdhër i MAS Nr. 397, datë 10.08.2011 Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, “Master i shkencave” dhe “Master i Arteve” në Fakultetin e Muzikës, Fakultetin e Artit Skenik dhe Fakultetin e Arteve të Bukura të Universitetit të Arteve B13</p> <p>II.1.5.4. Plan i mësimor i Programit të Studimit Master në Arte Trombon dhe Mësuesi.</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>UART ka status të veçantë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në zbatim të VKM Nr.145, datë 10.03.2021. Konkursi për pranimin e studentëve miratohet në përputhje me kriteret e përcaktuara nga njësia përkatëse dhe miratohet nga Senati. Kuotat e dërguara nga UART miratohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit e cila nxjerr Udhëzimin përkatës për zhvillimin dhe afatin e konkursit. Bordi i Administrimit përcakton tarifën për program studimi dhe ia përcjell Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Bursa dhe reduktimi i tarifave mundësohet për studentë me aftësi të kufizuara, me notë mesatarë të lartë, shtresa sociale, etj.</p> <p>Sipas analizimit të dokumentacionit të paraqitur në evidence ,GVJ konstaton se Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës dhe Departamenti i Interpretimit, ku ofrohet Programi i Studimit Master i Arteve në ”Trombon dhe Mësuesi” organizohen dhe funksionojnë në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të lartë dhe rregulloret të paraqitura në evidence të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>


	<p>DVV Evid.</p> <p>II.1.6.1 Ligji 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor” ,</p> <p>II.1.6.2.VKM Nr. 145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>II.1.6.3 Statuti i UART</p> <p>II.1.6.4. VKM 780 datë 26.12.2018 Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve në IAL.</p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë nërmbajtje të ngjashme në nivel</p>	<p>Nuk ofrohet programi i studimit Master i Arteve në “Trombon dhe Mësuesi” me të njëjtën emërtim.</p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Arteve në “Trombon dhe Mësuesi” që nga viti 2019 i përmbahet sistemit të kodimit ISCED (adresuar arsimit të lartë VKM Nr.330, datë 11.05.2022). Ky program zhvillohet në:</p> <p>Kodi 02, fushën kryesore të Arteve dhe Shkencave Humane</p> <p>Kodi 021, Arte të përgjithshme</p> <p>Kodi 0215, Muzikë dhe Arte Performuese</p> <p>Program i studimit Master I arteve në Trombon dhe Mësuesi zotëron kodet sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra nga MAS poashtu dhe Standarteve Ndërkombëtare të Klasifikimeve të Arsimit :</p> <p>Fusha e studimit — ARTE dhe Shkencave Humane (kodi 02)</p> <p>Fusha e përgjithshme - ARTE (kodi 021)</p> <p>Fusha specifike - MUZIKË DHE ARTE PËRFORMUESE (kodi 0215)</p> <p>Master i Arteve "Trombon dhe Mësuesi" - Kode M2VLC1114; M2VLC1201•, M2VLC1399.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.1.8.1 VKM Nr. 330, datë 11.05 2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë”.</p> <p>II.1.8.2 UNESCO Standardet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit: Fields of Education and Training 2013 .</p> <p>II.1.8.2VKM Nr. 330, datë 11.05 2022 “Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në republikën e Shqipërisë”</p>

Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit i Arteve në “Trombon dhe Mësuesi” nuk ofrohet si program i përbashkët midis dy a më shumë institucioneve të arsimit të lartë. DVV Evid. II.1.9.1 Raporti I vlerësimit të brendshëm.		
Konkluzione	<i>Konstatohet se Programi i studimit ka përcaktuar ngarkesën e krediteve sipas Veprimeve Formuese, Module A-E (VKM Nr.41 , datë 24.01.2018) dhe që nga viti 2019 i përmbahet sistemit të kodimit ISCED (adresuar arsimit të lartë VKM Nr.330, datë 11.05.2022). Ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore bazë përgjegjëse për programin ka përmbushur detyrimet ligjore për organizimin ,strukturën akademike,stafin akademik ,vlerësimin dhe akreditimin. Njësia kryesor përmban organizimin dhe strukturën akademike poashtu kanë stafin e mjaftueshëm për realizimin e programit të studimit . Universiteti i Arteve përbëhet nga tre Fakultete: Fakulteti i Muzikës Fakulteti i Artit Muzikor Fakulteti i Arteve të Bukura Departamentet në Fakultetin e Muzikës janë: Interpretimi Trombon Trombon, Muzikologji, Dirizhim dhe Pedagogji Muzikore. Detyrimet e këtij programi përmbushen në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015, Neni 24/Pika 4. Shpërndarja lektorë të brendshëm dhe të jashtëm sipas viteve është si vijon 10 PAE/1 PAK v.a.2021-2022 7 PAE/2 PAK v.a.2020-2021 8 PAE/3 PAK v.a. 2019-2020

	<p>Përqindja e parashikuar bazuar në udhëzimet e MASR është 70% PAE me 30 % PAK dhe nga departamenti kjo përqindje është lehtësisht e prekur kryesisht në vitin akademik 2019-2020 kur kjo përqindje ka qenë 50-50.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.2.1.1 Ligji 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor II.2.1.1 VKM Nr. 145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve” II.2.1.1 Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr.17, datë 24.03.2022 për Akreditimin e Universitetit të Arteve II.2.1.1 Planifikimi i personelit te FM nga DI II.2.1.1 Kërkesë për miratim strukture organizative të FM, 15/09/2021: Dekani kërkesë Senatit Akademik II.2.1.1 Organigrama FM.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion nga UART dhe vizita, konstatuam që program i studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Struktura administrative përbëhet nga: struktura ndihmës akademik me karakter administrativ (sekretaria, kryesekretaria, specialistët në kurrikul dhe informim të studentëve); struktura administrative me kryetar të Degës në FM, punonjës shërbimi dhe struktura ndihmës akademike; specialist (laborantë).</p> <p>Të gjitha veprimtaritë bazohen në Rregulloren e Fakultetit të Muzikës. Për angazhimin e personelit ndihmës akademik për realizimin e praktikave mësimore, GVJ ka analizuar marrëveshjet me Zyrat vendore arsimore dhe Fakulteti i Muzikës dhe Departamenti i Interpretimit përgjegjës për Programin e Studimit Master i Arteve në "Trombon dhe Mësuesi", duke marrë parasysh specifikën profesionale të studentëve praktikant, i përmbushin detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi duke angazhuar personel akademik për realizimin e praktikave mësimore.</p> <p>Angazhimi i personelit akademik për realizimin e praktikave mësimore bëhet me urdhër të brendshëm, pas firmosjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit me Zyrat Vendore Arsimore .</p> <p>Ky angazhim bëhet me caktimin e një pedagogu koordinator i cili luan rolin e Mentorit Mbikëqyrës së praktikës mësimore në institucione ku realizohet program.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.2.2.1.Marrëveshje me ZVA Vlorë për Praktikant Profesionale Mësimore II.2.2.2.Urdhër i brendshëm për angazhimin e personelit akademik për realizimin e praktikave mësimore II.2.2.3.Skeda e studentit praktikant (model)</p>


<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>II.2.2.4.Marrëveshja e praktikës, (model) II.2.2.5.Formulari i vlerësimit për studentin praktikant (model).</p> <p>Konstatuam se, monitorimi i programit të studimit dhe praktikës artistike të studentëve realizohet nga Njësia Bazë Departamenti i Interpretimit kryetari/ja që përfaqëson grupin mësimor, Neni 15-16). Kryetari/ja i/e grupit kryen edhe detyrën e koordinatorit të programit të studimit.</p> <p>Njësia kryesore bazë ka caktuar një pedagog koordinator i cili luan rolin e Mentorit Mbikëqyrës së praktikës mësimore në institucione ku realizohet praktika.</p> <p>Të dhënat për praktikën e studentit figurojnë në skedën për praktikën dhe formularin e vlerësimit.</p> <p>Në takimin me studentët u vu re se studentët realizojnë praktikën mësimore në shkollat e qyteteve nga vijnë.</p> <p>Kjo praktikë është e mirë sepse bëhet edhe promovimi i edukimit dhe mësimin të instrumentit në atë shkollë.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.2.3.1 Marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të ZVA (model ZVA Vlorë) II.2.3.2 Urdhër i brendshëm për angazhimin e personelit akademik për realizimin e praktikave mësimore II.2.3.3 Skeda e studentit praktikant (model) II.2.3.4.Marrëveshja e praktikës, (model) II.2.3.5.Formulari i vlerësimit për studentin praktikant (model).</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga ana e GVJ u konstatua se detyrimet dhe veprimtaritë e këtij programi përmbushen në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë 80/2015, Neni 24/Pika 4 dhe Rregullores së Fakultetit të Muzikës.</i></p> <p><i>Përqindja e parashikuar bazuar në udhëzimet e MASR mes stafit me kohë të plotë të anagazhuar dhe stafit me kohë të pjesshme të angazhuar është 70% PAE me 30 % PAK dhe nga departamenti kjo përqindje është lehtësisht e prekur kryesisht në vitin akademik 2019-2020 kur kjo përqindje ka qenë 50-50.</i></p> <p><i>Ky standard përmbushet plotësisht</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë,</p>	<p>Nga vizita në UART, takimi me grupin e punës të vlerësimit të brendshëm, me përfaqësues të Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, informimit të studentëve, Këshillimit të Karrierës, Njesisë së Sigurimit të</p>

<p>disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Brendshëm të Cilësisë, u konfirmua që Njësia Bazë Departamenti I Interpretimit është përgjegjës për programin e studimit të Ciklit të dytë dhe për këtë ka hartuar Rregulloren e Programit të Studimit Master në “Trombon dhe Mësuesi”, miratuar me VSA Nr.45, dt. 20.07.2022.</p> <p>Në Rregulloren mësimore të ciklit të dytë Master si dhe në Rregulloren e programit të studimit Master i arteve në Trombon dhe Mësuesi.</p> <p>Në këto Rregullore paraqiten informacionet më të hollësishme prej pranimit të studentëve e deri te përmbyllja e studimeve, diplomimi, pajisja me diploma.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.3.1.1. Vendimi i Senatit Akademik nr. 17, datë 07.10.2021 i cili ka aprovuar Rregulloren Mësimore e Ciklit të Dytë Master</p> <p>II.3.1.2. Vendimi i SA nr. 60, datë 13.9.2022 për aprovimin e Rregullores së Programit të Studimit Master i Arteve Trombon dhe Mësuesi</p> <p>II.3.1.3. Plani mësimor Programit të Studimit Master i Arteve Trombon dhe Mësuesi</p> <p>II.3.1.4. Syllabuset e Programit të Studimit Master i Arteve Trombon dhe Mësuesi</p> <p>II.3.1.5. Rregullore dhe kriteret për studimet master viti 2022-2023.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Sipas Sistemit Evropian të transferimit dhe grumbullimit të Krediteve, programi i studimit Master i Arteve “Trombon dhe Mësuesi”, në përputhje me VKM nr.41, dt. 24.1.2018 me udhëzim të MAS, realizon vlerësimin e lëndëve me kredite/ECTS. Programi i studimit përmban planin mësimor të ndarë në vite, ku rishikohen në çdo vit akademik. Veprimtaritë formuese grupohen në module që grumbullojnë gjithësej 120 Kredite (ECTS). Modulet e veprimtarisë formuese janë nga A-E module, ku Moduli A ka lëndë bazike për përgatitjen metodologjike; Moduli B ka lëndë karakterizuese që lidhen me veçoritë e programit; Moduli C ka lëndë ndërdisiplinore dhe integruese ngjajshëm me disiplinat karakterizuese; Moduli D ka lëndë plotësuese që aftëson studentët në gjuhë të huaja, informatikë, komunikim dhe praktika profesionale; Moduli E ka detyrime përmbyllëse në lidhje më provimin përfundimtar.</p> <p>Programi i studimit Master i Arteve në Trombon dhe Mësuesi dhe plani mësimor posedojnë informacionet e nevojshme për grupimin e lëndëve në module në semestra-ngarkesën mësimore të lëndëve ,orët në auditorë ,format e mësimdhënies,format e kontrollit si dhe kreditet sipas ECTS.</p> <p>DVV Evid.</p>


	II.3.2.1. Plani mësimor Programit të Studimit Master i Arteve Trombon dhe Mësuesi.
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	<p>Programi i studimit Master i Arteve “Trombon dhe Mësuesi” përmban informacione të nevojshme për kriteret dhe specifikat e pranimit të studentëve të rinj. Konkursi për pranimin e studentëve organizohet në bazë të rregullores dhe kriterëve të propozuara nga Njësia Bazë Interpretim, miratuar nga Dekanati dhe Senati i UART. Pastaj, kalon në kërkesë për MAS për publikimin e kriterëve të pranimit. Transferimi i studentëve bëhet vetëm nga institucionet e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, që kanë program të njëjtë studimi). Po ashtu, edhe në web-faqe të Universitetit mund të informohen studentët.</p> <p>Programi Master i Arteve në Trombon dhe Mësuesi disponon informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve .Të gjitha këto janë të paraqitura në Rregulloren e UA, Rregulloren mësimore të ciklit të dytë, Rregulloren e programit të studimit Master i arteve në Trombon dhe Mësuesi.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.3.3.1. Rregullore e Universitetit të Arteve II.3.3.2 Rregullore mësimore e Ciklit të dytë të studimeve Master II.3.3.3 Rregullore e konkursit dhe kriteret për studimet master viti 2022-2023 II.3.3.4 Vendimi i SA nr. 60, datë 13.9.2022 për aprovimin e Rregullores së Programit të Studimit Master i Arteve Trombon dhe Mësuesi.</p>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<p>Programi i studimit Master i Arteve “Trombon dhe Mësuesi” përmban informacionet e nevojshme për programin, lëndët me përshkrim të detajuar-syllabuset (sipas VKM Nr.41, dt.24.01.2012). Gjatë kontrollit të syllabuseve, u konstatua se janë të gjitha syllabuset e lëndëve me përshkrim të detajuar, duke filluar nga objektivat, qëllimi, temat javore, vlerësimi, mënyra e organizimit të lëndës, semestri, vijueshmëria, literature bazë dhe shtesë. Çdo student ka dosjen e praktikës ku përfshihet në formularin e vlerësimit nga koordinatori dhe pedagogu i udhëheqjes praktike. Megjithatë nga kontrolli i syllabuseve u konstatua që jo të gjitha syllabuset janë të përditësuara sipas formatit të parashikuar në këtë VKM.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.3.4.1. Syllabuset e Planit Mësimor të Programit të Studimit Master I Arteve Trombon dhe Mësues.</p>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në	Përmbajtja e programit të studimit Master i Arteve “Trombon dhe Mësuesi”, bazuar në Rregulloren e programit të studimit, përditësohet çdo

<p>përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>vit me qëllim të përmirësimit të arritjeve të objektivave. Rishikimi i detajuar i planit mësimor, rregullores, syllabuseve bëhet nga departamenti i Interpretimit. Planet mësimore miratohen çdo vit nga Senati i UART. GVJ ka analizuar me kujdes Raportin e vlerësimit të brendshëm ku thuhet se në tri vitet e fundit akademike programi i studimit Master i Arteve Trombon dhe Mësuesi nuk ka pësuar ndryshime. Përmbajtja e programit mund të pësojë ndryshime në kontekst të analizave vjetore dhe riorganizimit ose përshtatjes me ndryshimet në aspektin ligjor. Ky program studimi gjatë periudhës 2021/22, nuk ka pasur ndryshime.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.3.5.1. Raporti I vlerësimit të brendshëm II.3.5.2. Statut i UART II.3.5.2. Plani mësimor Programit të Studimit Master i Arteve Trombon dhe Mësuesi.</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Gjatë vizitës në institucion, u konstatua që Njësia Bazë Interpretim është përgjegjëse për programin e studimit të Ciklit të dytë dhe për këtë ka hartuar Rregulloren e Programit të Studimit Master në "Trombon dhe Mësuesi".</i></p> <p><i>Gjatë kontrollit të syllabuseve, u konstatua se janë të gjitha syllabuset e lëndëve me përshkrim të detajuar, duke filluar nga objektivat, qëllimi, temat javore, vlerësimi, mënyra e organizimit të lëndës, semestri, vijueshmëria, literature bazë dhe shtesë. Nga kontrolli i syllabuseve u konstatua se syllabuset e lëndëve 'Teori e të nxënit dhe menaxhim klase' dhe lënda 'Metodologji e mësimdhënies' nuk janë të formatit të njëjtë nga aspekti teknik me syllabuset e lëndëve tjera, por nga aspekti përmbajtësor të gjitha kërkesat përkatëse të VKM janë përmbushur.</i></p> <p><i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.4


Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe</p>	<p>Programi Master i arteve në Trombon dhe Mësuesi është program koherent dhe ngërthen në vete emërtimin, përmbajtjen, shpërndarjen e lëndëve dhe praktikatat të cilat mundësojnë aftësimin e studentëve për punësim si</p>





<p>praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>instrumentist /trombonist po ashtu edhe si mësimdhënës të instrumentit Trombon.</p> <p>Emërtimi i programit të studimit Master i Arteve në “Trombon dhe Mësuesi”, përcakton fushën e ngushtë të studimit, zhvillimin e krijimtarisë dhe integrimin me profilin mësuesi, sipas kodifikimeve kombëtare dhe ndërkombëtare (kodet tek Standardi I.2 kr.2, II.1 kr.8). Veprimtaria formuese e këtij programi është organizuar me qëllim të zhvillimit gradual kreativ muzikor dhe edukues-pedagogjik, ku mundëson njëkohësisht karrierën artistike dhe atë mësimdhënëse. Orët dhe ushtrimet individuale dhe me grupe të vogla, ndihmojnë në realizimin e objektivave dhe pershtatjen me tregun e punës.</p> <p>Në takim me studentë janë evidentuar se studentët trombonist tashmë janë të punësuar në Orkestrën e Forcave të armatosura.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.4.1.1.Ligj 10247, datë 4.3.2010 “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve ndryshuar me Ligjin nr. 23/2018, datë 10.5.2018)</p> <p>II.4.1.2 Korniza Evropiane e kualifikimeve</p> <p>II.4.1.3.Plani mësimor Programit të Studimit Master i Arteve Trombon dhe Mësuesi</p> <p>II.4.1.4.Syllabuset e Plani mësimor të Programit të Studimit Master i Arteve Trombon dhe Mësuesi.</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Lëndët /modulet, shpërndarja në vite e semestra dhe vlerësimi në kredite e orë mësimore është i qartë dhe mundëson arritjen e objektivave të programit.</p> <p>Programi i studimit Master i Arteve “Trombon dhe Mësuesi” realizohet në 2 (dy) vite akademike (4-katër semestra), me kohëzgjatje normale 15 javë secili semestër. Programi i studimit nevojat e tregut arsimor dhe artistik shqiptar, me: kompozitorë/tromboniste të kualifikuar, mësues/instrukturë të kurrikulave artistike për arsimin parauniversitar, pedagog në lëndët teoriko-praktike në FM, punonjës në institucione të ndryshme muzikore. Rezultatet e të nxënit janë në aftësimin e krijimtarisë së avancuar muzikore, njohjen e teknikave bashkëkohore, të jenë në gjendje të analizojnë vepra të ndryshme muzikore (dhe ato bashkëkohore), metodologjinë e mësimdhënies, si dhe të njohin natyrën e punës së drejtuesit artistik, redaktorit, konsulentit, administratës në institucione kulturore.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.4.2.1. VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”</p>

	<p>II.4.2.2 VKM Nr. 185, datë 25.03.2021 “Për ndryshimin e VKM datë 24.01.2018”</p> <p>II.4.2.3 Ligj 10247, datë 4.3.2010 “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve ndryshuar me Ligjin nr. 23/2018, datë 10.5.2018)”</p> <p>II.4.2.4 Korniza Evropiane e kualifikimeve</p> <p>II.4.2.5 Plani mësimor Bachelor Trombon</p> <p>II.4.2.6 Plani mësimor Programit të Studimit Master i Arteve Trombon dhe Mësuesi.</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Modeli i programit të studimit është i bazuar tek struktura e programit në Universitetin e Muzikës dhe Arteve Performuese të Vjenës. Struktura e programit është në përputhje me profilin e programit dhe lëndët janë të përshtatshme për aftësimin e studentëve si instrumentist /trombonist po ashtu përmes lëndëve pedagogjike përgatisin dhe aftësojnë studentët për aktivitetin profesional të fushës pedagogjike. Programi i studimit është hartuar në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës dhe Sistemit Europian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS), si model i programeve të ngjashme të europës perëndimore. Programi i kushton rëndësi të posacme aspektit praktik, sidomos lëndës speciale që zhvillohet në mënyrë individuale. Krahas aspektit teorik, analizave të veprave muzikore, e rëndësishme është edhe aspekti praktik, realizimi i veprave origjinale. Rëndësia që i jepet lëndës kryesore, si dhe lëndëve tjera, ky profil është në përputhshmëri me institucionet, si: Universiteti i Muzikës dhe Arteve Performuese Vjenë, Shkolla e Larë për Muzikë dhe Teatër Mynih, Universiteti i Arteve Helsinki-Akademia Sibelius.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.4.3.1. https://www.mdw.ac.at/studienplaene/?stNR=33472&stArt=infoite</p> <p>II.4.3.2. http://uart.edu.al/media/bachelor-flaut-oboe-klarinete-fagot-trombe-Trombon-trombon-bastube-21-22.pdf</p> <p>II.4.3.3. http://uart.edu.al/media/master-flaut-oboe-klarinete-fagot-trombe-Trombon-trombon-bastube-21-22.pdf.</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues,</p>	<p>Tek programi i studimit raporti i formimit teorik dhe praktik është i mjaftueshëm për të arritur objektivat formuese ,si dhe për transferim të studimeve ,mobilitetit dhe punësimit të studentëve ku kjo e fundit u evidentua edhe në takim me studentët meqë kishte studentë të punësuar në Orkestrën e Forcave të Armatosura. Në këtë program studimi, ndarja sipas veprimeve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik</p>

<p>transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>mundësojnë transferim të studimeve dhe mobilitet të studentëve në kuadër të projektit Erasmus+ (numri i shkëmbimeve Erasmus, tek Standardi I.3, Kriteri 2). Raporti midis lëndëve të formimit teorik dhe praktik është së paku 50/50.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.4.4.1.Plani mësimor Programit të Studimit Master i Arteve Trombon dhe Mësuesi</p> <p>II.4.4.2.Syllabuset e Planit mësimor Programit të Studimit Master i Arteve Trombon dhe Mësuesi</p> <p>II.4.4.3Statistikat e përgjithshme të International Credit Mobility.</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Bazuar në vizitë dhe evidencat e vëna në dispozicion nga UART, u konstatua se syllabuset përditësohen në mënyrë të vazhdueshme nga Njësia Bazë Interpretim, bazuar në Rregulloren e programit të studimit Master i Arteve “Trombon dhe Mësuesi”. Në përfundim të çdo viti akademik, diskutohen arritjet dhe problematikat e hasura duke evidentuar edhe mundësinë e rishikimit të përmbajtjes së lëndëve. Stafi akademik mund të ndryshojë përmbajtjen e lëndëve që ligjerojnë dhe i dërgojnë tek Njësia Bazë Interpretim Kërkesën për pasurimin e literaturës bazë dhe ndihmëse, e bën stafi akademik, që i përcillet bibliotekës së UART për sigurimin e literaturës së kërkuar. Megjithatë nga kontrolli i syllabuseve u konstatua që jo të gjitha syllabuset janë të përditësuara sipas formatit të parashikuar në këtë VKM. Syllabuset në përgjithësi janë të përditësuara sipas kërkesave të tregut të punës po ashtu edhe literature bazë është e përditësuar. Konstatohet se nuk ka mjaftueshëm literaturë shqipëtare në veçanti vepra solistike për instrumentin.</p> <p>Nga komenti I IAL vlerësohet angazhimi i Institucionit për iniciativa të tilla dhe pasurim të Bibliotekës me sa më shumë vepra të kompozitorëve shqiptarë.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.4.5.1.Plani mësimor Programit të Studimit Master i Arteve Trombon dhe Mësuesi</p> <p>II.4.5.2.Syllabuset e Planit mësimor Programit të Studimit Master i Arteve Trombon dhe Mësuesi.</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Riorganizimi i programit të studimeve Master i Arteve në Trombon dhe Mësuesi me anë të lëndëve artistike dhe lëndëve pedagogjike bëjnë të mundur përfitim të dijeve dhe aftësive për një instrumentist po ashtu edhe mësimdhënës të instrumentit. Përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave programi i studimit Master i Arteve “Trombon dhe Mësuesi” i ka të rregulluara me rregullore të programit të studimit. Pas përfundimit të</p>





	<p>programit studenti aftësohet në krijimtari, mësues/instruktorë të kurrikulave artistike për arsim parauniversitar, pedagog për lëndët teoriko-praktike pranë FM, si punonjës dhe në institucione kulturore/muzikore. Lëndët e ndara në module A-B-C-D-E aftësojnë studentin të jetë jo vetëm interpret/e por edhe edukator/e dhe organizator/e i/e aktiviteteve artistike.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.4.6.1 Plani mësimor Programit të Studimit Master i Arteve Trombon dhe Mësuesi</p> <p>II.4.6.2.Syllabuset e Planit mësimor Programit të Studimit Master i Arteve Trombon dhe Mësuesi.</p>								
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimeve mundëson vijimin e studimeve të ciklit të tretë po ashtu mundëson edhe punësimin e studentëve si Trombonist por edhe si Mësues i Trombons në shkolla. Sipas rregullores dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit që ka FM me institucionet dhe organizatat profesionale, krijohen mundësi për punësim.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.4.7.1 VKM Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë</p> <p>II.4.7.2 VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”,</p> <p>II.4.7.3 VKM Nr. 185, datë 25.03.2021 “Për ndryshimin e VKM 41 të datës 24.01.2018”.</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Struktura dhe organizimi i programit të studimit Master i Arteve “Trombon dhe Mësuesi” është hartuar në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës dhe Sistemit European të Transferimit dhe Mbledhjes së Kredive (ECTS). Ndarja e planit mësimor bëhet sipas veprimeve formuese dhe raporti midis lëndëve të formimit praktik dhe teorik, me raport 50/50. Pas përfundimit të studimeve Master, studentët mund të vazhdojnë me studime pasuniversitare si dhe janë të gatshëm për kërkesat e tregut.</i></p> <p><i>Ky standart përmbushet plotësisht.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet	Përmbushet plotësisht						
			X						


Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------


<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Vizita në UART, takimi me Drejtuesin e Departamentit Trombon, grupin e Vlerësimit të Brendshëm dhe studentët u konstatua se programi i studimit është në përshtatje me kërkesat e tregut. Departamenti i Interpretimit ku zhvillohet programi janë konsultuar me të diplomuarit, aktorët nga tregu i punës me qëllim të përmirësimit të përmbajtjes së programit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ ka sygjyeruar që në grupin punues për hartimin e përmbajtjes së programit të ketë një anëtar nga tregu i punës ose anëtar nga institucionet partnere</p> <p>Rekomandohet të ketë e kontakt më të shpeshtë dhe të sigurt me institucionet partnere për treg pune.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.5.1.2 Urdhër Nr. 616, datë 30.12.2016 i MASH Ngritja e grupit të punës për shqyrtimin e programeve të Ciklit të Dytë</p> <p>Propozimet dhe rekomandimet e grupit të punës</p> <p>II.5.1.3 Urdhër Nr. 821, datë 26.12.2018 i MASR Propozim i Njësisë Bazë DI për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të dytë Miratimi nga ana e Senatit Akademik.</p> <p>II.5.1.4. Komunikime shkresore me lidhur me Urdhër Nr. 821, datë 26.12.2018 i MASR.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti i muzikës, Departamenti i Interpretimit mbajnë kontakte të vazhdueshme me studentët të diplomuar .Kjo realizohet edhe përmes Projektit Erasmus+ CBHE me akronimin GRADUA i cili është burim i përhershëm i mbledhjes së të dhënave në mënyrë statistikore për të diplomuarit.</p> <p>Nga vizita në UART, takimi me përfaqësues të Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillit të Karrierës, ALUMNI, u konstatua që zyra ALUMNI këto tre vitet e fundit është më aktive, ku me ane të një formulari plotësohen kontaktet e studentëve dhe futen në një databazë. Krahas formularit nuk ka ndonjë mënyrë të mirëfilltë për të marrë të dhënat personale. Pedagogët ndihmojnë në përditësimin e të dhënave personale për ALUMNI. Kjo realizohet falë natyrës së punës individuale që kanë me studentë.</p> <p>Mendimi i studentëve rreth programit të mësimin realizohet nëpërmjet pyetësorit në fund të vitit mësimor.</p> <p>Rekomandohet databaza ALUMNI të ketë të dhëna më të detajuara rreth studentëve të diplomuar dhe të përditësohen. GVJ gjatë takimit me zyrën Alumni sygjeron të ketë më tepër angazhim për student alumni në përfshirjen e tyre në aktivitetet që organizohen nga Fakulteti.</p> <p>Nga komenti i Ial vlerësohet angazhimi i Institucionit se databaza ALUMNI është në përditësim të përhershëm .</p>

	DVV Evid.			
	II.5.2.1 Analizë nga NJSBC e pyetësorëve të studentëve.			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	<p>Departamenti i Interpretimit ku ofrohet programi i studimit gjatë proceseve të përmirësimit dhe përditësimit të programit konsideron propozimet dhe zhvillimet e fundit përmes shkëmbimit të përvojave mësimore akademike të anëtarëve të personelit akademik në kuadër të mobiliteteve ERASMUS+KA107, Masterklaseve të artistëve ndërkombëtarë që zhvillohen në Fakultet.Njësia Bazë Departamenti i Interpretimit përditëson dhe përshtat programin në bazë të kërkesave të kohës, posacërisht zhvillimit të komunikimit me institucionet e tjera artistike. Këtë program e ka dëshmuar me dëshmi për mbarëvajtje të Master Klasaveve dhe takimeve të punës të mbajtura nga pedagog dhe artistë të huaj.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.5.3.1.Statistika të Mobiliteteve Erasmus+ KA107 2018-2020 II.5.3.2.Statistika të Mobiliteteve Erasmus+ KA 107 2020-2022 II.5.3.3.Foto masterklase.</p>			
Konkluzione	<p><i>Konstatohet që Njësia Bazë Departamenti i Interpretimit është përgjegjëse për përditësimin dhe përshtatjen e programit. Realizohet me propozimet e marra nga pedagogët dhe studentët. Studentët plotësojnë pyetësor për programin mësimor në fundvit akademik. Rekomandohet të ketë kontakt më të sigurtë me institucionet partnere për treg pune.</i></p> <p><i>Nga Komenti I IAL vlerësohet angazhimi i Institucionit se databaza ALUMNI është në përditësim të përhershëm dhe nevojitet kohë për zhvillimin e teknologjisë për transformime digjitale .</i></p> <p><i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	GVJ vlerëson se Programi i studimit Master i Arteve në Trombon dhe Mësuesi ka përcaktuar qartë objektivat e studimit në përputhje me objektivat madhorë të Universitetit të Arteve .Objektivat kryesorë të programit të studimit janë hartuar në bazë të objektivave të parashikuara në Statutin e UART (Neni 4, 7), me ato të Rregullores së Përgjithshme dhe asaj Mësimore në FM (Neni 4) dhe në Rregulloren e Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj mësimore në Departamentin Interpretim (Neni 4).


	<p>DVV Evid.</p> <p>II.6.1.1. Statuti i Universitetit të Arteve II.6.1.2 Rregullorja e Universitetit të Arteve II.6.1.3.Rregullorja Mësimore e studimeve të Ciklit të Dytë Master.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Departamenti i Interpretimit administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë artistike të personelit akademik</p> <p>Gjatë takimit me zyrën e burimeve njerëzore si dokument shtesë u paraqit edhe Marrëveshja për orë të punës ku paraqiten veprimtaria e mësimdhënies dhe veprimtaria artistike e personelit akademik</p> <p>Nga vizita në UART, takimi me Drejtuesin e Departamentit, stafin akademik dhe përfaqësuesit e Sektorit të Projekteve Artistike dhe Shkencore konstatuam se, Fakulteti i Muzikës dhe Departamenti Interpretim administron këto veprimtari: mësimdhënies, artistike, kërkimore shkencore me liri akademike të personelit akademik. Orari mësimor përcaktohet nëpërmjet zv. dekanit, përgjegjësit të departamentit dhe sekretarisë mësimore. Ngarkesa mësimore shpërndahet nga drejtuesi i departamentit. Provimet zhvillohen sipas afateve të përcaktuara në Rregulloren e Fakultetit të Muzikës (Neni 44), pedagogu ka lirinë e sygjërimit të datës së provimit (Neni45). Bazuar në evidencat e prezentuara, Dep.Interpretim organizon aktivitete me pjesëmarrje të stafit akademik në koncerte, tryeza shkencore, leksione të hapura, puntori me studentë, etj.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.6.2.1,Ligjin 80/2015 Neni 3/2 https://qzb.gov.al/eli/ligj/2015/07/22/80</p> <p>II.6.2.2.Statutin e Universitetit të Arteve Neni 6/2 http://www.uart.edu.al/media/Statuti_uart_2021.PDF</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>GVJ pas takimit me studentët konstaton se Departamenti i Interpretimit ku ofrohet programi motivon studentët të angazhohen në aktivitete koncertale dhe projekte përmes bashkëpunimit me Orkestrën TKOBAP,Orkestrës së Forcave të Armatosura po ashtu edhe përmes mobilteteve të studentëve përmes projekteve ERASMUS +. Programi i studimit Master i Arteve “Trombon dhe Mësuesi” mundëson dhe motivon studentët në aktivitete artistike dhe kërkimore në bazë të planit mësimor dhe vlerësimeve më kredite (ECTS). Krahas koncerteve, pra aktivitetit artistike, studentët konstatuan që bëjnë edhe punime kërkimore.</p> <p>Krahas aktivitetit artistik rekomandohet t’i kushtohet vëmendje hulumtimit dhe prezantimit të temave të studentëve në tryeza apo konferenca të hapura.</p>


	DVV Evid.		
	II.6.3.1.Foto 60 vjetori i FM		
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	<p>GVJ nga takimet me Dekanin dhe Sektorin e projekteve ka evidentuar se universiteti ka mbështetur financiarisht aktivitetin artistik për kremtimin e 60 vjetorit të Fakultetit të muzikës me 60 ditë aktivitete artistike.</p> <p>Sipas evidences së paraqitur nga institucioni Fakulteti i Muzikës nuk administron në mënyrë të drejtpërdrejt të ardhurat nga aktivitetet e ndryshme. Nga vizita në UART, takimi me stafin akademik dhe Sektorin e Projekteve Artistike dhe Kërkimore, u konstatua që Universiteti i Arteve ka një fond për çdo njësi kryesore. Mbështetja financiare për aktivitet artistik dhe kërkimor të stafit akademik realizohet në bazë të kërkesës së bërë nga pedagogu.</p> <p>Rekomandohet të ketë përkrahje më tepër në realizimin e punimeve kërkimore dhe mbështetje për pjesëmarrje të stafit akademik në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.6.4.1.Urdhër administratori për Tërheqje Pajisjesh për Departamentin e Interpretimit nga magazine.</p> <p>II.6.4.2.VBA Vendim për miratimin e rishpërndarjes së të ardhurave të institucionit dhe ndryshim i regjistrit të prokurimeve në UART.</p>		
Konkluzione	<p><i>Gjatë takimeve me Drejtuesin e Departamentit, stafin akademik dhe përfaqësuesit e Sektorit të Projekteve Artistike dhe Shkencore konstatuam se, Fakulteti i Muzikës dhe Departamenti Interpretim administron këto veprimtari: mësimdhënies, artistike, kërkimore shkencore me liri akademike të personelit akademik. Studentët kanë aktivitete artistike dhe punime hulumtuese. Njësia Bazë Trombon së bashku me pedagogun bëjnë kërkesë në Universitet të Arteve për ndihmë financiare rreth punimeve hulumtuese dhe artistike. Rekomandohet hulumtimet të prezentohen sa më tepër në tryeza dhe konferenca shkencore/artistike.</i></p> <p><i>Ky standard përmbushet plotësisht</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të	Departamenti i Interpretimit mbështet grupet lëndore dhe aktivitetet koncertale. Konstatohet se Njësia bazë Interpretim përmes grupeve mësimore realizon objektivat e programit të studimit, duke përfshirë veprimtaritë artistike, kërkimore-shkencore. Kërkesat e grupit mësimor paraqiten pranë Administratës të UART.

<p>tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>GVJ ka analizuar dokumentacionin në evidencë dhe ka konstatuar se ka projekte artistike të përbashkëta në grup siç është realizuar aktiviteti i kremtimit të 60 vjetorit të Fakultetit të Muzikës po ashtu mbështetja realizohet edhe përmes projekteve ndërkombëtare.</p> <p>GVJ sugjeron të fuqizohen më tepër aktivitetet e përbashkëta të bashkëpunimit me Universitetet/Fakultetet e Arteve shqipfolëse në Rajon.</p> <p><i>Nga Komenti i IAL vlerësohen faktet se UART ka vëmendje në bashkëpunime për aktivitete të ndryshme me Institucionet homologe shqipfolëse në Rajon dhe uron se ato aktivitete të intensifikohen edhe më shumë.</i></p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.7.1.1 Foto nga kremtimet e 60 vjetorit të FM II.7.1.2 Foto nga aktivitetet e muzikës bashkëkohore në FM.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Njësia përgjegjëse angazhohet për realizimin e analizave, projekteve studimore duke angazhuar stafin akademik dhe studentët me mbështetje të projekteve të financuara nga fondet ndërkombëtare.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.7.2.1 Foto personeli akademik i FM si juri konkurseesh e komisione vlerësimi: Shkodër, Elbasan, Tiranë, Gjirokastrë.</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Njësia Bazë Trombon në bazë të dëshmimeve është konstatuar se ka organizuar aktivitete artistike për zhvillim dhe promovim të krijimtarisë së re muzikore. Gjatë vitit 2021-2022 Fakulteti i Muzikës për nder të 60 vjetorit të themelimit, ka organizuar mbi 60 aktivitete artistike dhe shkencore. Gjatë takimit me Dekanin u paraqiten dokumente shtesë të organizimit të aktiviteteve të përvitshme si Sezoni koncertal i cili realizohet çdo vit.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.7.3.1. Broshura-Kremtimi I 60 vjetorit të Fakultetit të muzikë II.7.3.2. Foto nga aktivitetet për 60 vjetorin e FM II.7.3.3. Foto Koncerte A.Z. Cajupi, Korçë II.7.3.4. Foto Takimi i Orkestrave në Elbasan.</p>

<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Bazuar në programin e studimit që është në përputhje me model programe europiane, konstatuam se ky program studimi ndihmon në formësimin e profesionistëve kombëtar dhe ndërkombëtar. GVJ vlerëson se programi i studimit formon profesionistë për tregun e punës si anëtar orkestre si rast konkret anëtar i Orkestrës së Forcave të Armatosura dhe Mësues Trombon në Shkolla.</p> <p>Ndërsa në tregun ndërkombëtar të punës janë anëtarë të orkestrës së të rinjve në kuadër të CEMAN.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.7.4.1 Foto nga koncerte CEMAN II.7.4.2.Foto nga koncerte të Filarmonisë së Tiranës</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>GVJ vlerëson se janë bërë përditësime në program studimi Master i arteve në Trombon dhe Mësuesi duke u bazuar në aktet ligjore në fuqi për tregun e punës në fushën e mësimdhënies në arte. Bazuar në evidencat e sjella konstatuam që riorganizimi i programeve të studimit, Cikli i dytë, ju mundëson studentëve të drejtën për punësim si mësimdhënës në lëndët e artit në institucionet e arsimit parashkollor, cikli i mesem i ulet dhe i mesem i lartë.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.7.5.1 Ligj Nr.10 171, datë 22.10.2009 Për profesionet e rregulluara II.7.5.2.Ligj Nr.10 357, datë 16.12.2010 Për një shtesë në Ligjin Nr.10 171, datë 22.10.2009 II.7.5.3.Urdhër Nr.100, dt.25.2.2022 Miratimi i Rregullores për Zhvillimin e praktikave profesionale të mësuesit II.7.5.4.Datë 25.02.2022 Rregullore për praktikat profesionale në mësuesi.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Bazuar në program të studimit, konstatojmë që Master i Arteve në “Trombon dhe Mësuesi” krahas krijimtarisë artistike, i aftëson studentët edhe në mësimdhënie në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Programi i studimit është i zbatueshëm në përputhje me aktet nënligjore dhe urdhrat e udhëzimit me fushën e mësuesisë.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>II.7.6.1 Ligj Nr.10 171, datë 22.10.2009 Për profesionet e rregulluara II.7.6.2.Ligj Nr.10 357, datë 16.12.2010 Për një shtesë në Ligjin Nr.10 171, datë 22.10.2009 II.7.6.3.Urdhër Nr.100, dt.25.2.2022 Miratimi i Rregullores për Zhvillimin e praktikave profesionale të mësuesit II.7.6.4.Datë 25.02.2022 Rregullore për praktikat profesionale në mësuesi.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në evidencat e vëna nga UART, konstatojmë që program i studimit Master i Arteve “Trombon dhe Mësuesi”, ndihmon studentët në</i></p>

	<i>formësimin e profesionistëve kombëtar dhe ndërkombëtar. Po ashtu, i aftëson studentët në mësimdhënie në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT


Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Programi i studimit Master i Arteve në Trombon dhe Mësuesi me anë të dokumenteve të paraqitura në evidencë i ka të përcaktuara format e mësimdhënies dhe mësimnxënies po ashtu të paraqitura në Planin mësimor të programit dhe në Syllabuse. Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion nga UART, konstatohet se format e mësimdhënies janë të paraqitura në Rregulloren e programit të studimit mbështetur në VKM Nr.145, dt. 10.03.2021. Pra, forma e mësimdhënies varion në varësi të përmbajtjes së lëndës, efikasitetit në transmetim, përmbushjes së njohurive dhe kompetencave të synuara dhe përshkrimit të lëndës (Syllabusit). Duke i marrë parasysh specifikat e programeve në Fakultetin e Muzikës, zhvillimi i mësimdhënies realizohet dhe varet nga numri i studentëve. Format e zhvillimit të mësimin janë: mësim individuale, leksione, seminare, ushtrime, praktika mësimore dhe praktika artistike.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.1.1.1 Statuti i Universitetit të Arteve, Neni 93/1 http://www.uart.edu.al/media/Statuti_uart_2021.PDF</p> <p>III.1.1.2 VKM 145, datë 10.03.2021: Për dhënien e statusit të veçantë për Universitetin e Arteve, Pika 8/a http://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/03/10/145</p>




	<p>III.1.1.3 Rregullore Mësimore e Ciklit të Dytë Master në Arte Neni 12/1/a http://www.uart.edu.al/media/VSA_Nr.17_dt.07.10.2021.PDF</p> <p>III.1.1.4 Rregullore e Programit të Studimit Master i Arteve në “Trombon dhe Mësuesi”</p> <p>III.1.1.5 Plani Mësimor i Programit të Studimit Master i Arteve në “Trombon dhe Mësuesi” http://uart.edu.al/media/master-flaut-oboe-klarinete-fagot-trombe-Trombon-trombon-bastube-21-22.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>GVJ ka analizuar sylabuset e lëndëve dhe konstaton se personeli akademik në Programin e studimit ofron metoda dhe forma të spikatura të mësimdhënies. Nga vizita në UART, takimi me stafin akademik u konstatua që personeli akademik bashkë me drejtuesin e Departamentit të Interpretimit janë përgjegjës për zhvillimin e procesit mësimor, qoftë individuale apo në grup. Përshtatja e metodologjisë së mësimdhënies bëhet në përputhje me individualitetin e studentit. Të gjitha specifikat e mësimdhënies për secilën lëndë janë të paraqitura në Syllabus.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.1.2.1 Syllabuset e Programit të Studimit Master i Arteve në “Trombon dhe Mësuesi”</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Departamenti i Interpretimit mbështet personelin akademik në sigurimin e hapësirave për studime, shkëmbime përvojave përmes mobilitetit me Universitetet brenda projekteve të fituara. Nga vizita në UART, takimi me stafin akademik dhe përfaqësuesit të sektorit të projekteve artistike dhe shkencore, konstatohet që institucioni udhëzon stafin akademik për pjesëmarrje në trajnime, përmirësimin e kompetencave didaktike, pedagogjike. Po ashtu, ka pasur shkëmbim të personelit akademik me universitetet e huaja përmes programit Erasmus. Ka organizime të Master-Classave, grupeve të punës muzikore. Aktivitetet individuale të stafit akademik janë të paraqitura në evidenca. GVJ sugjeron që të ketë më tepër trajnime pedagogjike për metodologjinë e avancuar të mësimdhënies.</p> <p><i>Nga komenti i IAL vlerësohet angazhimi i Institucionit për të zhvilluar më tepër trajnime për metodologjinë e avansuar të mësimdhënies.</i></p>
	<p>DVV Evid.</p>






	<p>III.1.3.1 Kërkesë për leje aktivitete kërkimore/artistike apo pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare.</p> <p>III.1.3.2 Foto nga masterklaset e profesorëve ndërkombëtarë në kuadër të Erasmus.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin interpret, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Nga analizimi i CV të personelit akademik GVJ vlerëson se programi i studimit ka staf të kualifikuar dhe kompetent të cilët përdorin metoda të ndryshme të mësimdhënies. Personeli akademik i programit të studimit Master I Arteve “Trombon dhe Mësuesi” ka eksperiencë në mësimdhënie dhe veprimtari artistike, duke përdorur metoda të avancuara dhe të ndryshme në mësimdhënie. Nga vizita në UART, takimi me studentët, u konstatua që mësimdhënia është interaktive, me diskutime, dhe shkëmbime mendimesh të ndërsjellta kreative.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.1.4.1 Struktura e Fakultetit të Muzikës dhe Departamenteve të tij.</p> <p>III.1.4.2 CV e personelit akademik sipas grupeve mësimore lëndore.</p> <p>III.1.4.3. Diplomati e titujve: Profesor, Profesor i Asociuar, Doktor, Doktor.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Departamenti i Interpretimit ofron forma e metoda të mësimdhënies të reflektuara këto përmes analizave vjetore të paraqitura në evidence. Po ashtu njësia bazë ka inkuadruar edhe studentin në grupin e vlerësimit të brendshëm për hartimin e raportit për programin e studimit. Nga vizita në UART, takimi me përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, u konstatua që Njësia Bazë Departamenti I Interpretimit në fundvit dërgon analizën e të gjitha veprimtarive të zhvilluara artistike dhe mësimore. Studentët reflektimin e tyre e bëjnë në pyetëtorin që realizohet në fundvit, si dhe sugjerimet e pedagogëve merren parasysh për përmirësim të vazhdueshëm të programit të studimit.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.1.5.1 Analizë vjetore e DI</p> <p>III.1.5.1 Analizë e pyetësorëve të studentëve:</p>

<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja..</p>	<p>Universiteti i Arteve, Fakulteti i Muzikës koordinojnë dhe bashkërendojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies ku kontribut të veçantë japin edhe Sektori mësimor, i Kurrikulave, Sekretaria mësimore si dhe Komisioni ad-hoc për Sigurimin e Cilësisë. Nga vizita në UART, takimi me përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përfaqësues të sektorit mësimor dhe kurrikulës, Informimit të Studentëve si dhe Sekretarinë mësimore, u konstatua se cilësia e stafit akademik është e rëndësishme për mësimdhënien. Për këtë arsye, institucioni mbështet dhe kontribuon në kualifikimin e pedagogëve, ku Departamenti i Interpretimit gjatë viteve 2019-2022 ka organizuar trajnime dhe Master-Class me pedagog nga: Austria, Australia, SHBA, Italia dhe Spanja.</p> <p><i>Mungojnë trajnime për metodat e avancuara apo inovative të mësimdhënies të organizuara në nivel institucional për personelin akademik</i></p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.1.6.1 Analizë e pyetësorëve të studentëve.</p> <p>III.1.6.1 Foto nga masterklasat dhe/ose koncertet e kolegëve nga institucionet partnere Erasmus+ KA107.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga vizita në UART, takimi me përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, përfaqësues të Sektorit mësimor dhe kurrikulës, Informimit të Studentëve si dhe Sekretarinë mësimore, si dhe evidencat e paraqitura, konstatohet që UART, Fakulteti i Muzikës garanton procesin e të nxënies dhe aftësimin artistik e shkencor për të arritur rezultatet e pritura. Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstaton se në bazë të dokumentacioneve të paraqitura në evidencë si Rregulloren e Programit të Studimit të ciklit të dytë Master dhe Rregulloren e UART bëhen testimet dhe vlerësimet e njohurive dhe përmes sistemit Pitagora bëhen publike për studentët. Konstatohet se, Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore në Fakultetin e Arteve paraqet gjitha kushtet e vlerësimit të njohurive</p> <p>Vlerësimi i studentit pasqyrohet në sistemin elektronik PITAGORA. Vendoset nota nga pedagogu dhe pas një kohe shtypet dhe firmoset procesverbali nga anëtarët e komisionit. Studentët kanë të drejtë 3 (tre)</p>


	<p>herë nënshtrihen provimit (sezoinin e vjeshtës, të pranverës dhe sezonin e verës). Format e vlerësimit bazohen në Rregullorja e programit të studimit.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.2.1.1.Rregulloren e UART III.2.1.2 Rregulloren e Programit të Studimit Ciklit të Dytë Master III.2.1.3 Rregullore e Programit të studimit Master i Arteve në “Trombon dhe Mësuesi” III.2.1.4. PITAGORA Manual përdorimi për studentë dhe pedagogë.</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari I lëndës/modulit.</p>	<p>Nga vizita në UART, takimi me studentët, u konstatua që në fillim të vitit akademik pedagogët prezantojnë përshkrimin e lëndës që lektrojnë (Syllabusin), ku përfshin përshkrimin, qëllimin, veprimtarinë, formën e kontrollit, metoda e vlerësimit, rezultatet e të nxënit.</p> <p>Poashtu, plani mësimor dhe të gjitha syllabuset, rregulloret publikohen në web-faqe të Universitetit të Arteve.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.2.2.1 Plani mësimor Master sipas Grupeve Mësimore III.2.2.2 Syllabuset e Planit Mësimor të Programit të studimit Master i Arteve në “Trombon dhe Mësuesi”.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi I njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke I dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ ka analizuar Rregulloren mësimore të studimeve të ciklit të dytë, Rregulloren e programit të studimit si dhe syllabuset që janë paraqiturë në evidence dhe është vërtetuar se format e kontrollit dhe vlerësimet e njohurive bëhen në disa mënyra varësisht nga specifikat e lëndës. Bazuar në Rregulloren e programit të studimit u konstatua që forma e vlerësimit është e rregulluar në mënyra të ndryshme, si bashkëbisedime, kontrolleve teknike, mbrojtjen e detyrave/projekteve individuale/grupore, mbrojtjen e praktikave profesionale, kolokuim provime përfundimtare, mbrojtje të temave të diplomave, aktivitete artistike, etj,</p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.2.3.1 Planin mësimor Master i Arteve në “Trombon dhe Mësuesi” III.2.3.2Rregulloren Mësimore të Studimeve të Ciklit të Dytë III.2.3.3Rregulloren e Programit të studimit Master i Arteve në “Trombon dhe Mësuesi” III.2.3.4 Plani mësimor Master sipas Grupeve Mësimore.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në Rregulloren e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore në Fakultetin e Arteve si dhe Rregulloren e programit të studimit, u konstatua që janë të paraqitura gjitha kushtet e vlerësimit të njohurive.</i></p> <p><i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi III.3


Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi I njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari I lëndës/modulit.</p>	<p>Sipas syllabuseve të paraqitura në evidencë testimet dhe vlerësimet bëhen në mënyrë periodike gjatë gjithë vitit akademik me forma të ndryshme të kontrollit varësisht nga specifikat e lëndës. Nga vizita në UART, takimi me drejtuesin e Departamentit të Interpretimit, stafin akademik dhe studentët, u konstatua që vlerësimi i studentëve bazohet në syllabusin e lëndës, ku vlerësimi realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësim përfundimtar. Vlerësimi përfundimtar është I hartuar në përputhje me Rregulloren e programit të studimit.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.3.1.1 Syllabuset e Planit Mësimor të Programit të studimit Master i Arteve në “Trombon dhe Mësuesi”</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Në bazë të specifikave të lëndës Institucioni shmang format e ndryshme të abuzimit në vlerësimin e njohurive si në vlerësimin e lëndëve artistike bëhen me interpretim në kohë reale duke përdorur fletë provimi vjetor për lëndë artistike ndërsa vlerësimet tek lëndët teorike bëhen me sekretim të emrit të studentit .Vlerësimet reflektohen në systemin Pitagora.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.3.2.1 Fletë provimi vjetor lëndë individuale artistike dhe/ose në ansambël, model . III.3.2.2MA.FO procedurë sekretimi të tezës së provimit teorik.</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar I lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i lëndëve bëhet në përputhje me syllabusin dhe Rregulloren Mësimore të Studimeve të Ciklit të Dytë Master duke përdorur modele si Fletë provimin vjetor, vlerësimin e praktikës mësimore. Bazuar në analizën e syllabuseve të lëndëve, u konstatua që forma e vlerësimit përfundimtar është në përputhje me syllabuset, që parashikohen në Rregulloren e programit të studimit.</p> <p>DVV Evid.</p>

	<p>III.3.3.1 Fletë provimi vjetor lëndë individuale artistike dhe/ose në ansambël, model</p> <p>III.3.3.2 Vlerësim i praktikës artistike, model</p> <p>III.3.3.3 Vlerësim i praktikës mësimore, model</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi I njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është I nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nga vizita në UART, takimi me stafin akademik, studentët dhe sekretarinë mësimore, u konstatua që për vlerësim përfundimtar merren parasysh të gjitha arritjet, aktivitetet artistike, vlerësimet e pjeshme dhe të vazhduara, praktika mësimore. Specifikat e programit, me mësim individual dhe grupe të vogla mundësojnë kontaktin më të afërt mes pedagogut dhe studentit, gjë që mundëson diskutimet për përmirësim. Nga raporti i GVB vlerësohet se vlerësimet përfundimtare shoqërohen edhe me komente përmirësimi dhe këshillimi për studentin.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.3.4.1 Fletë provimi vjetor lëndë individuale artistike dhe/ose në ansambël, model</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Bazuar në Rregulloret e Universitetit të Arteve dhe Fakultetit të Muzikës, Kodin e etikës janë marrë masat për të shmangur kopjimin dhe plagjiaturën. Institucioni ka nxjerrë Rregullore Mësimore të Ciklit të Dytë Master dhe Kodin e Etikës me të cilat shmangin plagjiaturën dhe kopjimin në provime.</p> <p>Gjatë takimit GVJ është informuar se Institucioni më herët ka poseduar sistemin antiplagjiaturë .GVJ sugjeron që ky sistem antiplagjiat të rifunksionalizohet.Evidentimi I plagjiaturës në punim diplome është e parashikuar në Rregullore të programit sipas parashikimeve të VKM Nr.879, dt. 18.12.2019. Programet e Departamentit Interpretim, me specifikën e organizimit të procesit mësimor që ka, e bën të pamundur kopjimin dhe plagjiaturën.</p> <p>Nga komenti i IAL vlerësohet angazhimi i Institucionit për të rivendosjen e sistemit antiplagjiaturë në Platformë.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.3.5.1 Kodi i Etikës,</p> <p>III.3.5.2 Rregulloren Mësimore të Ciklit të dytë Master</p> <p>III.3.5.3 Planit mësimor Master “Trombon dhe Mësuesi”</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Sipas dokumenteve të paraqitura në evidencë, GVJ konstaton se vlerësimet e njohurive bazohen në meritë dhe paraqiten me kohë në platformen Pitagora sipas Rregulloreve mësimore .Nga vizita në UART, takimi me sekretarinë mësimore, u konstatua që Universiteti I Arteve përdor sistemin elektronik PITAGORA në menaxhimin e studimeve. Sistemi u mundësua nga Rrjeti Akademik Shqiptar,</p>

	<p>administrohet nga Sektori I IT me RASH, në koordinim me Sekretarinë Mësimore. Sekretaria Mësimore ngarkon të dhënat administrative didaktike, të dhënat mbi ofertën akademike, provimet dhe notat etj. Sistemi përdoret edhe nga pedagogët në përpilimin e procesverbaleve dhe studentët në informim lidhur me aktivitetin akademik. Personeli administrative përcjell të dhënat në Rektorat ku të dhënat statistikore përpunohen.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.3.6.1 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve</p> <p>III.3.6.2 Rregullore e Programit të studimit Master i Arteve në “Trombon dhe Mësuesi”</p> <p>III.3.6.3 Platformën PITAGORA.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Sipas Rregullores së studimeve të Ciklit të Dytë Master dhe Sistemit Pitagora, Institucion garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit. Nga vizita në UART, takimi me sekretarinë mësimore dhe drejtuesin e Departamentit Interpretim u konstatua që pas provimit përfundimtar komisioni duhet ta vendos notën jo më larg se 5 (pesë) ditë pune. Konsultimet mundësohen mes studentit dhe pedagogut për vlerësimin e marrë. Po ashtu, student ka të drejtë ankese në Dekanat të FM dhe ndiqen procedurat e Rregullores së ciklit të II-të.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.3.7.1 Rregullore Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve,</p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni I vlerësimit dhe më pas nga komisioni I posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Sipas Rregullores Mësimore të Ciklit të Dytë Master dhe Sistemit Pitagora, Institucioni garanton të drejtat e studentëve për të ndjekur procedura për çdo kërkesë dhe ankimim lidhur me vlerësimin e kontrollit të dijeve. Studentët, pas përfundimit të provimit kanë të drejtë të sqarohen nga komisioni për vlerësimin përfundimtar, si dhe të drejtën e rishikimit të tezës.</p> <p>Studentët kanë të drejtë ankese në Dekanat të FM, që ndjek procedurat e parashikuara në Rregulloren e ciklit të II-të (Evidencë nr. 5 Neni 20). Ankesa e paraqitur shqyrtohet nga Dekani, I cili kërkon sqarime nga komisioni I provimeve dhe studenti dhe merr vendimin përkatës të formës së prerë.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.3.8.1</p>

	Rregullore Mësimore të Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Arteve.		
Konkluzione	Nga vizita në UART, takimi me sekretarinë mësimore, drejtuesin e Departamentit Interpretim, stafin akademik, studentët, u konstatua që vlerësimi i studentëve realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësim përfundimtar, e gjithë kjo bazuar në syllabus të lëndës. Vlerësimi përfundimtar pasqyrohet në sistemin elektronik PITAGORA. Konsultimet mundësohen mes studentit dhe pedagogut për vlerësimin e marrë. Po ashtu, studenti ka të drejtë ankese në Dekanat të FM që ndjek procedurat e Rregullores së ciklit të II-të. Ky standard përmbushet plotësisht.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive interprete e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi I studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Duke u bazuar në dokumentacionin në evidence DVV, programi i studimit është në vijim logjik të programit të studimit Bachelor në Trombon i cili zhvillon aftësitë profesionale -artistike, zhvillon kapacitetet pedagogjike. Programi I studimit Master I Arteve “Trombon dhe Mësuesi” zgjat 2 vite akademike me 120 kredite (ECTS). Plani mësimor dhe syllabuset janë të hartuara për zhvillimin e aftësive profesionale, artistike dhe teorike-shkencore. Zhvillohet më tej krijimtaria muzikore, teknikat bashkëkohore interprete, mendimi kritik, metodologjia e mësimdhënies dhe praktika artistike. DVV Evid. III.4.1.1 Plani mësimor Bachelor Trombon III.4.1.2 Plani mësimor Master “Trombon dhe Mësuesi” III.4.1.3 Syllabuset e Planit mësimor Master “Trombon dhe Mësuesi”
Kriteri 2. Programi I studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Njësia përgjegjëse që ofron programin e studimeve Master në Trombon dhe Mësuesi synon që përmes lëndëve të teknologjisë së informacionit dhe lëndëve humane ,sociale në planin mësimor të zhvillojnë aftësi të veçanta në fushën e teknologjisë. Programi i studimit, ka lëndë mbështetëse të teknologjisë .Studentët janë të njohur paraprakisht me programet muzikore. Lëndët me karakter psiko-pedagogjik aftësojnë fushën e komunikimit mësimdhënës-nxënës. DVV Evid.



<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>III.4.2.1 Plani mësimor Master “Trombon dhe Mësuesi”</p> <p>Nga vizita në UART, takimi me pedagog dhe studentë konstatohet se, Fakulteti I Muzikës, duke marr parasysh specifikën që ka në mësimdhënie, kontakti i afërt që ka pegagog-student, e kanë më lehtë analizën e punës për të evidentuar arritjet dhe për të përcaktuar detyrat për përmirësime. Analizat zhvillohen në nivel grupi mësimor, departamenti dhe në dekanatin e FM .Në syllabuset e lëndës speciale janë të paraqitura kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti pas përfundimit të lëndës.</p> <p>Nga GVJ sugjerohet që të vendosen edhe në syllabuset e tjera kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti. Detyrimet përmbyllëse i bëhen të qarta studentit në fillim të vitit akademik dhe që në fillim të studimeve.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.4.3.1 Syllabuset e Planit mësimor Master “Trombon dhe Mësuesi”</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Grupi I vlerësimit të jashtëm konstaton që personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën qoftë individuale dhe ate grupore në realizim, zgjidhje të problemeve, zhvillimin e ideve kreative, hulumtime, artistike, praktika mësimore.</p> <p>Universiteti i Arteve mbështet idetë innovative duke rritur bashkëpunimin dhe mobilitetin e studentëve me institucione tjera arsimore.</p> <p>Në programin e studimit Master i Arteve në Trombon dhe Mësuesi ,mësimdhënia bazohet më tepër në proces praktik ku arrin kuotën në 76% apo 92 ECTS kredi nga gjithënjë 120 ECTS .</p> <p>Poashtu syllabuset e lëndëve artistike, procesi praktik është më i shprehur të cilat mbështeten në punën individuale dhe në grup.</p> <p>Tek Plani mësimor nuk është i qartë fondi I orëve 2.5 orë në javë për lëndët Metodologji e mësimdhënies dhe Teoritë e të nxëniet dhe menaxhim klase dhe fondi i orëve 1, 1 tek lënda Histori muzike (gjysma e dytë e shek.XX).</p> <p>GVJ sugjeron të ketë fond të orëve të plota tek këto lëndë.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.4.4.1 Syllabuset e Planit mësimor Master “Trombon dhe Mësuesi”</p> <p>III.4.4.2 Plani mësimor Master “Trombon dhe Mësuesi”.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe</p>	<p>Nga vizita në UART, takimi me personelin akademik, u konstatua se si ata efektiv edhe ata me kontratë në Fakultetin e Muzikës zhvillojnë orë të hapura dhe seminare mbi teknologjinë muzikore dhe hulumtimet artistike, si në nivel Fakulteti ashtu edhe në institucione kombëtare dhe</p>

<p>teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>ndërkombëtare. Gjatë vitit 2022 personeli akademik realizoi orë dhe seminare të hapura përmes masterklaseve me rastin e kremtimit të 60 vjetorit të Fakultetit të Muzikës që janë paraqiturë në evidence. DVV Evid.</p> <p>III.4.5.1.Foto nga 60 vjetori i FM – Aktivitet me muzikë bashkëkohore III.4.5.2. Model Marrëveshje për organizimin e kohës vjetore të punës për personelin akademik të FM dhe DI, sipas Grupeve Mësimore.</p>		
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Nga vizita në UART, takimi me drejtuesin e programit, pedagogët, studentët dhe përfaqësuesit e Sektorit të Projekteve Artistike dhe Shkencore, u konstatua që ka aktivitete të shumta artistike brenda FM. Studentët inkurajohen të marrin pjesë në koncerte dhe aktivitete tjera artistike dhe kërkimore. Njësia Bazë Interpretim organizon koncertin e studentëve dhe siguron regjistrimin profesional. Njësia Bazë parashikon fonde të veçanta për mbështetje të aktiviteteve të studentëve. Personeli akademik në syllabuset e lëndëve ofrojnë literature inovative dhe bashkëkohore. Gjatë vizitës GVJ sugjeron të institucioni të nxit personelin akademik interpret/kompozitorët të krijojnë vepra solistike për instrumente enkas për programin e studimit.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.4.6.1. Foto nga laborator i audios. III.4.6.2.Foto nga koncerti me muzikë bashkëkohore.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Konstatohet se programi i studimit Master I Arteve "Trombon dhe Mësuesi" garanton rritjen e aftësive interprete e hulumtuese tek studentët dhe synon zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek studentët.</i> <i>Tek Plani mësimor nuk është i qartë fondi I orëve 2.5 orë në javë për lëndët Metodologji e mësimdhënies dhe Teoritë e të nxënies dhe menaxhim klase dhe fondi i orëve 1,1 tek lënda Histori muzike(gjysma e dytë e shek.XX).</i> <i>GVJ sugjeron të ketë fond të orëve të plota tek këto lëndë ngase fondi me 2.5 orë për javë është i paqartë.</i> <i>Ky standard përmbushet kryesisht</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	





Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Institucioni duke u bazuar në Rregulloren mësimore të programit të studimeve dhe në Rregulloren e ciklit të dytë të studimeve Master të publikuara në web faqen e Universitetit ndjek procedurat për detyrimet përmbyllëse. Konstatohet se, Njësia Bazë Interpretim harton në bazë të Rregullores së programit procedurën për detyrimet përmbyllëse dhe pranimin në provimin përfundimtar. Këto detyrime përmbyllëse janë të publikuara në web-faqen e Universitetit të Arteve. Detyrimet janë plotësimi i kritereve detyruese të lëndëve, përbushja e grafikut të ndërvarësisë së lëndëve, frekuentimi i formave mësimore, përfundimi i praktikave mësimore, regjistrimi i provimit në sekretarinë mësimore, pagesa e tarifës së shkollimit. Procedurat e diplomimit janë të parashikuara në Rregulloren e Programit të Studimit.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.5.1.1. Rregulloren Mësimore të Programit të Studimit http://www.uart.edu.al/media/VSA_Nr.17_dt.07.10.2021.PDF.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Nga vizita në UART, takimi me përfaqesues të Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve dhe Sekretarisë mësimore, u konstatua se informimi i studentëve rreth detyrimeve përmbyllëse të lëndëve në vitin përkatës, kryhet nga Sekretaria mësimore ku datat e provimeve publikohen në ambient të FM dhe në web-faqe, si dhe bëhen të ditur nga pedagogët e lëndëve me udhëzime përkatëse për detyrimet përmbyllëse.</p> <p>Procedurat e propozimit dhe dorëzimit të Temës së Diplomës janë të rregulluara në Rregulloren e programit por mungon një udhëzues teme diplome kur kjo e fundit përmbyllet me projekt kërkimor.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.5.2.1. Formular regjistrimi në provim përmbyllës.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni I posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Konstatohet se, Rregullorja e programit të studimit paraqet procedurat e përgatitjes dhe paraqitjes së punimit përfundimtar/ diplomës. Procedurat miratohen nga Dekani dhe caktohet komisioni I mbrojtjes. Mbrojtja e titullit Master I Arteve “Trombon dhe Mësuesi” bëhet me realizimin e mbrojtjes artistike të krijimtarisë muzikore, si dhe hartimin e tezës teorike, me mbështetje të krijimtarisë artistike. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit të diplomës bazohet në testimet e qëndrueshmërisë së njohurive të dhëna dhe progresit gjatë gjithë vitit akademik poashtu edhe përmbyllja e Diplomës organizohet në dy pjesë: me një punim teorik -tezë të shkurtër dhe program i interpretimit që studenti interpreton para Komisionit si dhe publikut në sallë.</p>



	<p>DVV Evid.</p> <p>III.5.3.1. Syllabuset e Planit mësimor Master “Trombon dhe Mësuesi”.</p> <p>Nga vizita në UART, takimi me personelin akademik dhe drejtuesin e departamentit Trombon , u konstatua që udhëheqjen e diplomës e bën pedagogu që e udhëheq lënden speciale. Formulari përkatës për dorëzim diplome bazohet në Rregulloren e programit ku firmoset nga udhëheqësi i diplomës, kryetari i grupit mësimor dhe përgjegjësi i Njesisë Bazë Interpretim.</p> <p>Zhvillimi i mësimit për mbrojtje të temës së diplomës zhvillohet në mësim individual, ku garantohej cilësia e rezultateve. Udhëheqësi i diplomës ndihmon studentin në përcaktimin e programit të diplomës, ndihmon në fazën studimore nga ana metodologjike po ashtu përgatitjen e interpretimit përmbyllës para komisionit dhe publikut.</p> <p>Studenti duhet të dorëzojë punimin artistik (Trombonet-partiturat) dhe tezën teorike, jo më pak se 10 ditë para datës së mbrojtjes së diplomës. Po ashtu dokumentet shoqëruese duhet të jenë të miratuara dhe nënshkruara nga udhëheqësi i diplomes.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.5.4.1. Syllabuset e Planit mësimor Master “Trombon dhe Mësuesi”.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi I diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi I asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Fusha e studimit mbështet projektet artistike dhe kërkimore të studenteve me kapacitet të plotë për të ju përgjigjur ndryshimeve që sjellin kërkesat e tregut. Projektet artistike institucionale apo edhe individuale mbështeten edhe nga departamentet kryesisht në drejtim të mbështetjes infrastrukturore. Për shkak të specifikave që ka programi ky kriter nuk mund të realizohet në programet e fushës së interpretimit muzikor.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Nga vizita në UART, takimi me Sekretarinë mësimore, drejtuesin e departamentit Trombon, u konstatua se pas mbrojtjes së diplomës Kryetari i Komisionit mbledh anëtarët e komisionit vlerësues dhe vendosin pikët e vlerësimit në formular dhe nënshkruajnë dokumentin. Pasi mbledhet mesatarja e vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit, komisioni e komunikon diplomantin/en mbi notën përfundimtare. Cdo gje dokumentohet dhe i bashkangjitet procesverbali i mbrojtjes së diplomës, ku regjistrohet nota përfundimtare.</p> <p>Nëse vlerësimi është negativ apo mungon studentin/ja në mbrojtje të diplomës, ai/ajo mund të mbrojë temën brenda afateve të caktuara sipas Rregulloreve të programit të studimit. Në evidence paraqitet modeli i vlerësimit të diplomes duke u bazuar në Rregulloren Mësimore të Ciklit të dytë Master.</p> <p>DVV Evid.</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	

	<p>III.5.6.1. Model vlerësimi diplome Planit mësimor Master “Trombon dhe Mësuesi”.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Bazuar në evidenca të Rregulloreve, konstatohet se lëshimi i diplomës bëhet brenda afatit të caktuar kohor, jo më gjatë se 6 (gjashtë) muaj nga mbrojtja e diplomës. Ndërkohë, mund t’i lëshohet një vërtetim me listën e notave. Diploma plotësohet në zbatim me Udhëzimin nr. 25, dt. 10.11.2017.</p> <p>Studenti/ja pajiset me diplomën përkatëse, suplementin e diplomës miratuar nga Senati (hartuar në përputhje me Udhëzimin e MAS Nr.11, dt. 2.4.2020) dhe listën e rezultateve të studimit. Në evidence paraqiten modeli i diplomës dhe modeli i Suplementit të diplomes duke u bazuar në Rregulloren Mësimore të Ciklit të dytë Master.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.5.7.1. Model Diplome III.5.7.2. Model Suplementi diplome III.5.7.3. Udhëzimin Nr. 11, datë 2.4.2020 Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së suplementit të diplomës dhe listën e rezultateve të studimeve. III.5.7.4. Udhëzimi nr. 25, datë 10.11.2017 Për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Nga vizita në UART, takimi me Sekretarinë mësimore, u konstatua që ruajtja e dokumentacionit të studentëve bëhet në letër (hardcopy) dhe në formë elektronike. Hardcopy dokumentacioni ruhet në Arkiv-protokoll të UART. Sekretaria mësimore e Fakultetit të Muzikës ruan dokumentacionin në Regjistrin Themeltar dhe Regjistrin e Arritjeve, ku ruhen të gjitha të dhënat personale dhe vlerësimet e studentëve gjatë studimeve. Një kopje e diplomës së studentit dërgohet në Bibliotekë të Universitetit të Arteve. Në përputhje me Ligjin Nr.9887, dt.10.03.2008 mundësohet verifikimin e dokumentacionit të studentëve.</p> <p>Institucioni ruan dokumentacionin e studentit dhe në përputhje me Ligjin për të dhëna personale është i mundshëm të verifikohet.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>III.5.8.1. Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, i ndryshuar Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga vizita në UART, takimi me drejtuesin e programit të studimit, personelin akademik dhe sekretarinë mësimore, konstatuam se UART, Fakulteti I Muzikës, departamenti Interpretim ndjek procedurë të qartë të reflektimit të detyrimeve përmbyllëse të studentit dhe pajiset me Diplomë, suplementin e diplomës miratuar nga Senati (hartuar në përputhje me Udhëzimin e MAS Nr.11, dt. 2.4.2020) dhe përpunimin e rezultateve të studimit.</i></p> <p><i>Ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>



Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve		
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	N/A		
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më të njohurive dhe kompetencave profesionale.	N/A		
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	N/A		
Konkluzione	<i>Programi i studimit që vlerësohet është "Master i Arteve" dhe jo Master Profesional. Ndaj ky standard nuk aplikohet për këtë program studimi.</i>		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
	X		


Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës III	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X



Prongolli


**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Gjate vizitave në institucion, si dhe bazuar në evidencat, për vitin akademik 2019-2020, 2020-2021 dhe vitin akademik 2021-2022, konstatohet që, personeli akademik i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit ka ekspertizën e nevojshme lidhur me mbarëvajtjen cilësore të procesit të mësimdhënies.</p> <p>Në vitin 2019-2020, për programin e studimit kemi të angazhuar 12 personel akademik, nga të cilët 4 janë me titullin Prof.Dr, 2 janë me titullin Prof. As, 1 janë me gradën Doktor dhe 4 janë MA.</p> <p>Në vitin 2020-2021 për programin e studimit kemi të angazhuar 9 personel akademik nga të cilët 3 Prof.Asoc.Dr. , 2 Dr., 4 As Lektor -Ma.</p> <p>Në vitin 2021-2022 për programin e studimit kemi të angazhuar 11 personel akademik nga të cilët 4 Prof.Dr., 2 Prof.Asoc,2 DR, dhe 3 As.lektor</p> <p>Bazuar në të dhënat e mësipërme evidentohet plotësimi I kuadrit ligjor lidhur me ekspertizën dhe nivelin e pedagogëve të përfshirë në procesin mësimdhënës në një program të ciklit të dytë, por bazuar në Udhëzimin Nr. 1, 665 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, pika 3/c Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi”.</p> <ul style="list-style-type: none"> • 10 PAE/1 PAK v.a.2021-2022 91% me 0.9% • 7 PAE/2 PAK v.a.2020-2021 77.7% me 32.3% • 8 PAE/4 PAK v.a. 2019-2020 50% me 50% <p>Përqindjet sipas viteve akademike janë që të gjitha të prekura dhe mund të ishin rregulluar lehtësisht. Cenimin më të madh në shpërndarjen staf me kohë të plotë dhe staf me kohë të pjesshme e ka pasur viti akademik 2019-2020.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>IV.1.1.1. Cv e personelit akademik</p>

<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>IV.1.1.2. Tabelat e stafit akademik për vitet 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022 .</p> <p>Konstatuam se personeli akademik me kohë të plotë, pranë Departamentit Interpretim mbulon ngarkesën dhe zhvillon aktivitetin mësimdhënës, bazuar në legjislacionin në fuqi dhe Konform VKM Nr. 29, date 10.09.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”. Personeli akademik në bazë të marrëveshjes për kohën e punës vjetore të personelit mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore. Edhe në rastet kur kemi mbingarkesë të pedagogëve mbi normativën e lejuar nga ana e njësisë bazë dhe zyrës së burimeve njerëzore janë marrë masat që të depozitohet një formular I nënshkruar nga pedagogu ku ai pranon të kryejë lëndën por pa marrë pagesë për mbingarkesën.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>IV.1.2.1 Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë. https://arsimi.gov.al/web-content/uploads/2018/09/Udhezimi-nr.-29-dt-10.9.2018.pdf</p> <p>IV.1.2.2. Kopje e një modeli marrëveshje për kohën e punës vjetore të personelit akademik .</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Bazuar në evidencat konstatuam se, institucioni derdh rregullisht kontributet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe bazuar në takimin me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe në takimin me personelin akademik, të programit të studimit, evidentohet qëndrueshmëri kontraktuale, si dhe korrektesë në pagesat e kryera, bazuar në legjislacionin në fuqi.</p> <p>Personeli akademik i rregulltë dhe i angazhuar nënshkruajnë kontratën me UART sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>IV.1.3.1 Kopje e një modeli marrëveshje për kohën e punës vjetore të personelit akademik</p> <p>IV.1.3.2. Model draft kontrate të stafit akademik me kohë të pjesshme</p> <p>IV.1.3.3. Model kopje listpagese me sigurimet e paguara.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën,</p>	<p>Institucioni ndjek procedurat rekrutimi dhe vlerësimi sipas kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara në konkurs. Konstatuam se, vlerësimi për përzgjedhjen e personelit realizohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, bazuar në propozimin e departamentit, e cila përditëson në mënyrë të vazhdueshme të dhëna që lidhen me aktivitetin kërkimor të stafit akademik, CV e tyre akademike, kontratat, formularët e parashikimit dhe realizimit të ngarkesës mësimore.</p>

<p>strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik, bazuar në kuadrin ligjor ajo arkivon dosjet përkatëse për çdo anëtar të PAE dhe PAK, si dhe marrëveshjet kontraktuale të nënshkuara me stafin akademik në përfundim të gjithë procesit të rekrutimit.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>IV.1.4.1. Model dosje për rekrutim personeli akademik.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Sipas udhëzimeve për strukturat e brendshme akademike dhe administrative, Institucioni përcakton organizimin e brendshëm akademik dhe administrativ. U konstatua se, Institucioni, ka punonjës ndihmës në realizimin e programit të studimit në përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike mësimore. Kontributi i tyre ka konsistuar në ndihmën e dhënë pedagogëve dhe studentëve, veçanërisht gjatë periudhës së pandemisë dhe mësimin online.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>IV.1.5.1. Udhëzimin Nr. 27, datë 29.12.2017 Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë.</p> <p>IV.1.5.1.2. Rregullore mësimore e Fakultetit të Muzikës .</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni mbledh dhe ruan të dhënat e personelit akademik në dosjet e personelit .Nga shqyrtimi i RVB dhe takimet fizike, konstatuam se, institucioni mbledh dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit akademik sipas organigramës së UART, në lidhje me strukturën analitike të FM, në rang njësie dhe personelin përkatës. Departamenti, mbledh, ruan dhe përditëson angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik të përfshirë në program dhe personat përgjegjës për organizimin e programit të studimit.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>IV.1.6.1. VKM Nr. 329 datë 12.4.2017 Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik</p> <p>IV.1.6.2. Udhëzimi Nr. 29, datë 10.09.2018,</p> <p>IV.1.6.3. Kopje e një modeli marrëveshje për kohën e punës vjetore të personelit akademik sipas grupeve mësimore</p> <p>IV.1.6.4. Model dosje të aktivitetit kërkimor artistik e interpretativ</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të</p>	<p>Duke u bazuar në marrëveshjet për praktikant profesional me shkollë, Institucioni vë në dispozicion personelin e duhur për kryerjen e praktikave. Institucioni "UART", ka një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me ZVA dhe shkollë të arsimit parauniversitar në të gjithë vendin. Kryesisht, Institucioni, ka marrëveshje bashkëpunimi me ZVA Tirane, ku shihet se janë të përcaktuara qartë detyrat e secilit aktor.</p>


<p>duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>UART merr përsipër: deklarin e studenteve praktikante lidhur me sigurimet shendetesore, sigurimin e pedagogut mentor, ndihmën e nevojshme për studentët praktikantë, ndjekjen e punës së studentëve dhe vlerësimin e studentëve për paketën e praktikës.</p> <p>ZVAT, merr përsipër, mundësimin e zhvillimit të praktikave për studentët, sipas shkollave dhe nivelit të tyre të studimit, si dhe në dhënien e mendimeve për vlerësimin e studentëve praktikantë.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>IV.1.7.1. Kopje e marrëveshjes për praktikat profesionale me ZVA Vlorë</p> <p>IV.1.7.2. Model vlerësimi i praktikës profesionale.</p>			
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me ZVA për praktikat profesionale ku praktikat mësimore studentët I realizojnë në shkolla Realizimi i praktikave mesimore, zhvillohet sipas një protokollit të mirëpërcaktuar lidhur me rolin e institucionit dërgues dhe institucionit pritës. Formularet dhe dosja e praktikës janë pjesë përbërëse e vlerësimit final të studentit, si dhe paraqesin në mënyrë të qartë veprimtaritë, orët, mënyrat dhe modelet e aplikuara gjatë zhvillimit të procesit mësimor.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>IV.1.7.1.Kopje e marrëveshjes për praktikat profesionale me ZVA Vlorë</p> <p>IV.1.7.2.Model vlerësimi i praktikës profesionale,</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, qartësisht të pasqyruara, GVJ, konstaton se, personeli akademik efektiv dhe me kontratë, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit. Konstatuam gjithashtu, se Drejtoria e Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik, si dhe se departamenti, mbledh, ruan dhe përditëson angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik të përfshirë në program</i></p> <p><i>Konstatuam se realizimi i praktikave mësimore, zhvillohet sipas një protokollit të mirëpërcaktuar lidhur me rolin e institucionit dërgues dhe institucionit pritës.</i></p> <p><i>Nga komenti i IAL vlerësohet angazhimi i Institucionit për përmirësimin e raportit të lektorëve të jashtëm me atë efektivë dhe shpreson që ky përmirësim të jetë në vazhdimësi.</i></p> <p><i>Komenti merret parasysh dhe GVJ ndryshon vlerësimin nga kryesisht në plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>





Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Institucioni siguron hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore të Programit.</p> <p>Gjatë vizitës së hapësirave GVJ konstatoj se ka hapësira të mjaftueshme dhe adekuate për mësim dhe ushtrime individuale të studentëve. Nga vizita e mjediseve të institucionit konstatoj se, lëndët e programit, zhvillohen në kampusin universitar, si dhe infrastruktura e universitetit përmban auditore me përmasa të mjaftueshme, lidhur me nevojën specifike të programit. Të gjitha auditoret janë të pajisura me mjetet specifike të mësimdhënies në këtë program studimi, të cilët mundësojnë mësimdhënien me metoda të ndryshme si praktike edhe teorike.</p> <p>Evid.</p> <p>IV.2.1.1. Vizita në mjedise</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës së hapësirave GVJ konstatoj se ka hapësira të mjaftueshme dhe adekuate për mësim dhe ushtrime individuale të studentëve.</p> <p>Të gjitha sallat janë të pajisura me intrumentin si dhe Salla e auditoriumit kishte pajisje digjitale. Konstatoj se, disa nga mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, biblioteka janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Institucioni, ka kapacitet infrastrukturor dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve të programit, duke përmbushur kështu standardet e duhura për student.</p> <p>Evid.</p> <p>IV.2.2.1. Vizita në mjedise</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e</p>	<p>Nga vizita e mjediseve, konstatoj se, auditorët mësimorë janë të pajisur me mjetet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor (banka, karrike, pajisje audiovizive, tabela etj). Disa nga sallat e leksioneve, në të cilat zhvillohen lëndët e programit të studimit janë të pajisura me videoprojektorë.</p> <p>Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, konstatoj se, mjediset mësimore si zyra, salla leksionesh, laboratorë, sallë konferencash janë të</p>

<p>praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>pajisuara me mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të kurseve që ofron ky program studimi për aftësimin teorik dhe detyrat praktike formuese të programit të studimit.</p> <p>Evid.</p> <p>IV.2.3.1. Vizita në mjedise</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni I arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Nga vizita në institucion, konstatoam se, infrastruktura qendrore e shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit në Institucion përbëhet nga 6 pajisje server dhe 3 njësi network storage. Aktualisht, në institucion janë të instaluar mbi 50 pajisje kompjuterike të ndërlidhjes së rrjetit kompjuterik në tërësi, të përbërë nga switch-e, media converter-a, router, firewall, transmetues me valë të brendshme dhe të jashtëm.</p> <p>Rezulton se, disponohen pesë laboratorë të përpunimit dhe prodhimit filmik të pajisura me infrastrukturë rrjeti kompjuterik fizik dhe valor, si dhe me pajisje kompjuterike workstation / monitore / videoprojektore / infrastrukture audio, etj,</p> <p>Rezulton, gjithashtu, se pranë Bibliotekës së UART ndodhet laboratori i informatikës, i pajisur me softuerët përkatës në mënyrë që të "i shërbejë sa më mirë programit mësimor me një kapacitet afërsisht 25 vendesh. Ai është në parametra të mirë për realizimin e nevojave të programit të studimit në lidhje me përdorimin e teknologjisë në drejtim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Laboratori, rezulton se shërben për zhvillimin e detyrave dhe projekteve të kursit të studentëve, por edhe për aktivitete të ndryshme nga vetë departamenti. Një punonjës i IT-së është në dispozicion të mirëmbajtjes së laboratorit dhe rrjetit kompjuterik të UART, gjatë kohës së zhvillimit të orëve mësimore, si dhe ofron asistencë teknike për studentët dhe stafin akademik.</p> <p>Evid.</p> <p>IV.2.4.1. Vizita në mjedise</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat</p>	<p>Konfirmojmë që, institucioni ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore parauniversitare, për realizimin e praktikave mësimore të studentëve të programit të studimit. Me mundësitë dhe infrastrukturën që ka, UART, ka kapacitete të mjaftueshme për të organizuar veprimtari praktike apo veprimtari të posaçme vetë ose edhe në bashkëpunim me institucione të tjera.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>IV.2.4.1. Kopje e marrëveshjes për praktikën profesionale me ZVA Vlorë</p> <p>IV.2.4.1. Model vlerësimi i praktikës profesionale.</p>

spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.							
Konkluzione	<i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatojmë se institucioni siguron mjediset e mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore dhe asaj artistike. Gjithashtu, konstatojmë se institucioni, ka kapacitetet e duhura infrastrukturore dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve në këtë program studimi, duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara. Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					


Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Literatura bazë dhe ndihmëse në shërbim të programit të studimit plotëson të gjitha kriteret e vlefshmërisë dhe përdorimit. Ajo gjëndet si fizikisht, ashtu edhe në rrugë elektronike, duke garantuar kështu një shfrytëzim të mirë të saj për realizimin e detyrave dhe projekteve të kursit si dhe realizimit të aktiviteteve të ndryshme artistike.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion konstatojmë se, literatura për realizimin e këtij program studimi përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Literatura bazë; - Literatura ndihmëse; - Periodik të huaj; - Periodik shqiptarë; - Enciklopedi, diksionerefjalor; - Dorëshkrime të kompozitorëve shqiptarë; - Koleksione periodike në fushat e artit; - Punime teorike universitare dhe pasuniversitare të studentëve dhe pedagogëve; - Monografi shkencore të fushave të ndryshme mbi muzikën, letersinë, artin dhe kulturën në gjuhën shqipe. - GVJ sugjeron që në të ardhmen Biblioteka të pasurohet edhe më tepër me literature të kompozitorëve shqipëtar dhe vlerëson angazhimin e IAL se do të punojë në këtë drejtim. <p>DVV Evid.</p> <p>IV.3.1.1. Katalogu online i BSHUA</p>

<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë vizitës së GJVJ në Bibliotekën e Fakultetit të muzikës u konstatua se ka botime të reja të fituara nga fondet ndërkombëtare si partiture për interpretim nga Edicioni Urtex .Konstatohet se, njësia kryesore me propozim nga njësia bazë çdo fillim viti akademik paraqet listën e kërkesave të titujve për pasurimin e fondit të titujve në shërbim të realizimit të programeve të studimit që ofron.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>IV.3.2.1. Katalogu online i BSHUA</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës së GJVJ në Bibliotekën e Fakultetit të muzikës u konstatua se personelit administrativ punon me përkushtim për të ofruar studentëve shërbimet e duhura poashtu, për kohën e provimeve Biblioteka është e hapur edhe ditëve të shtunë.Nga vizita në institucion, konstatuam se, biblioteka është e konceptuar në disa mjedise të ndërlidhura së bashku. Përveç mjedisit ku është vendosur fondi I librave, gjenden gjithashtu edhe dy salla laboratorë si, Salla e fondit të hapur dhe Media Library të pajisura me infrastrukturë rrjeti kompjuterik.</p> <p>Në ambientet e bibliotekës ndodhet gjithashtu salla “Multimedia”, e cila është e pajisur me 20 kompjutera që kanë akses në internet të pajisur me software në mbështetje të punës individuale studimore.</p> <p>Shërbimi elektronik i bibliotekës ofrohet nëpërmjet dy sistemeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sistemi i menaxhimit, përmes të cilit biblioteka kryen katalogimin dhe shfaqjen përmes shfletuesit publik (OPAC) për audiencën e gjërë dhe. • Sistemi i arkivit digjital, ku përdoruesit mund të shfletojnë materialet elektronike. <p>DVV Evid.</p> <p>IV.3.3.1. Model hapje llogarie online për Arkivin digjital të BSHUA</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës së GJVJ në Bibliotekën e Fakultetit të muzikës u konstatua se ka literature të mjaftueshme për zhvillimin e programit Master i Arteve në Trombon dhe Mësuesi.</p> <p>Konstatohet se, Biblioteka është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaj, libra apo revista shkencore të nevojshme, të përshtatshme për mbulimin e kurseve dhe veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës të programit të studimit.</p> <p>Biblioteka e UART luan rolin e një biblioteke speciale për të gjithë fushat e artit në Shqipëri.</p> <p>Bazuar në vizitën në institucion, rezulton se numri i teksteve përfshin libra teorik të artin skenik, regji, skenografi, kostumografi, filmi,</p>

	<p>koreografi; koleksionin e dramës: drama, përkthime, komedi, periodikë si dhe letërsi shqip dhe huaj dhe shqipe si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 45. 000 libra, albume, partitura & parte; • 40.000 File (audio/ pdf) – muzike e huaj dhe shqiptare ; • 1000 doreshkrime; • 897 perkthim dhe adaptim; • 400 drama te perkthyer ne shqip • 68 tituj (periodik i huaj); • 42 tituj (periodiku shqiptare); • 20 Titles (gazeta). • Fondi referues – enciklopedi, diksionere, tituj 150 +100 fjalor • Letersia shqipe – 3040 tituj • Letersia e huaj – 2646 tituj • Drama, perkthime teorike, ne shaptilograf, printime – 1000 tituj • Estetika, filozofi, psikologji, sociologji – 200 tituj • Seriale – 1455 tituj • Teoria e Drames, regjisë – 700 tituj • Histori teatri – 308 tituj • Filmi – 460 tituj • Teatri – 409 tituj • Koreografi – 300 tituj <p>Një vend të rëndësishëm në fondin e saj zënë fondet speciale si :</p> <ul style="list-style-type: none"> • 1000 dorëshkrime të kompozitorëve shqiptare. • 3000 koleksione periodike në fushat e artit. • 1500 punime teorike universitare dhe pasuniversitare • 1400 fotokopje të partëve dhe partiturave të formacioneve orkestrale. • 750 tituj monografi shkencore të fushave të ndryshe mbi muzikën, letërsinë, artin dhe kulturën në gjuhën shqipe. <p>DVV Evid.</p> <p>IV.3.4.1. Katalogu online i BSHUA</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për</p>	<p>GVJ vlerëson mundësin e ofruar për student nga Institucioni për përdorimin e bibliotekës online BSHUA dhe IMSLP.Nga vizita në institucion, konstatuam se, menaxhimi I librave të bibliotekës është I</p>


<p>studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>realizuar nëpërmjet skedarëve dhe gjithashtu nëpërmjet platformës online për të krijuar kushte për akses të shpejtë, të barabartë e pa pagesë për studentët.</p> <p>Rezulton se, periodiku retrospektive– kërkimi bëhet në katalogun manual dhe shërbehet në fondin e mbyllur për t’u studiuar në sallën e leximit me fonde të hapura përgjatë orarit 8:00 – 19:00.</p> <p>Ndërsa periodiku koherent, rekorde bibliografike me të dhëna të hollësishme mbi përmbajtjen, kërkimi bëhet online, kurse shërbim ofrohet në fondi I mbyllur dhe shfletohet në sallën e leximit me fonde të hapura përgjatë orarit 8:00 – 19:00.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>IV.3.5.1. Biblioteka online specifike për programin e studimit Master i Arteve në “Trombon dhe Mësuesi” është IMSLP - PETRUCCI MUSIC LIBRARY https://imslp.org/wiki/Main_Page</p> <p>IV.3.5.2. Arkiva digjitale e BSHUA aksesueshme pas regjistrimit online.</p> <p><i>http://arkiv.uart.edu.al/password-login</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, rezultoi se, institucioni ka krijuar mundësi për aksesimin e studentëve në platformën on-line të bibliotekës ku mund të paraqesin kërkesat e tyre për shfrytëzimin e librave fizik dhe digjital. Institucioni i ofron studentëve mundësi aksesimi nëpërmjet abonimit në revista shkencore online si:</p> <ul style="list-style-type: none"> ◦ Years 2007 – Grover Music; ◦ Years 2008 -2013 – Cambridge journals online; Oxford English Dictionary online; Oxford reference online; ◦ Years 2012 – 2013 – Alexander Street Press; Jstor; Muse; Eäiley; AKSH – Ebscohost <p>For free access</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ IMSLP – Petrucci Music Library. http://imslp.org/ ▪ ILSan – Il sistema Archivistico Nazionale. http://san.beniculturali.it ▪ Culturetheque Instituti Francais www.culturetheque.com <p>si dhe nëpërmjet katalogut online të Bibliotekës universitare uart.edu.al/katalog_biblio dhe arkivës dixhitale të Bibliotekës së Universitetit të Arteve arkiv.uart.edu.al.</p> <p>Evid.</p> <p>IV.3.6.1. Vizita në Bibliotekë</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, konstatoam se, Biblioteka funksionon nëpërmjet Regjistrimit themeltar të inventarit të koleksioneve bibliotekare, i cili është dokumenti bazë që pasqyron të gjitha materialet bibliotekare që kanë hyrë në bibliotekë që në krijimin e saj në mënyrë kronologjike. Regjistri i inventarit është dokument mbi bazën e të cilit bëhet inventari</p>

<p>dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>i bibliotekës. Në të rregjistrohet çdo njësi që hyn në bibliotekë dhe merr një numër që e identifikon atë si njësi unike midis tërë koleksionit të bibliotekës.</p> <p>Biblioteka ka vënë në dispozicion të studentëve aksesimin nëpërmjet katalogu online të Bibliotekës së Universitetit të Arteve uart.edu.al/katalog_biblio dhe arkivës dixhitale të Bibliotekës së Universitetit të Arteve arkiv.uart.edu.al si dhe oraret e shërbimit, për të qënë në dispozicion të nevojave të studentëve. Biblioteka punon përgjatë orarit 8:00 – 19:00.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>IV.3.7.1. Informacion zyrtar në faqen e UART http://www.artacademy.al/index.php?pg=faqe&id=88&niveli=55</p>		
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Konstatohet se, biblioteka dhe njësitë bazë kanë një komunikim të vazhdueshëm për pasurimin e fondit fizik dhe elektronik të fondit të titujve. Njësia kryesore me propozim nga njësia bazë çdo fillim viti akademik paraqet shkresat e kërkesave të titujve për pasurimin e fondit të titujve në shërbim të realizimit të programeve të studimit që ofron.</p> <p>Biblioteka bën përditësime periodike për shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit nëpërmjet Arkivës Dixhitale të BSHUA, nga ku rezulton se, për vitin akademik 2021-2022 kanë shfrytëzuar fondit online të bibliotekës 1073 përdorues, nga të cilët 704 nga Shqipëria, 148 nga Kosova, 46 nga USA, 26 nga Italia etj.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>IV.3.7.1. Katalogu i veprave të fondit fizik dhuruar nga Henle-Verlag</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se, Biblioteka e UART ka një fond shumë të pasur fizik dhe elektronik me tekste mësimore në gjuhën shqipe dhe të huaj si dhe dorëshkrime, libra dhe revista shkencore të nevojshme, të përshtatshme për mbulimin e kurseve dhe veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes të programit të studimit, por vërehet një mungesë fondi dedikuar kurseve me karakter psiko-pedagogjik që ofrohen në të gjitha programet e ciklit të dytë të studimeve që ofrohen në këtë institucion, si rrjedhojë: Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>


Standardi IV.4
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni disponon me sistemin online Pitagora ku gjenerohen të gjitha të dhënat e studentëve nga regjistrimi e deri te diplomimi. Gjithashtu, konstatuam që sekretaria mësimore disponon statistika vjetore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit; • të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit viti akademik; • të dhëna për transferimet dhe çregjistrimet; • të dhëna për ecurinë akademike të studentit; • numrin e ECTS të grumbulluara për çdo vit akademik; • të dhënat e studentëve që diplomohen; <p>DVV Evid.</p> <p>IV.4.1.1. Platforma online http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=963&niveli=68</p> <p>IV.4.1.2. Njoftime http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=292&niveli=69</p> <p>IV.4.1.3. Pranimet në UART http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=133&niveli=75</p> <p>IV.4.1.4. Pajisja me Diplomë http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=134&niveli=77</p> <p>IV.4.1.5. Drejtoria e BNJ dhe Informacion, Protokoll dhe Arkivë http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=110&niveli=5</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit</p>	<p>Bazuar në Raportin Vjetor të Departamentit, rezultojnë se, institucioni disponon informacion të plotë për aktivitetin mësimor dhe atë kërkimor-shkencor të personelit akademik.</p> <p>Ndërsa në marrëveshjeve në funksion të programit të studimit shprehet qartë aktiviteti që institucioni ka, në rang njësie kryesore dhe njësie bazë</p>

<p>administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>me partnerët të cilët janë të angazhuar në realizimin e këtij program studimi.</p> <p>Drejtorja e Burimeve Njerëzore, disponon dhe arkivon dokumentacionin për personelin akademik, personelin ndihmës akademik, personelin administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Ndërsa Departamenti monitoron dhe nxit aktivitetin mësimor dhe kërkimor-shkencor.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>IV.4.2.1. Një model akt marrëveshje për kohën vjetore të punës IV.4.2.2. Një model dosje të aktivitetit ndihmës akademik me karakter mësimor, artistik e shkencor IV.4.2.3. Një model dosje të aktivitetit ndihmës akademik me karakter administrativ.</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni siguron akses në informacione e dokumente për të gjithë studentët dhe personelin akademik duke përdorur emailin e postave nga Sekretaria Mësimore si dhe sistemin Pitagora. Nga takimi me sekretarinë mësimore, konstatoam se, ajo ruan të gjithë dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna elektronikisht në formatin e Regjistrimit Themeltar të Studentëve dhe Regjistrin e Diplomimit.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>IV.4.3.1. Model shkëmbimi të emailave të postës me sekretarinë mësimore dhe specialisten për sistemin PITAGORA IV.4.3.2. Model shkëmbimit të emailave të postës me Sektorin e IT IV.4.3.3. Model i të dhënave të përgjithshme dhe/ose regjistrimit të të dhënave të studentëve lidhur me frekuentimin, mënyrën e vlerësimit, vlerësimin, gjenerimin e procesverbalit të provimit në sistemin PITAGORA.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Format që përdorin personeli akademik për shkëmbim informacioni me studentët janë sistemi online Pitagora dhe platforma TEAMS .Nëpërmjet sistemit PITAGORA, rezulton se, institucioni menaxhon sistemin e regjistrimeve, kurrikulën, grafikun e provimeve online, hedhjen dhe ruajtjen e vlerësimit, fazën e paradiplomimit dhe diplomimit. Studentëve u jepen të dhënat e aksesit të llogarive individuale për regjistrimin përfundimtar në mënyrë që ata të aksesojnë atë në çdo kohë, nga çdo pajisje që ka lidhje interneti. Sekretaria mësimore mban në sistem edhe të dhëna personale të studentëve si numra telefoni, adresa emaili dhe ruan kontakte të vazhdueshëm me studentët në raste njoftimesh. Të dhënat personale të tyre si datëlindja, qyteti i lindjes, adresa kontakti, etj.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>IV.4.4.1. Model flete provimi gjeneruar nga PITAGORA</p>


	<p>IV.4.4.2.Model vendosje në kalendar të një eventit online TEAMS IV.4.4.3.Model Statistike përdorimi të platformës TEAMS për leksion online</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi I menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sipas dokumenteve të paraqitura në evidence Institucioni posedon monitorim të vazhdueshëm për aktivitetin akademik dhe administrative. Bazuar në Rregulloren e Fakultetit, si dhe të dhëna, të evidentuara në institucion, rezultojnë se, institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, në hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar, përmbushjen e zhvillimit të leksioneve dhe aktiviteteve të tjera mësimore.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>IV.4.5.1. Model listë prezence IV.4.5.2.Model evidence orësh të realizuara IV.4.5.3.Model të një raporti mbi përdorimin e platformës TEAMS</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>GVJ ka analizuar web faqen e Institucionit dhe konstaton se informacionet e duhura janë të publikuara. Konfirmojmë që, në faqen zyrtare të internetit të UART janë publikuar të dhëna në lidhje me strukturën organizative, stafin akademik, veprimtaritë, bazën ligjore, kurrikulat dhe kalendarin akademik, kriteret e përzgjedhjes së studentëve si dhe njoftimet të ndryshme që lidhen me veprimtarinë akademike të UART, në dy gjuhë: shqip dhe anglisht.</p> <p>http://www.uart.edu.al/index.php?lang=1 http://www.uart.edu.al/index.php?lang=2</p> <p>DVV Evid.</p> <p>IV.4.6.1. Statuti i UART http://www.uart.edu.al/media/Statuti_uart_2021.PDF IV.4.6.2.Informacion programi i studimit “Trombon dhe Mësuesi” http://uart.edu.al/media/master-flaut-oboe-klarinete-fagot-trombe-Trombon-trombon-bastube-21-22.pdf IV.4.6.3.Model Informacion personeli akademik http://uart.edu.al/media/2021%20-%20FM%20PERSONEL%20AKADEMIK.pdf IV.4.6.4.Informacion aktivitete të ndryshme http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=1111&niveli=92</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet sistemit PITAGORA, duke administruar të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre. Konstatohet, gjithashtu, se institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ, në hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar, në faqen e tyre zyrtare të web-it në gjuhën shqipe dhe atë angleze duke përmbushur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara.</p>

	<i>Sa më sipër, ky standard përmbushet plotësisht.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Departamenti i interpretimit ku edhe ofrohet program Master i Arteve në Trombon dhe Mësuesi ka një plan për mbështetje financiare dhe raport financiar të kostosë së Njesis.</p> <p>GVJ gjatë vizitës ka sugjeruar se duhet të ketë mbështetje më të madhe financiare për veprimtari dhe aktivitete artistike sidomos për aktivitete ndërkombëtare .Bazuar në RVB, institucioni harton çdo fillim viti buxhetin financiar I cili, pasi hartohet nga Administratori, miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi I Administrimit, ku deklarohen kostot e shpenzuara, të ardhurat dhe përcaktimi I mbulimit financiar për programet e studimit dhe njësinë bazë.</p> <p>UART, harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare. Në raport pasqyrohen të dhëna financiare në lidhje me koston për secilin program studimi, duke bërë kështu edhe një vlerësim të ecurisë dhe vazhdimësisë së programeve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e vendosura. Në to përfshihet kosto për çdo program studimi, kostot operationale dhe të mirëmbajtjes, etj.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>IV.5.1.1. Ligjin nr. 10/296, datë 08.07.2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin,</p> <p>IV.5.1.2.Model Raporti financiar të kostove</p> <p>IV.5.1.3.Model Plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit.</p>

<p>Kriteri 2. Plani I financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit,</p>	<p>Njësia përgjegjëse ka një plan financiar ku janë të ndara vijat buxhetore të parapara për periudhën e caktuar. Konfirmojmë që, institucioni ka paraqitur një plan financiar për këtë program studimi. Ndersa plani i financimit të dërguar për këtë program studimi specifikon shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, gjithashtu shpenzimet për fondin e bibliotekës, si dhe shërbimeve të lidhura me procesin mësimor dhe shkencor të Departamentit.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>IV.5.2.1 Vendim SA për Plan Buxhetin e financimit të Programeve të studimit (model)</p> <p>IV.5.2.2. Vendim BA për Plan Buxhetin e financimit të Programeve të studimit (model)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim financiar, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Këto tri vitet e fundit Institucioni nuk iu ka nënshtruar ndonjë auditimi periodik mbi vlerësimin e gjendjesë financiare. Konstatuam që, UART, nuk i është nënshtruar një auditimi financiar, për shkak se disponon një procedurë të posaçme për realizimin e Auditit të brendshëm, siç parashikon VKM Nr. 83, Datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriteve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin financiar”.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Sipas udhëzimit të paraqiturë në evidence institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. Konstatuam se, në mbyllje të çdo viti kalendarik, institucioni dokumenton raportin financiar për 1 vit kalendarik dhe konstatuam se në bilancin e vënë në dispozicion, pasqyrohen të gjitha të dhënat përsa i përket realizimit të buxhetit, si dhe shpenzimeve të kryera.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>IV.5.4.1 Udhëzimi Nr. 5, datë 19.02.2018 “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë” http://qbz.gov.al/eli/udhezim/2019/10/21/24</p> <p>IV.5.4.2. Një model raportimi vjetor http://uart.edu.al/media/Analiza%20vjetore%20e%20UART%202019-2020.pdf http://uart.edu.al/media/VSA22dt23122021.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për</p>	<p>Institucioni garanton qëndrueshmërinë dhe kapacitetet financiare duke u bazuar në Ligjet në fuqi dhe planet për mbështetje financiare për program</p>

<p>zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të posaçme financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>studimi. Konstatohet se, bilanci i vënë në dispozicion nga institucioni dëshmon se UART, garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen, për këtë program.</p> <p>DVV Evid.</p> <p>IV.5.5.1 Ligjin nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor https://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/07/22/80</p> <p>IV.5.5.2.Ligjin nr. 10/296, datë 08.07.2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, https://infrastruktura.gov.al/ep-content/uploads/2017/10/Ligj_10296_8.7.2010.pdf</p> <p>IV.5.5.3.Model Raporti financiar të kostove</p> <p>IV.5.5.4.Model Plani për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vizitën në institucion, si dhe në evidencat, konstatohet se institucioni harton çdo vit një raport në lidhje me transparencën financiare, ku pasqyrohen të dhënat dhe gjendja financiare, ku përfshihen kostot për çdo program studimi, kostot operacionale dhe të mirëmbajtjes, duke përmbyshur kështu standardet dhe kriteret ligjore të përcaktuara. Sa më sipër, ky standard përmbyshet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbyshjes së standardit</p>	<p>Përmbyshet pjesërisht</p>	<p>Përmbyshet kryesisht</p>	<p>Përmbyshet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbyshjes së standardit</p>	<p>Përmbyshet pjesërisht</p>	<p>Përmbyshet kryesisht</p>	<p>Përmbyshet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	------------------------------	-----------------------------	--

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p>Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Vlerësimi dhe raportimi anëtarëve të GVB në lidhje me këtë kriter dhe metodologjia e adresimit të referencave e përdorur nga ana e tyre e mbështetur kryesisht në evidenca të përgjithshme, pa iu referuar akteve, nenëve apo pikave të caktuara të dokumentave rregullatore nuk nxjerr në pah qartësisht mënyrën sesi institucioni ka hartuar dhe ndjek politika të qarta të ndjekjes së mbarëvajtjes së studentëve që në hyrje dhe deri në diplomimin e tyre. Argumentimi i bërë nga grupi i punës i përfshirë në</p>



hartimin e RVB përmend statutin, **Rregulloren e UART**
[http://www.uart.edu.al/media/VSA Nr.20 dt.07.10.2021.PDF](http://www.uart.edu.al/media/VSA_Nr.20_dt.07.10.2021.PDF)
rregulloret e njësisve kryesore , atyre bazë si dhe akte të tjera rregullatore të miratuara nga senati **DVV Rregullore mësimore e Ciklit të Dytë**
[http://www.uart.edu.al/media/VSA Nr.17 dt.07.10.2021.PDF](http://www.uart.edu.al/media/VSA_Nr.17_dt.07.10.2021.PDF)

Referenca të tilla si **DVV Ligji për arsimin e Lartë 80/2015, VKM 145 Për dhënien e statusit të vecantë UART**, përbëjnë dokumente rregullatore kornizë për gjithë arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë dhe arsimimin në Universitetin e Arteve, por nuk përbëjnë dokumente evidentues të procedurave që ndiqen tashmë në UART dhe nuk dëshmojnë për realizueshmërinë dhe shkallën e përmbushjes së këtij kriteri. Nga ana tjetër **DVV. Evid. Statuti UART dhe Evid. Plani i Zhvillimit Strategjik** vetëm pjesërisht qartësojnë nga ana procedurale praktikatat e formalizuara të vëna në zbatim për të monitoruar progresin e studentëve nga hyrja në dalje.

Gjithsesi nga konsultimi edhe i dokumenteve të përgjithshëm mund të konstatohet që Universiteti i Arteve në perputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore ka hartuar dhe zbaton politika dhe procedura të cilat mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve të Fakultetit të Muzikës dhe Njësisë Baze DI, që nga aplikimi për pjesëmarrje në konkurrim e deri në diplomim, përmes një baze ligjore dhe dokumentacioni respektiv mbështetës.

Dokumentat e referencës së mësipërm vetëm pjesërisht qartësojnë nga ana procedurale praktikatat e formalizuara të vëna në zbatim për të monitoruar progresin e studentëve nga hyrja në dalje. Një evidencë e mirë për tu sjellë këtu do të ishte procedura e rakordimit të punës së zyrës së pranimeve me departamentet me këshillarët akademike/pedagogët e speciales dhe me përfaqësuesen për Alumni për të ndjekur të gjithë rrugëtimin e studentëve. Megjithatë nga vizita në institucion GVJ ka konstatuar që ekziston një bashkërendim i mirë edhe pse jo i formalizuar në dokumentacion i punës për të ndjekur mbarëvatjen e studentëve nga regjistrimi deri në diplomim. Procedurat që ndjekin kandidatët për studimet e ciklit të dytë pranë këtij fakulteti janë të detajuara dhe rregullatore. Këta procedura përfshijnë njoftimin dhe hapjen e aplikimeve, publikimin e kriterëve të konkursit, publikimin e informacionit mbi planin mësimor dhe përmbajtjen e syllabuseve, si dhe publikimin e tarifës së studimeve për program të parë dhe të dytë studimi.


DVV Evid.

Njoftim për hapjen e aplikimeve për studimet e ciklit të dytë dhe tarifatat përkatëse.


<http://uart.edu.al/index.php?id=1044>

Publikimi i Rregullores dhe Kriteret e konkursit të pranimit


	<p>http://uart.edu.al/medfrit1Rregulloret%20dhe%20kriteret%20.MASTER%202022-2023%20Flvfpd/</p> <p>Informacioni mbi Planin Mesimor, oreve ne auditor dhe krediteve per çdo lende</p> <p>http://uart.edu.al/media/1naster-fiaut-oboe-klarinete-[agot-trornbe-Trombon-trombon-bast11be-2l-22.pdf</p> <p>Informacioni i detajuar programin e lendes (syllabusin)</p> <p>Tarife e studimeve Master i Arteve ne "Trombe dhe Mesuesi", Program i pare dhe i dyte studimi</p> <p>/Jtp://www.uurt.edu.al/n1ediu/Turi/ut%20e%10shlël!imit%20ne%20tabele%20perrnbledhese%202012-2023.pdf</p> <p>Evid.V.I.I.I.Syllabuset e planit mësimor Trombon e mësuesi</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Kriteret procedurat, dhe informacionet mbi aktet rregullatore të universitetit të cilët garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët studentë të programit të studimit janë lehtësisht të aksesueshme, transparente dhe publike në faqen zyrtare të webit të Universitetit të Arteve DVV. Evid. Faqja Web e UART si dhe vihen në dispozicion nga zyrat përkatëse të institucionit të arsimit të lartë.</p> <p>Evidenca DVV</p> <p>V 1.2.1 Ligjin Nr. 80/2015 Per arsimin e larte dhe kerkimin shkencor ne Republiken e Shqiperise, dhe aktet nenligjore https://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/07/22/80</p> <p>VI.2.2 Statutin e UART http://www.uart.edu.al/media/Statuti_uart_2021.PDF</p> <p>VI.2.3 Rregulloren e UART http://www.uart.edu.al/media/VSA_Nr.20_dt.07.10.2021.PDF</p> <p>VI.2.4 Rregulloren Mesimore e Ciklit te Dyte Master http://www.uart.edu.al/media/VSA_Nr.17_dt.07.10.2021.PDF</p> <p>V I.2.5 Kodi i Etikes ne UART http://uart.edu.al/media/2020%20-%20vsa%20%2023.I%20KODI%20ETIKES.vdf</p> <p>VI.2.6 VKM 780 date 26.12.2018 Per percaktimin e kategorive te individeve qe plotesojne kriteret per ulje te tarifes vjetore te studimit ne programet e ciklit te dyte te studimeve ne JAL. http://qbz.gov.al/eli/vendim/2018/12/26/780</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të procedurave shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Kandidatët për studentë në Universitetin e Arteve i nënshtrohen konkurseve të pranimit për programet e ciklit të parë, ndërkohë që për programet e ciklit të dytë konkurimi bëhet vetëm me dosje mes aplikantëve që shprehin dëshirën për të ndjekur studimet master. Përparësi në përzgjedhje marrin aplikantët të cilët kanë kryer një cikël studimesh pranë Universitetit të Arteve. Institucioni bën të ditura në çdo fillim viti kuotat e pranimit, kriteret e pranimit, rregulloret e konkurseve të pranimit dhe propozimin e tarifave përkatëse. Ndërkohë edhe për programet e ciklit të dytë të studimeve, master profesional apo master i shkencave janë miratuar në senatin akademik rregulloret përkatëse. Ndjekja e procedurave të hapjes së konkurimit dhe të regjistrimit të studentëve është në bashkëpunim të plotë me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p> <p>Nga ana tjetër në DVV nga ana e anëtarëve të GVB është dhënë edhe një shembull vlerësimi dosje kandidatësh me anë të pikësimit.</p> <p>DVV. Evid. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore të fakultetit</p> <p>Evid. Mbi miratimin e rregulloreve dhe kritereve të konkursit të pranimit për vitin akademik 2022-2023 në FM</p> <p>Evid.nr.Mbi propozimin për miratimin e tarifave të konkurimit, regjistrimit, shkollimit program i parë dhe i dytë</p> <p>Evid. Nr. Për deklarimin e kuotave të pranimit për vitin akademik 2022-2023 në UART.</p> <p><u>http://ev.fë.uart.edu.al/media/Rregulloret%20dhe%20kriteret%20Yo20MASTER%202023-2024%20FMpdf</u></p> <p>Metodologjikisht ka një mangësi këto në dhënien e evidencave pasi janë dhënë vetëm me hyperlink po ju referuar evidencës së numërtuar përkatëse pjesë të DVV.</p> <p>Pikëzimi</p> <p><u>http://ev.fë.uart.edu.al/media/NSA%20Nr%2019,%20Dt%2010%2003%202022%20Mbi%20Percaktimin%20e%20gikezimit%20ne%20konk:urset%20e%20Qranimit%20Qer%20vitin%20akademik'%202022-2023.11df</u></p>
---	--

<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në faqen web të Universitetit të Arteve janë të publikuara dhe të aksesueshme për publikun e gjerë kriteret procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, transferimit dhe njohjes së studimeve të mëparshme si dhe të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Ngelet e paqartësuar dhe e padëshmuar me anë të evidencave puna që pedagogu i speciales, sektori i kurrikulës dhe dega mësimore bëjnë në bashkërendim me njëri-tjetrin për informimin e studentëve. Një procedurë e tillë bashkërendimi i punës mes strukturave përkatëse me qëllim informimin sa me të mirë të studentëve do të duhej të ishte sjellë me evidencë me anë të një praktikë të plotë informimi.</p> <p>DVV. Evid.</p> <p>V1.4.1 Rregullore dhe kriteret pranimit cikli i dytë Master V1.4.2 Rregullore mesimore cikli dyte studime Master</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni arsimit të lartë afishon njoftime në lidhje me programet e studimit çdo fillim viti akademik si dhe përpara fillimit të vitit akademik lektorët marrin pjesë në panairt e studimit të organizuara nga MAS ose takimet informuese nëpër gjimnaze dhe lice të ndryshme. Institucioni gjithashtu organizon ditë të hapura të informimit të publikut dhe të kandidatëve të mundshëm përpara fillimit të çdo viti akademik duke u shpjeguar kriteret dhe mundësitë e regjistrimit në programet e ofruara Në evidencat e përcjella nga GVB ekzistojnë dëshmi të shpalljeve publike të informacionit për programet si dhe evidence të takimeve informuese të drejtëpërdrejta, ditet e hapura apo takimet informuese në shkolla apo në lice.</p> <p>DVV.Evid.</p> <p>Rregullore dhe kriteret pranimit cikli i dyte Master hte:lluart.edu.a.1/media/Rregu/!oret%20dhe%20kriteret%20M4S%20TER%202022-2023%20FM.pdf</p> <p>Kuotat e pranimeve ne ciklin e dyte Master hte:!Av11'e.uart.edu.allmedia/VSA%20Nr %2017,%20Dt %201003 2022%20Per%20deklarimi11%20e%20kuotave%20te%20ura11limit%20eer%20viti%20akade11ik%202022-2023%20ne%20UART.g_df</p>

<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Institucioni i alokon kritere dhe hapësire vëmendjeje të veçantë përzgjedhjes së kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave apo të shtresave të marginalizuara.</p> <p>DVV.Evid. http://www.uart.edu.al/media/VSA%20Nr %2017.%20Dt %2010 03 2022%20Per%20deklarimin%20e%20kuotave%20te%20pranimit%20per%20viti n%20akademik%20 2022-2023%20ne%</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Sipas relatiemeve të anëtarëve të GVB të drejtën për të ndjekur studimet në njërin prej programeve të ofruara nga fakulteti e kanë edhe kandidatët që kanë një diploma të shkollës së mesme të një vendi të huaj, ekuivalente me diplomën shqiptare të matures shtetërore sipas legjislacionit në fuqi. Fakulteti I Muzikës nuk harton kritere të veçanta për kandidatë nga shtete të tjera dhe për shtetasit e huaj vlejné kriteret qe aplikohen edhe për kandidatët që kanë studiuar në Shqipëri.</p> <p>DVV. Evid. Rregullore Mesimore e Ciklit te Dyte Master http://www.uait.edu.al/media/VSA Nr.17 dt.07.10.2021.PDF</p> <p>Rregullore dhe kritere pranimi cikli i dyte Master http://uart.edu.allmedia/Rregu/1oret%20dhe%20kriteret%20A1AS TER%202022- 2023%20.FltLpd http://www.uart.edu.allmedia/Rregul/oret%20dhe%20kriteret%20 M4STER%202023- 2024%20f7vf.pdf 20UART.pdf</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Institucioni është shumë mbështetës me politikat e ndihmës.bursave për shtresat në nevojë, mbështetjen e përjashtimit të studentëve ose të reduktimit të tarifës vjetore për ta, si dhe me fondin e mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer.Përmbushja e kriterit plotësisht nga ana e institucionit është mbështetur edhe me evidencat e duhura.</p> <p>Meqë vetë regjistrimi në programe studimi të ciklit të dytë parashikon një cilësi më të lartë Universiteti I Arteve nuk ka hartuar një politikë të vecantë ndihmëse dhe promovuese të programit të studimit.</p> <p>DVV. Evid. http://uart.edu.al/media/2021%20-%20VBA%2028%20PER%20REDUKTIM%20TARIFE%20SHKOLLIMI%2050%20pergind.PDF</p>




Prongolli

Konkluzione	<p><i>Institucioni ka të qartësuar procedura të ndjekjes së mbarëvatjes së studentëve nga hyrja në dalje por raportet analitike në lidhje me cilësinë e studentëve në hyrje dhe performancën e tyre gjatë viteve hartohen dhe disponohen vetëm nga zyra e sekretarisë mësimore dhe depozitohen vetëm si pjesë e raportit vjetor institucional që dorëzohet nga ana e UART në MAS. Kriteret procedurat, informacionet mbi aktet rregullatore të universitetit janë lehtësisht të aksesueshme, transparente dhe publike në faqen zyrtare të webit të Universitetit të Arteve si dhe vihen në dispozicion nga zyrat përkatëse të institucionit të arsimit të lartë. Institucioni bën të ditura në çdo fillim viti kuotat e pranimit, kriteret e pranimit, rregulloret e konkurseve të pranimit dhe propozimin e tarifave përkatëse. Institucioni gjithashtu organizon ditë të hapura të informimit të publikut dhe të kandidatëve të mundshëm përpara fillimit të çdo viti akademik duke u shpjeguar kriteret dhe mundësitë e regjistrimit në programet e ofruara. Institucioni është shumë mbështetës me politikat e ndihmës. Bursave për shtresa në nevojë, mbështetjen e përjashtimit të studentëve ose të reduktimit të tarifës vjetore për ta, si dhe me fondin e mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer. Edhe për këtë kriter ka disa evidence të munguara apo të numërtuara gabimisht.</i></p> <p><i>Standardi përmbushet plotësisht</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X


Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri nga ana e GVB paraqiten si evidence dokumentet rregullatore të cilët në parim parashikojnë të drejtat dhe detyrimet e studentëve, kriteret dhe procedurat e vlerësimit, dokumentimin e vlerësimeve, procedurat e ndërprerjes dhe vijimit të studimeve etj. Studentët informohen përmes sistemit Pitagora mbi përparimin e tyre akademik dhe mbi përmbushjen e kriteve minimale për kalimin nga një vit akademik në tjetrin mbi vlerësimin e vazhduar, përmbajtjen dhe organizimin e lëndës etj.</p> <p>Mënyrat e informimit të studentëve parashikohen në Rregulloren mësimore të programit të studimit cikli II (neni 17-23), si dhe një informim më i avancuar mundësohet përmes specialistit të kurrikulës, sistemit Pitagora i cili reflekton përparimin akademik si dhe kontakteve individuale të pedagogut të lëndës individuale artistike në funksion të këshillimit të karrierës për studentët.</p> <p>DVV.Evid.Rregullore Mesimore e programit te studimit, Ciklit II,</p>

	- http://www.uart.edu.al/media/VSA Nr.17 d1.07.J0.2021.PDF
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>Institucioni pranon transferime të studentëve nga institucione të tjera të arsimit të lartë, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, ndërkohë që kuadri rregullator për këto transferime është i bërë publik dhe transparent përmes faqes web të institucionit. Evidencat për këtë kriter janë dhënë saktësisht dhe në të njëjtën kohë është adresuar edhe neni konkret ku parashikohet transferimi i studentëve.</p> <p>DVV.Evid.Rregullore Mesimore e programit te studimit, Ciklit II,</p> <p>http://www.uart.edu.al/media/VSA Nr.17 dt.07.10.2021.PDF studimeve</p> <p>Kreu VI Transferimet, Njohja e krediteve, Neni 24,25,26,17,28</p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	<p>Aktet rregullatore të UART, po ashtu si edhe syllabuset e lëndëve përkatëse parashikojnë kriteret dhe format e vlerësimit të dijeve të studentëve, procedurat e vlerësimit, komunikimin e vlerësimeve studentëve si dhe dokumentimin e vlerësimeve. Referencat dhe evidencat e sjella për përmbushjen e këtij kriteri nga ana e GVB janë relevante dhe të sakta, ndërkohë që tek syllabuset e lëndëve mund të konstatohet që disa nga lektorët ndjekin një format të vjetër të papërpërditësuar syllabusi dhe jo në përputhje me çfarë parashikohet në VKM 41, ndërsa pjesa tjetër respektojnë elementët e një syllabusi të parashikuar në këtë VKM. Institucioni dëshmon që ka krijuar kushtet për të informuar si duhet studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive. Kontakti me pedagogun e lëndës individuale speciale edhe në funksion të këshillimit të karrierës është gjithashtu shumë i rëndësishëm në këtë proces.</p> <p>DVV. Evid.</p> <p>Rregullore Mesimore e programit te studimit, Ciklit II, http://www.11art.ed11.al/media/VSA Nr.17 dt.07.10.2021.PDF</p> <p>Neni 17, Menyrat e te provuarit te dijes, Neni 18, Parakushtet per hyrjen ne provim, Neni 19, Sezonet e provimeve, Neni 20, Provimi dhe kontrolli i dijeve, Neni 21, Dokumentimi i vleresimit te studenteve Neni 22, Kushtet e kalimit ne vitin pasardhes, Neni 23, Permiresimi i notave.</p>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e	Universiteti i Arteve ka të parashikuar në mënyrë të detajuar procedura për hartimin e punimit të diplomës dhe procedura të diplomimit të studentëve me provim të përgjithshëm përfundimtar, mbrojtje artistike

<p>punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>apo temë diplome me tekst dhe mbrojtje artistike njëkohësisht. Në evidencat e sjella nga grupi i punës parashtrihen aktet rregullatore që kontrollojnë përfundimin e studimeve, diplomimin dhe punimin e diplomës por nuk evidentohet të ketë një udhëzues teme diplome të detajuar dhe të standardizuar e formalizuar i cili të shërbeje si udhëheqje akademike kërkimore dhe artistike për studentët që e mbyllin ciklin e tyre të studimeve me një punim diplome.</p> <p>DVV. Evid. Bazuar ne Rregulloren Mësimore të Ciklit të Dytë Master http://1.vë11.uart.edu.allmedia/VSA Nr.17 dt.07.10.2021.PDF</p> <ul style="list-style-type: none"> - Neni 30 pershkruan Modalitetet e Diplomimit - Neni 36 pershkruan Supplementin e Diplomes <p>Bazuar ne Syllabuset e programit te studimit "Trombe dhe Mesuesi"</p> <ul style="list-style-type: none"> - DO.DI/SY Nr.1, Nr.2, Nr.3, Nr.4, Nr.5, Nr. 6, Nr.7, Nr.8, (Syllabuset sipas grupeve mësimore të Departamentit të Intepretimt) informacioni bëhet me i detajuar, jo vetem të literaturës së nevojshme, por edhe përsa i takon të gjithë aspekteve organizative dhe të ECTS.
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Universiteti i Arteve përdor forma të ndryshme për informimin e studentëve të ardhshëm lidhur me programet që ai ofron. Udhëzues apo fletëpalosje të veçanta janë prodhuar në mënyrë periodike dhe publikohen në mjetet e informimit publik apo në mediat sociale si dhe bëhen të ditura përmes tureve informative të lektorëve të UART në licetë artistike të shkollave të ndryshme.</p> <p>Kuotat jane percaktuar sipas tipologjise:</p> <p>Kuota per brenda territorit te vendit</p> <ul style="list-style-type: none"> - kuota per program te dyte studimi - kuota transferimi - kuota per studente te huaj - kuota per status jetimi <p>-kuota per aftesi te kufizuara -kuota per rome dhe ballkano-egjiptian</p> <p>Kuota sipas Shteteve</p> <p>Universiteti i Arteve dhe Fakulteti i Muzikes, konsideron si frekuentues potencialë të Ciklit të Dytë të Studimeve Master, nënshtetas të Shqiperisë, të Trojeve shqiptare ose të huaj, që kane ndjekur Bachelor në Trombe pranë UART. Për këtë kategori studentësh potencial nga ana e GVB gjykohet që nuk është e nevojshme të publikohen udhezues te posacëm pasi gjate studimeve Bachelor, kane pasur të gjitha mundesitë dhe lehtesitë të vëzhgojnë piket e forta dhe ato të dobeta të programit të studimit të Ciklit të Dytë.</p> <p>Një pershkrim i Universitetit të Arteve, Fakulteteve të tij, strukturës së Departamenteve dhe programeve të studimit, si një material informues dhe udhëzues i posaçëm per t'u përdorur nga personeli akademik i</p>





	<p>programit të studimit është hartuar në kuadër të shkëmbimit Erasmus Plus me Itali, Norvegji, Spanjë.</p> <p>DVV.Evid. Kuota pranimi</p> <p>http://1tart.ed1t.al/mcdia/VSA%20Nr.%j017,%20Dt %2010 03 j022%20Per%20deklari min%20e%20k1%20tave%20te%20praniniit%20per%20vitin%20aka demik%202022- 2023%20ne%2</p>		
Konkluzione	<p><i>Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik, ato të njohjes së kualifikimeve të mëparshme të vlerësimeve të vazhdueshme të lëndës, procedurat e punimit të diplomës. Universiteti i Arteve përdor formë të ndryshme për informimin e studentëve të ardhshëm lidhur me programet që ai ofron. Udhëzues apo fletëpalosje të veçanta janë prodhuar në mënyrë periodike dhe publikohen në mjetet e informimit publik apo në mediat sociale si dhe bëhen të ditura përmes tureve informative të lektorëve në shkollat e mesme artistike. Standardi përmbushet plotësisht</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Nga vlerësimi rezulton se studentët e UART informohen në fillim të çdo viti akademik dhe në vijim në lidhje me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Informimi zhvillohet gjatë ditëve të informimit, në ditët e hapura të organizuara pranë Fakultetit të Muzikës, gjatë periudhës së regjistrimit dhe gjatë javës së akomodimit, si dhe përgjatë periudhës së studimeve. Evidencat e sjella në këtë kriter dhe në kriteret pararendëse në lidhje me përmbushjen e këtij standardi janë relevante dhe bindëse.</p> <p>DVV</p> <p>Evid. V.3.1.2. Syllabuset Master i Arteve në Trombon dhe Mësuesi</p> <p>Evid. V.3.1.1Piani mësimor i programit të studimit.</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Bazuar në vlerësimin e ekspertëve të jashtëm institucioni ju vë në dispozicion studentëve informacion/dokumentacion në formën e një syllabusi lënde të detajuar në të cilin janë specifikuar rubrikat ose temat për çdo javë mësimore, shoqëruar me literaturën e detajuar kryesore dhe ndihmëse si dhe format e vlerësimit të dijeve. Gjithashtu plani mësimor i programit është i publikuar online në faqen zyrtare të UART.</p> <table border="1" data-bbox="616 465 1449 676"> <tr> <td>V3.2.1</td> <td><i>Rregullore Mesimore e Ciklit te Dyte Master</i></td> </tr> <tr> <td>V3.2.2</td> <td><i>Plani mesimor per Programin e Studimit Master i Arteve ne "I dhe Mesuesi"</i></td> </tr> <tr> <td>V3.2.3</td> <td><i>Syllabuset Planit mesimor Master i Arteve ne "Trombe dhe M</i></td> </tr> </table>	V3.2.1	<i>Rregullore Mesimore e Ciklit te Dyte Master</i>	V3.2.2	<i>Plani mesimor per Programin e Studimit Master i Arteve ne "I dhe Mesuesi"</i>	V3.2.3	<i>Syllabuset Planit mesimor Master i Arteve ne "Trombe dhe M</i>
V3.2.1	<i>Rregullore Mesimore e Ciklit te Dyte Master</i>						
V3.2.2	<i>Plani mesimor per Programin e Studimit Master i Arteve ne "I dhe Mesuesi"</i>						
V3.2.3	<i>Syllabuset Planit mesimor Master i Arteve ne "Trombe dhe M</i>						
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Grupi i vlerësimit të jashtëm gjykon dhe vlerëson që Universiteti i Arteve ofron mbështetjen institucionale të nevojshme për orientimin e studentëve drejt tregut të punës, megjithatë në DVV nuk ofrohet mjaftueshëm informacion dhe evidenca për të dëshmuar mënyrën si institucioni i informon studentët mbi mundësitë e punësimit. Gjithsesi vetë numri i vogël i studentëve që UART diplomon çdo vit dhe vetë numri i kufizuar i institucioneve elitare të artit ku këta studentë mund të gjejnë punësim e bëjnë procedurën e orientimit të karrierës më të lehtë. Përfshirja e studentëve në jetën artistike dhe kulturore të vendit dhe aktivitetet që kryhen në kuadër të Paktit për Universitetin shërbejnë si procedura formale për të informuar studentët mbi mundësitë e punësimit. Universiteti i Arteve ka marrë pjesë me sukses si një nga partneret e projektit GRADUA, Erasmus+ CBHE - për të dëshmuar mbështetjen institucionale për orientimin drejt në tregun e punës. Nëpërmjet këtij projekti janë siguruar laboratorë, përgatitur e trajnuar kapacitete njerëzore, si dhe është ideuar platforma me të njejtin emer te projektit, ku studentet, pas regjistrimit, kanë mundësi dhe kontakte te drejtperdrejta me tregun e punës.</p> <p>GVB në asnjë vend nuk sjell dot të dhëna analitike mbi përfitimet e projektit Gradua.</p> <p>Evidenca të sjella nga GVB janë</p> <p>Evid. V.3.3.1 Regjistrimi ne platforme i studenteve https:// gradua.rash.al/stud/registration/Default.aspx?code Pia=l&lang=sq</p>						
	<p>Evid. V.3.3.2 Nje informacion mbi projektin GRADUA ne faqen zyrtare te UART http://uart.edu.al/index.php?id=845</p>						

<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Universiteti i Arteve vë në dispozicion të studentëve para periudhës së studimeve dhe gjatë periudhës së studimeve informacion të gjerë të përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, infrastrukturën dhe çdo gjë tjetër në funksion të realizimit të programit. Nga ana e grupit të vlerësimit të brendshëm deklarohet që studentëve u vihet në dispozicion nga sekretaria informacioni i përditësuar mbi zhvillimin e procesit mësimor gjithashtu gjatë vizitës në institucion edhe nga vetë studentët është pohuar që ata vihen në dijeni të çdo gjë që ka të bëjë me procesin mësimor. Faqja Web e fakultetit dhe e Departamentit të Interpretimit posaçërisht janë mjaftueshmërisht të plota për të ofruar informacionin që studentëve u nevojitet në lidhje me procesin mësimor.</p> <p>DVV.</p> <p>Evidenca për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&ld='/'&niveli=66 bazuar në</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullore UART - http://www.uart.edu.al/media/VSA Nr.20 dt.07.10.2021.PDF - Rregulloren mesimore cikli dyte - http://www.uart.edu.al/media/VSA Nr.17 dt.07.10.2021 <p>V3.4.1 Foto klasat e rikonstruara</p>		
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Grupi i vlerësimit të jashtëm ka konstatuar që informacione të detajuara në lidhje me planin mësimor të programit të studimit, sipas viteve, semestrave, krediteve mundësohen përmes një sistemi menaxhimi të brendshëm Pitagora. Përveç kësaj informacioni është bërë edhe publik përmes faqes web të Fakultetit të Muzikës.</p> <p>DVV</p> <p>Evid Faqja Web , Plani mesimor i programit Evid. Sistemi Pitagora</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Studentët e UART informohen në fillim të çdo viti akademik dhe në vijim në lidhje me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Institucioni ju vë në dispozicion studentëve informacion/dokumentacion në formën e një syllabusi lënde të detajuar në të cilin janë specifikuar rubrikat ose temat për çdo javë mësimore, shoqëruar me literaturën e detajuar kryesore dhe ndihmëse si dhe format e vlerësimit të dijeve. Universiteti i Arteve ofron mbështetjen institucionale të nevojshme për orientimin e studentëve drejt tregut të punës. Informacione të detajuara në lidhje me planin mësimor të programit të studimit, sipas viteve, semestrave, krediteve mundësohen përmes një sistemi menaxhimi të brendshëm Pitagora.</i></p> <p><i>Standardi përmbushet plotësisht</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profillin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti i Arteve mbledh, arkivon dhe përpunon të dhëna të sakta në lidhje me numrin e studentëve diplomuar, sipas viteve dhe gjinive.</p> <p>DVV Evid. Tabelat me numrat e studenteve viti i Master, nr. i femrave dhe te dhëna të tjera -Tabelat me numrat diplomante Master, nr. i femrave dhe të dhëna të tjera per 3 vitet 20I 9, 2020 - 202I, 2021 - 2022</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Institucioni përpunon në mënyrë vjetore të dhëna të sakta në lidhje me studentët e pranuar, ato që po ndjekin studimet aktualisht të trasferuar dhe të çrregjistruar, deri në diplomim për secilin vit akademik. Të dhënat e depozituara dhe të përpunuara nga zyra e sekretarisë mësimore gjithashtu përfshijnë informacion mbi tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Këto të dhëna përfshihen edhe në raportin vjetor të Institucionit të arsimit të Lartë. Evidencat e sjella janë mbështetëse dhe relevante.</p> <p>Të dhëna mbi studentë</p> <ul style="list-style-type: none"> - të regjistruar ne programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, - tërheqjet nga programi, - largimet para përfundimit të programit - mospërfundimin me sukses te vitit akademik <p>shkëmbehen midis Sekretarisë Mësimore të Fakultetit të Muzikës. Në Sekretarinë Mësimore të FM disponohen të dhënat të dokumentuara në:</p> <ol style="list-style-type: none"> a)Regjistrin Themeltar b) Regjistrin e arritjeve c)Sistemin Pitagora <p>DVV.Evid. V.4.3.1 Regjistri themeltar FM V.4.3.2 Regjistri i Arritjeve FM</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Institucioni ka përdorur më përpara dhe vijon të përdorë një system të sigurtë të brendshëm të menaxhimit të informacionit. Ky system më përpara ka qene i ofruar nga Rrjeti Telematik Shqiptar dhe ka qene ESSE3, ndërkohë që aktualisht përdoret sistemi Pitagora sërish i mundësuar nga RASH. UART ka qene një ndër institucionet e para që ka përqafuar dixhitalizimin e sistemeve online të hedhjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave. Të dhënat janë të arkivuara në mënyrë të sigurtë</p>




	<p>dhe janë lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. Gjatë vizitës në sekretarinë mesimore të GVJ janë vënë në dispozicion edhe të dhëna të tjera shtesë nga sistemi Pitagora të cilat janë lehtësisht të verifikueshme dhe të aksesueshme.</p> <p>DVV Evid. Sistemi Pitagora</p>								
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritet mesimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Përmes një rregulloreje mbi sektorin mesimor të miratuar nga senati akademik DVV Evid. Rregullore e Zyrës mesimore dhe Kurrikulës, Neni 5, Pika 14 Universiteti I Arteve kryen kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin e sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit duke vlerësuar dhe dokumentuar në këtë mënyrë gjendjen dhe saktësinë e informacionit në lidhje me studentët. Nga evidencat e sjella nuk dëshmohet mënyra si kryhet auditimi i brendshëm apo kontrolli periodik rastësor i saktësisë. Nga vizita institucion u qartësua që kjo bëhet në mënyrë periodike nga ana e përfaqësuesve të zyrës mesimore. Në përshkrimin e përmbushjes së kriterit nga ana e anëtarëve të GVB evidencat referuese për këtë kriter mungojnë.</p> <p>DVV Evid. Rregullore e Zyrës mesimore dhe Kurrikulës, Neni 5, Pika 14</p>								
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Raporti vjetor i njësisë bazë është dokument themelor me anë të të cilit njësia bazë detajon të dhëna në lidhje me profilin dhe cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve si dhe punësueshmërinë e tyre .DVV. Evid. Raport vjetor i punës artistike mesimore dhe shkencore i stafit akademik të Departamentit të Interpretimit si shembull i sjellë nuk jep të dhëna analitike në lidhje me cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, dhe aq më pak në lidhje me punësimin e tyre. Të dhëna analitike në lidhje me punësimin e studentëve jepen më tej në vetë përshkrimin e RVB citoj</p> <p>Duke marrë në konsideratë numrat e studentëve interpretues Trombonist , specifikën e instrumentit, hapësirat për rekrutim janë të pakta por edhe numri i studentëve që diplomohen në këtë program është shumë i pakët..</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Universiteti i Arteve mbledh, arkivon dhe përpunon të dhëna të sakta në lidhje me numrin e studentëve diplomuar. Institucioni përpunon në mënyrë vjetore të dhëna të sakta në lidhje me studentët e pranuar, ata në ndjekje të studimeve, studentët e transferuar dhe të çrregjistruar, deri në diplomim për secilin vit akademik. Institucioni ka përdorur më përpara dhe vijon të përdorë një system të sigurtë të brendshëm të menaxhimit të informacionit. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse. Raporti vjetor i njësisë bazë është dokument themelor me anë të të cilit njësia bazë detajon të dhëna në lidhje me profilin dhe cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve si dhe punësueshmërinë e tyre.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Përmes konsultimit të websitit të institucionit dhe të akteve rregullatore që zbatohen në UART mund të vërehet se Universiteti I Arteve ka ngritur këshillat studentorë të cilët kanë si objektiv pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinimin e përfaqësimit të tyre me qëllim dhënien e mendimeve dhe të propozimeve në lidhje me strukturat mësimore kërkimore dhe ato të shërbimeve.</p> <p>DVV Evid. Nr.1 Kreu IX, Neni 126 Statuti i UART-, DVV Evid. Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore- neni 56, pika a dhe b dhe DVV. Httpë ë"1,11.uart.edu.al/media/VSA Nr.17 dt.07.10.2021.PDF</p> <p>Evid.Rregullore Mesimore te Ciklit II te Studimeve Master, Neni. 41 http://www.uart.edu.al/media/VSA Nr.17 dt.07.10.2021.PDF</p> <p>Evid.Rregullore e programit te studimit Master i Arteve ne "Trombe dhe Mesuesi" parashikojnë të drejtën e studentëve për tu përfaqësuar në këto organe senatin Akademik të tillë si Këshillin e Etikës, Komisionet e Përhershme dhe Këshillat e Studentëve.</p> <p>Vendimet e senatit me në përbërjen e tyre dhe të nënshkruara edhe nga studentë janë evidenca të përfshirjes së studentëve në mbledhje, takime apo vendimmarrje të senatit akademik. Ekziston gjithashtu evidenca e përfshirjes së studentëve në hartimin e RVB në kuadër të akreditimit të programit të studimit. Të pyetur gjatë vizitës në institucion në lidhje me nivelin e përfshirjes së tyre në mbledhje të organeve vendimmarrëse studentët nuk e pohojnë një gje të tillë, por shprehen se pyeten here pas here nga lektorët e tyre në lidhje me mbarëvatjen e programit të studimit.</p> <p>Ndërkohë përfaqësimi i studentëve në organet vendimmarrëse sipas nenit 126 Statuti UART është</p> <p>Senati Akademik, 2 studente http://iuart.edu.al/media/2022-vsa77.PDF Keshillin e Etikës, 1 student http://www.uart.edu.al/index.php?pg=fage&id=98&niveli=1 04) Komisionet i perhershem i Marredhenieve me Studentet, 3 studente Keshillat e Studenteve.</p>

<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Përfaqësimi i studentëve në parim në legjislacion është parashikuar në disa organe të përmendura më lart. Nga ana tjetër institucioni mundëson vlerësimin e punës së stafit akademik, infrastrukturës dhe cilësisë së programit përmes anketimeve të cilat zhvillohen periodikisht dy herë në vit në fund të çdo semestri. Pyetësorët në formën e sondazheve administrohen nga ana e degës mësimore. Përfaqësimi konkret i studentëve në organet vendimarrëse mund të gjurmohet vetëm përmes vendimit të përfshirjes së tyre si anëtare të grupit të punës për VB të programit të studimit Mastër në Mësuesi Trombon dhe në vendimmarrjet e senatit akademik.</p> <p>Nga ana e GVb pranohet përfshirja e studentëve në Vendimmarrje është në</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në komisionin e Marredhenieve me Studentet, - Në Senatin Akademik, - Në Keshillin e Etikes - Në Keshillat e studenteve <p>Në Këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetësorë për opinionet rreth mësimdhënies, veprimtarive shkencore dhe artistike - Përfaqësim me një anëtar grupi pune të vlerësimit të brendshëm të akreditimit institucional. - Përfaqësim me një anëtar grupi pune të vlerësimit të brendshëm për akreditimin e programit të studimit Master i Arteve në "Trombe dhe Mësuesi" <p>DVV.Evidencë</p> <p>V.5.2.1 Nje vendim SA http://uart.edu.al/medial2022-vsa77.PDF</p> <p>V.5.2.2 Urdhri per ngritjen e grupit te brendshem per akreditimin</p> <p>V.5.2.3 Model pyetesori te plotesuar</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Institucioni aplikon një komunikim të vazhdueshëm për të marrë prej studentëve mendime mbi programin e studimit dhe kurrikulat e lëndëve. Pyetësori për studentët është strukturuar në mënyrë të tillë që të jetë i ndarë në gjashtë indikatorë ku vjelen mendime në lidhje me vlerësimin e studentëve sipas fushave përkatësisht 1. Për Programin e Studimit, 2. Për Mësimdhënien, 3. Për Facilitetet, Burimet materiale, Logjistikën dhe Shërbime të Tjera. Njësia e Sktorit Mësimor është sërish ajo që në bashkëpunim me departamentin/ njësinë bazë dhe komisionin ad hoc të NJSBC bëjnë të mundur aplikimin e këtyre sondazheve tek studentët dhe përpunimin e të dhënave të dala nga pyetësorët.</p>
	<p>Mungojnë evidenca në lidhje me përfshirjen e studentëve në mbledhje të departamentit. Të pyetur studentët nuk pohojnë të kenë qenë të pranishëm në mbledhje të njësive bazë. Mungojnë evidenca përfshirjeje studentore në grupe fokusimi. Gjatë vizitës në institucion -takimi me</p>

	<p>studentët, takimi me NJSBC pohohet se grupet e fokusimit organizohen kryesisht në mënyrë informale ku pedagogu i speciales, njëkohësisht edhe këshillues akademik i studentit përmes diskutimeve të lira vjel mendimet e studentëve në lidhje me çështje të caktuara që kanë të bëjnë me programin e studimit.</p> <p>DVV.Evidencë V.5.3.1 I Model pyetesori te plotesuar (studente)</p>						
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Universiteti I Arteve u jep mundësinë studentëve të shprehin mendimet e tyre në lidhje me procesin e vlerësimit të lëndës nga ana e stafit akademik. Bazuar në rregulloret përkatëse studentët kanë të drejtë të kërkojnë informacion dhe të marrin shpjegime transparente nga lektorët për vlerësimin e tyre të lëndës, apo edhe të konstestojnë/apelojnë kërkojnë rivlerësim nëse nuk janë dakord me vlerësimin që ka bërë pedagogu për lëndën.</p> <p>Anëtari student i Senatit Akademik, ka të drejtën e dhënies së mendimit të tij rreth procedurave të miratuara për të gjithë procesin e vlerësimit te dijeve gjatë programit të studimit të ciklit të dytë.</p> <p>DVV. Evid. Për procesin e ankimimit/rivlerësimit të lëndës Rregullore Mësimore e programit Master I Arteve neni 23 DVV Evid. Rregullore e Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Muzikës kreu V, Neni 45 pika 12, 13.14,15,16</p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Përmes konsultimit të websitit të institucionit mund të vërehet se Universiteti I Arteve ka ngritur këshillat studentorë të cilët kanë si objektiv pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinimin e përfaqësimit të tyre me qëllim dhënien e mendimeve dhe të propozimeve në lidhje me strukturat mësimore kërkimore dhe ato të shërbimeve. Përfaqësimi i studentëve në parim në legjislacion është parashikuar në disa organe të përmendura më lart. Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit bëhet kryesisht përmes plotësimit të pyetësorëve mbi kurrikulën, vlerësimin, mësimdhënien dhe infrastrukturën dy herë në vit. Të pyetur rreth pjesëmarrjes së tyre aktive në përmirësimin e një programi studimi studentët pranojnë të jenë anëtarë të organeve kolegjiale por jo pjesëmarrës aktivë.</i></p> <p><i>Standardi përmbushet kryesisht</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="603 1630 810 1713">Përmirësimi i përgjithshëm</th> <th data-bbox="810 1630 1023 1713">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1023 1630 1246 1713">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="603 1713 810 1762"></td> <td data-bbox="810 1713 1023 1762" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="1023 1713 1246 1762"></td> </tr> </tbody> </table>	Përmirësimi i përgjithshëm	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		X	
Përmirësimi i përgjithshëm	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
	X						


Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Fakulteti i Muzikës, Universiteti i Arteve ofron infrastrukturën përkatëse me qëllim informimin dhe mbështetjen e studentëve gjatë periudhës së studimeve. Sekretaria Mësimore dhe Sektori Mësimor kanë në përbërjen e tij edhe strukturën e Informimit të Studentëve, Këshillimit të karrierës, dhe Alumni. Në fakt në vend që të konsiderohet një strukturë, është një individ i vetëm i cili ndjek Informimin e studentëve, këshillimin e tyre dhe gjurmon Alumni dhe kjo nuk është e mjaftueshme. Struktura përkatëse/individ ndjek ecurinë e studentit që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar këshillim për çështje akademike dhe informim të studentëve. Procedurat e informimit të studentëve parashikohen në</p> <p>DVV.Evidence -Statuti i UART http://1-1-ëë.uart.edu.al/1nedia!Sta fl tti uart 2021.PDF -Udhezimi Nr. 27 date 29.12.2017 https://arsimi.gov.al/ëp-content/uploads2018/03/Udhezimi nr. 27 dt. 29.12.2017.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Përveç strukturës përkatëse pranë Sekretarisë mësimore për informimin dhe ndjekjen e mbarëvajtjes së studentëve UART vë në dispozicion edhe një sërë strukturash/organizimesh për të informuar dhe ndjekur ecurinë e procesit akademik të programit të studimit. Këtu përfshihen ditët e hapura të informimit, vizitat e lektorëve nëpër lice apo shkolla të mesme të qyteteve, kontaktet e vazhdueshme të pedagogut të speciales i cili në të njëjtën kohën kryen edhe funksionin e këshilltarit akademik dhe ka kontakt të drejtëpërdrejtë me studentët duke ndjekur ecurinë e tyre dhe duke marrë opinione të vazhdueshme përgjatë studimeve.</p> <p>Evidenca të ndeshura gjatë konsultimit të DVV Evid. Nr.Fletëpalosje mbi informimin e studentëve lidhur me programet e studimit që ofron UART.PDF Evid.Nr.Foto nga veprimtari informuese.pdf Evid.Nr.Foto dokumente publikime nga takimet e pedagogëve në shkollat e mesme artistike.pdf Evidenca të ofruara dhe të cituara nga GVB DVV Evid. https://arsimi.gov.al/ëp-content/uploads/2018i03/Udhezimi nr. 27 dt. 29.12.2017.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës.</p>	<p>Sektori mësimor një ndër detyrat e tij ka mbajtjen e marrëdhënieve të vazhdueshme me këshillat studentorë, drejtimin e procesit të këshillimit të studentëve mbajtjen e komunikimit me tregun e punës si dhe</p>


<p>Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>orientimin e studentëve drejt zhvillimit të vlerave profesionale dhe artistike në fushën e artit dhe të kulturës. Zyra ruan lidhje të ngushta me këshillin studentor, orienton studentët e viteve të para në lidhje me programet e studimit, si dhe asiston më tej në një këshillim dhe informim të individualizuar të studentëve nga ana e pedagogut të speciale.</p> <p>Nga ana e anëtareve të GVB nuk janë ofruara evidence por evidence të ndeshura gjatë konsultimit të DVV janë</p> <p>DVV. Evid. Rregullore e Zyrës mësimore dhe Kurrikulës Evid. Rregullore e ciklit të dytë të studimeve Master , neni 40 Vizitë e GVJ në Institucion Takim me Pedagogë të Speciales, Takim me Studentë.</p>		
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Struktura e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni në UART mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, ka vjelur të dhëna nga Alumni të FM me anë të një formulari tip (Vizitë GVJ në institucion-takim me përfaqësuesen e Alumni). Zyra ka krijuar një bazë të dhënash bazuar në komunikimet e vazhdueshme me to përmes emailit, të dhënave të kontaktit, rrjeteve sociale etj.</p> <p>Platforma GRADUA është një instrument, i cili pas regjistrimit te studentit në platformë, është në gjendje të na japë në mënyrë sintetike e elektronike të dhëna mbi shkallën dhe cilesine e punësimit të studentëve të programit të studimit Master i Arteve ne "Trombe dhe Mesuesi"</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve. Sektori mësimor një ndër detyrat e tij ka mbajten e marrëdhënieve të vazhdueshme me këshillat studentorë, drejtimin e procesit të këshillimit të studentëve mbajten e komunikimit me tregun e punës si dhe orientimin e studentëve drejt zhvillimit të vlerave profesionale dhe artistike në fushën e artit dhe të kulturës. Struktura e Informimit të Studentëve, Këshillimit të karrierës, dhe Alumni në vend që të konsiderohet një strukturë, është një individ i vetëm i cili ndjek Informimin e studentëve, këshillimin e tyre dhe gjurmon Alumni dhe kjo nuk është e mjaftueshme. Struktura përkatëse/individ ndjek ecurinë e studentit që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar këshillim për çështje akademike dhe informim të studentëve Standardi përmbushet plotësisht</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	------------------------------	-----------------------------	--

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Institucioni nuk disponon një udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Institucioni ka hartuar gjatë periudhës së pandemisë vetëm një udhëzues institucional mbi përdorimin sa më efikas të sistemit Microsoft Teams por ky ishte një udhëzues me efekt veprimi të përkohshëm me qëllim përshtatjen me metodologjive të mesimdhënies online të diktuar nga Covid 19.</p> <p>Të pyetur nga ana e GVJ për ekzistencën e këtij udhëzuesi një evidencë e tillë nuk është vënë në dispozicion. GVJ vlerëson se një manual i tillë mund të mos jetë një domosdoshmëri për vetë specifikat e zhvillimit të mësimdhënies të personalizuar/ individualizuar tek Universiteti I Arteve, ku raporti lektor/student është shpeshherë 1 me 1 dhe kjo çon në pamundësinë e aplikimit të një manuali të përgjithshëm institucional mbi metodat inovative në mësimdhënie.</p> <p>Nga ana e GVB argumentohet se nevoja për t'ju pergjigjur kërkesës për një ecuri cilësore, si në raport me planin mësimor dhe repertorin e përcaktuar, ashtu dhe me aspektin stilistikor dhe të estetikës muzikore per secilin individ student, karakteristikat psiko-motore, bagazhi kulturor i krijuar, si dhe ndjeshmëria muzikore individuale nuk mund të aplikohen në mënyrë të përgjithsme në një udhëzues institucional.</p> <p><i>Për sa më sipër GVJ mirëkupton se hartimi i një udhëzuesi mësimdhënieje inovative në kushtet e një diversiteti individual të theksuar të artistëve përsa i përket aspektit stilistikor, të estetikës muzikore për secilin individ student, karakteristikave të tyre psiko-motore , bagazhit kulturor të krijuar dhe ndjeshmërisë muzikore individuale nuk është i mundshëm dhe i zbatueshëm në mënyrë të unifikuar.</i></p> <p>Komenti merret parasysh nga GVJ dhe reflektohet në raport</p> <p>DVV Evid. Nr. Manuali i Përdorimit të Microsoft Teams-sjellë si evidencë nga GVB Evid. V.1.1.1 I Syllabuset e Planit mesimor te Master i Arteve ne "Trombe dheI Mesuesi" Vizitë në institucion i GVJ -Takim me NJSBC dhe lektorët e Speciales</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të</p>	<p>Për vetë natyrën specifike të fushës në të cilën operon Universiteti I Arteve në Fushën e Arteve, arrijtet e teknologjisë dhe shpikjet inovative</p>





<p>monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>kanë pak ndikim në këtë fushë. Në Departamentin e Trombons përdoren kryesisht metoda tradicionale të personalizuara të mësimdhënies në auditor nën udhëheqjen e pedagogut të speciales. Institucioni kryen një vlerësim periodik të stafit akademik nga studentët dhe nga eprorët e tyre. Institucioni gjithashtu aplikon një pyetësor të stafit akademik ku vjelet mendimi i stafit akademik për çështje që kanë të bëjnë me infrastrukturën, programet e studimit, komunikimet me strukturat përkatëse vendimarrëse të UART etj.</p> <p>Evidentimi i problematikave për programet e studimit dhe procesin mësimor bëhet në raportin vjetor përkatës të njësisë bazë dhe të njësisë kryesore.</p> <p>Mekanizma të monitorimit të personelit akademik të cilat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pyetësoret nga Sektori Mesimor dhe Fakulteti i Muzikës, te plotësuar nga ana e studenteve dhe pedagogeve dhe përpunimi i të dhënave të tyre. - Nenshkrimit të marrëveshjes së kohës vjetore të punës me Njesine Baze DI dhe përpunimit të të dhënave të aktivitetit kërkimor artistik e metodologjik pedagogjik të personelit akademik. <p>Vlerësimet periodike të aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmes akademik sipas:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Analizave vjetore të Departamentit të Interpretimit - Analizave vjetore të Fakultetit të Muzikës - Analizave vjetore të Universitetit të Arteve <p>DVV.Evidence VI.1.2.1 Model pyetesori nga Sektori Mesimor te plotësuar V.1.2.2 Model marreveshje te kohes vjetore te punes, V.1.2.2 Analiza vjetore te Departamentit te Interpretimit dhe ose Analiza vjetore te Fakultetit te Muzikes</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në vlerësimet periodike të programeve të studimit ashtu sikundër është konstatuar edhe më sipër nuk dokumentohet apo evidentohet me anë të procesverbaleve të mbledhjeve apo procesverbaleve të organizimit të fokus grupeve. Universiteti i Arteve në të gjitha aktet rregullatore të hartuara prej tij në parim përcakton pjesëmarrjen e përfaqësuesve të studentëve të zgjedhur nga vetë ata në të gjitha strukturat drejtuese.</p> <p>DVV. EvidStatuti neni 123. Pika 1.2. si dhe neni 126 Studentët gjithashtu shprehin vlerësimin e tyre periodik të formave dhe metodave të mësimdhënies dhe vlerësimit të dijeve përmes plotësimit dy herë në vit të pyetësorit për studentët</p>
	<p>DVV Evid. Informacion mbi rezultatet e vlerësimit të pyetësorit të studentëve Evid. Informacion mbi rezultatet e vlerësimit të zhvilluara të stafit akademik.</p>


	Evid. VI.1.2.1 Model pyetesori nga Sektori Mesimor te plotesuar Mungojnë evidenca organizimi fokus grupe apo procesverbale mbledhjeje departamenti me pjesemarrje të përfaqësuesve të studentëve.		
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezultatet e monitorimit të cilësisë së programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve të vjela kryesisht përmes pyetësoreve bëhen publike ne analizën dhe raportet vjetore të njëjive. Në faqën Web të UART nuk gjenden të publikuara rezultatet e pyetësorëve. VI.1.4.1 Analize vjetore e Universitetit te Arteve		
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Institucioni promovon shembuj të praktikave të mira dhe nxit personelin akademik në përmirësim të mëtejshëm të mësimdhënies përmes evidentimit të praktikave më të mira të mësimdhënies dhe të performancave artistike në raportin vjetor të departamentit. DVV Evid. VI.1.5.1 Analize vjetore e Universitetit te Arteve htt ://uart.edu.al/media/VSA22dt23122021. Analizave vjetore te Departamentit te Interpretimit		
Konkluzione	<i>Institucioni nuk disponon një udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metopdave innovative të mësimdhënies. Institucioni ka hartuar gjatë periudhës së pandemisë vetëm një udhëzues institucional mbi përdorimin sa më efikas të sistemit Microsoft Teams. GVJ vlerëson se një manual i tillë mund të mos jetë një domosdoshmëri për vetë specifikat e zhvillimit të mësimdhënies të personalizuar/ individualizuar tek Universiteti I Arteve. Universiteti i Arteve në të gjitha aktet rregullatore të hartuara prej tij në parim përcakton pjesëmarrjen e përfaqësuesve të studentëve të zgjedhur nga vetë ata në të gjitha strukturat drejtuese. Institucioni promovon shembuj të praktikave të mira dhe nxit personelin akademik në përmirësim të mëtejshëm të mësimdhënies. Mungojnë evidenca organizimi fokus grupe apo procesverbale mbledhjeje departamenti me pjesemarrje të përfaqësuesve të studentëve Standardi përmbushet kryesisht</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.2


Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Institucioni nuk ka një Njësi të Përhershme Sigurimi Cilësie por strukturat përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë janë Njësia Bazë, Njësia kryesore dhe Komisioni Ad Hoc për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Organizimi dhe funksionet e këtyre strukturave janë të parashikuara në Statutin e UART dhe në rregulloret e përkatëse. UART gjithashtu nuk ka sjellë evidencë për ekzistencën e komisioneve të përhershme siç është Komisioni i Përhershëm për Garatimin e Standardeve dhe Cilësisë. Komisioni Ad Hoc për sigurimin e cilësisë shqyrton aktet rregullatore të funksionimit të institucionit në tërësi, punon për arritjen e standardeve dhe cilësisë, vlerëson rezultatet e veprimtarive mësimore, mban kontakte dhe pasuron databazën e të diplomuarve.</p> <p>Komisioni Ad Hoc për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë është ngritur me urdhër rektori Nr 15.1 dt. 10.03.2022, (DVV. Ev. Nr Urdhëri i Rektorit për krijimin e Komisionit Ad Hoc të NJSBC dhe VSA Nr.24, dt. 07.10.2021 mbi Miratimi i Rregullores të NJSBC.pdf.</p> <p>Anëtarë të komisionit janë 7 ndër të cilët 2 zv rektorët, përgjegjës të departamenteve, përfaqësues nga sekretaria mësimore. Komisioni është parashikuar të kryejë detyrën deri në plotësimin e strukturës së përhershme të njësisë së sigurimit të cilësisë. (Konstatime të GVJ gjatë vizitës në institucion)</p> <p>Sigurimi i Cilësisë është në fokus të disa dokumenteve rregullatore të UART të tilla si</p> <p>Statuti I UART, http://uart.edu.al/media/Statuti_uart_202J.PDF Kreu X, Sigurimi i cilesise Plani I Zhvillimit Strategjik, Kreu 5, Sigurimi i Cilesise, -Rregullores Mesimore te Ciklit te Dyte Master Kreu IX, Vleresimi i cilesise. Neni 37 (rishikimi periodik i programeve te studimit dhe rregulloreve respektive ne bashkepunim me NJSBC)</p> <p>DVV. Evid të vëna në dispozicion nga GVB</p> <p>Evid. VI.2.1.1 Rregullore e Komisionit ad hoc te Sigurimit te Brendshem te Cilesise</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë në institucion është i ngritur në formën e një Komisioni të Përkohshëm me në përbërjen e tij, 2 zv. rektorët, përgjegjës të njësive bazë, anëtarë të stafit akademik dhe studentë. Organizimi dhe funksionet e kësaj strukturë është e parashikuar në Statutin e UART dhe në rregulloret e përkatëse të kësaj njësie. Ndërkohë nga ana e anëtarë të GVB pohohet se sigurimi i cilësisë në institucion mundësohet përmes bashkërendimit të punës midis njësive bazë, sektorit mësimor kurrikulave dhe të informimit dhe Komisionit Ad Hoc për Sigurimin e Cilësisë. Në RVB theksohet se një vëmendje e</p>

	<p>vecantë i jepet dhe opinioneve të shprehura nga pedagogët e ftuar në lidhje me vjeljen e rekomandimeve të tyre për aspekte që kanë të bëjnë me përmirësimin e cilësisë së programeve. Por ne RVB nuk jepet evidencë në lidhje me procedurat që ndiqen për marrjen e mendimit të pedagogëve të ftuar apo të ekspertëve nga tregu i punës. Departamenti harton dokumentin e analizës mësimore të departamentit, më pas e përcjell atë në fakultet dhe analiza mësimore e fakultetit përcillet më tej në rektorat. Gjithsesi në këtë metodologji vlerësimi të aktivitetit mësimor dhe artistik të departamentit vlerësimi i cilësisë së programit dhe procedurat e parashikuara për vlerësimin e kësaj të fundit dalin të paqarta dhe të vagullta dhe ngelen vetëm si pjesë e rubrikave të vlerësimit në anketën për studentët dhe në anketën për stafin.</p> <p>Nga ana e GVB argumentohet që metodologjikisht, në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilesise, NJSBC ndërton punën në mënyre transversale që nga Njësiti Bazë deri ne Rektorat, me me mbështetjen e Sektorit mesimor, te Kurrikulave dhe Informimit te studenteve, duke u koordinuar me sekretaritë mësimore të secilit fakultet.</p> <p>Evidencat e sjella</p> <p>Evid. VI.2.2.1 Rregullore e Komisionit ad hoc te Sigurimit te Brendshem te Cilesise</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni përdor një paketë me instrumente të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta për sigurimin e cilësisë duke përfshirë këtu raportet e njësive bazë, analizat vjetore të enjësive bazë, anketat me studentët dhe me stafin akademik etj. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë dhe të akreditimit sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara nga manualët e ASCAL dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. UART i është nënshtruar akreditimit institucional dhe është vlerësuar me një kohëzgjatje 6 vite, vlerësimi maksimal për akreditimin institucional.</p> <p>Gjithsesi në RVB mungojnë evidenca të vlerësimeve analitike dhe krahasuese që mund të kryhen nga institucioni në afate kohore të ndërmjetme krahas periodicitetit që i imponohet institucionit nga procedurat e akreditimit institucional apo periodik të programeve.</p> <p>DVV VI.2.3.1 Model pyetesori te plotesuar nga studente VI.2.3.2 Analize vjetore e FM dhe/ose DI</p>
	<p>Mungojnë evidenca vlerësime analitike dhe krahasuese</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në</p>	<p>Aktet rregullatore institucionale të UART siç janë Rregullorja për Funksionimin e Fakultetit dhe DVV Evid. Rregullore Mësimore e</p>


<p>mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Ciklit të dytë të Studimit dhe Evid.Rregullore e programit të Studimit Master në Trombon dhe Mësuesi kanë të parashikuar praktikën që ndiqet për ndryshime dhe përmirësime të programeve të studimit në funksion të rritjes së cilësisë. Gjithsesi në evidencat e vëna në dispozicion në kuadër të VJ nuk është përfshirë një praktikë e qartë ku evidentohet procedura e marrjes në konsideratë të mendimeve të aktorëve të jashtëm në lidhje me cilësinë e programit. Një tregues i matshëm i cilësisë së programit janë studentët e diplomuar të UART dhe të angazhuar në institucionet më prestigjioze në fushën e artit jashtë vendit. Ashtu sikundër është argumentuar edhe nga anëtarët e GVB koncepti i treguesve cilesore në nje institucion të arsimit te lartë në Arte, është i ndryshëm me rezultate apo tregues cilësore. Si i tille, promovimi nxites për arritje me te mira ne programin e studimit lidhet edhe me aspekte te origjinalitetit, kreativitetit, bagazhit kulturor e shpirtëror të studenteve te programit te studimit Master i Arteve ne "Trombe dhe Mesuesi</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni nuk ka një Njësi të Përhershme Sigurimi Cilësie por strukturat përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë janë Njësia Bazë, Njësia kryesore dhe Komisioni Ad Hoc për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Organizimi dhe funksionet e këtyre strukturave janë të parashikuara në Statutin e UART dhe në rregulloret e përkatëse. UART gjithashtu nuk ka sjellë evidencë për ekzistencën e komisioneve të përhershme sic është Komisioni i Përhershëm për Garatimin e Standardeve dhe Cilësisë. Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë në institucion është i ngritur në formën e një komisioni të përkohshëm me në përbërjen e tij përgjegjës të njësive bazë, anëtarë të stafit akademik dhe studentë. Organizimi dhe funksionet e këtyre strukturave janë të parashikuara në Statutin e UART dhe në rregulloret e përkatëse të kësaj njësie. Institucioni përdor një paketë me instrumente të drejtëpërdrejta dhe të tërthorta për sigurimin e cilësisë duke përfshirë këtu raportet e njësive bazë, analizat vjetore të njësive bazë, anketat me studentët dhe me stafin akademik etj. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë. Në evidencat e vëna në dispozicion në kuadër të VJ nuk është përfshirë një praktikë e qartë ku evidentohet procedura e marrjes në konsideratë të mendimeve të aktorëve të jashtëm në lidhje me cilësinë e programit. Standardi përmbushet kryesisht</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

Standardi VL3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Institucioni përdor mekanizma të drejtëpërdrejtë si raportet dhe analizat e punës mësimore artistike të njësive bazë dhe të fakultetit, dhe mekanizma të tërthortë si pyetësoret me studentët dhe stafin për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë. Megjithatë në dokumentet e vëna në dispozicion dhe në përgjigjet e dhëna nga GVB , dhe strukturat drejtuese të UART gjatë vizitës së GVJ në institucion nuk mund të gjurmohet asnjë dokument apo procedurë e detajuar ku evidentohen arritjet dhe dobësitë, motivimi i praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe plani i masave për përmirësim.</p> <p>Analiza vjetore, merr ne konsiderate te gjitha arritjet dhe problematikat e hasura gjate vitit akademik. Keto diskutohen ne mbledhjet e Njesise Baze DI dhe ne fund materializohen ne formen e nje dokumenti qe i percillet dekanit te FM e me tej Rektoratit</p> <p>Evidencat DVV. Evid. Nr. Pyetësori për studentët nga Sektori mësimor, Ev. Nr. Pyetësori i Stafit Akademik Evid. Nr. Raport Vjetor i Punës artistike, mësimore-shkencore Nr. Raport Vjetor UART Evidence: Analiza vjetore DI janë relativisht dokumente reference të përgjithshme, të përdorura edhe më tej në RVB mbi instrumentet e tërthortë dhe të drejtëpërdrejtë të përdorur por nuk referojnë saktësisht mënyrën si institucioni evidenton arritjet dhe dobësitë e programit të studimit, motivon praktikat dhe arritjet më të mira, dhe del me një plan masash për përmirësim. Evidencat janë hasur nga GVJ duke konsultuar DVV.</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga</p>	<p>Nga ana e institucionit si dhe nga ana e njësive bazë që ofron programin e studimit të ciklit të dytë Master në Mësuesi Trombon nuk vihet në dispozicion të GVJ një raport vlerësimi që të artikulojë rezultatet e pritshme të vlerësimit, mangësitë dhe nevojat për përmirësim, mekanizmat për motivimin e arritjeve më të mira dhe planin e masave për adresimin e mangësive të konstatuara në programin e studimit.</p> <p>Evid. Nr. Raport Vjetor i Punës artistike, mësimore-shkencore nuk referon saktësisht mënyrën si institucioni evidenton arritjet dhe dobësitë e programit të studimit, motivon praktikat dhe arritjet më të mira, dhe del me një plan masash për përmirësim. Anëtarët e GVB deklarojnë se</p>

<p>personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Në mbledhjen e mbajtur pranë Njesise Baze DI, për analizën vjetore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - merren parasysh edhe pyetësoret e hartuar për studentët dhe pedagogët - adresohet edhe vlerësimi i stafit akademik dhe përmbushja e ngarkesës mesimore dhe objektivave të lendeve specifike, - adresohen problematika të tjera të cilat lidhen me parashikimet buxhetore të Njesise Baze DI. - vlerësohet specifikisht personeli akademik <p>Gjithsesi në dokumentin e referencës të ofruar nuk artikulohej rezultatet e pritshme të vlerësimit, mangësitë dhe nevojat për përmirësim, mekanizmat për motivimin e arritjeve më të mira dhe planin e masave për adresimin e mangësive të konstatuara në programin e studimit.</p> <p>DVV.Evidence</p> <p>VI.3.2.1 model analize vjetore DI VI.3.2.2 model vlerësimi i personelit akademik</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Metodat e drejtpërdrejta të përdorura në nivel institucional ashtu edhe në nivel njësie bazë për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve përfshijnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Monitorim të procesit të mësimdhënies (nga përgjegjësi i njësisë bazë apo nga një pedagog i speciales tek një pedagog tjetër)-Kjo procedurë nuk është e formalizuar dhe as e evidentuar në asnjërin nga dokumentat e paraqitur si evidencë por iu prezantua GVJ gjatë vizitës në institucion. 2. Vlerësim nga studentët për çdo lëndë (Anketë e Studentëve) 3. Rezultatet e Studentëve në Provime(Të përpunuara nga Sekretaria mesimore në bashkëpunim me Njësinë Bazë) 4. Rezultate në detyra kursi, koncerte performance etj 5. Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës 6. Rezultate të provimeve të diplomave <p>Një tregues i cilësisë së programit janë angazhimi i Alumni në institucione të artit prestigjioze jashtë vendit dhe për këtë zyrë e Alumni ka shpërndarë formularët përkatës për tu plotësuar dhe për të gjurmuar të diplomuarit nga UART (komente gjatë vizitës së GVJ dhe takim me përfaqësues të zyrës Alumni).</p> <p>Në evidencat e sjella mbështeten observacionet dhe vëzhgimet e mësimdhënies në institucion nuk mbështetet dhe provohet me anë të evidencave suksesi I studentëve të diplomuar në provimet e licensimit, provimin e shtetit për profesionet e rregulluara etj.</p>




<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni në kuadër të përdorimit të metodave të tërthorta të vlerësimit të realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit përdor këto instrumente të tërthorta vlerësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> -anketa me studentët (DVV. Evid Pyetësori për Studentët) -anketa me pedagogët (DVV. Evidencë Pyetësori i Stafit A akademik të UART) -sondazhe me studentët e diplomuar(vizitë GVJ) -anketa me alumni në lidhje me pjesëmarrjen në konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare DVV. Evid. Fletëpalosje aktivitetesh artistike Brenda dhe jashtë vendit, konkurse kombëtare etj. <p>Bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm në fushën e artit konsiderohet dhe përfshirja në performanca artistike të përbashkëta me partnerët institucionalë e marrë kjo si një indikator i tërthortë i performancës. Periudha e marre në shqyrtim për akreditimin e programeve të studimit të DI përkon me një situatë të kënaqshme të raportit midis të diplomuarve dhe të punësuarve. Në kushtet e Shqipërisë, nga 6 diploma të punësohen në specialitetin primar 5 prej tyre, është një raport shumë i kënaqshëm</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni përdor Metodën e drejtëpërdrejtë në nivel institucioni ashtu edhe në nivel njësie bazë për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, ecurisë dhe mbarëvajtjes së programeve. Në këto metoda përfshihen - Monitorim i procesit të mësimdhënies(nga përgjegjësi i njësisë bazë apo nga një pedagog i specialës tek një pedagog tjetër)-Vlerësim nga studentët për çdo lëndë (Anketë e Studentëve),-Rezultate të Studentëve në Provime(Sekretaria mësimore në bashkëpunim me Njësinë Bazë), Rezultate të studentëve në detyra kurse, koncerte performace etj , -Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës, -Rezultate të provimeve të diplomave</i></p> <p><i>Institucioni në kuadër të përdorimit të metodave të tërthorta të vlerësimit të realizimit dhe mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit përdor këto instrumente të tërthorta vlerësimi</i></p> <ul style="list-style-type: none"> -anketa me studentët -anketa me pedagogët -sondazhe me studentët e diplomuar -anketa me Alumni <p><i>Nuk vihet në dispozicion të GVJ një raport vlerësimi që të artikulojë rezultatet e pritshme të vlerësimit, mangësitë dhe nevojat për përmirësim, mekanizmat për motivimin e arritjeve më të mira dhe planin e masave për adresimin e mangësive të konstatuara në programin e studimit.</i></p> <p><i>Bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm në fushën e artit konsiderohet dhe përfshirja në performanca artistike të përbashkëta me partnerët institucionalë e marrë kjo si një indikator i tërthortë i performancës.</i></p> <p><i>Standardi përmbushet kryesisht</i></p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.4


Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në politikat dhe procedurat e brendshme të garantimit cilësisë si dhe në dokumentet rregullatorë të UART të evidentuara në DVV. Evid. Statuti UART neni 35, dhe Evid. e veprimtarisë së NJSBC parashikohet qartë përfshirja e aktorëve të brendshëm si stafi akademik dhe përgjegjësit e njërive si dhe përfshirja studentore por nuk garantohet asgjekundi përfshirja e aktorëve të jashtëm, bashkëpunëtorëve të jashtëm, apo përfaqësuesve nga tregu i punës. DVV Evidenca të munguara
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Në dokumentat rregullatore për cilësinë e brendshme të institucionit janë të përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët dhe studentët. Nuk del e përcaktuar qartë përfshirja e bashkëpunëtorëve të jashtëm. Nga ana tjetër për nga struktura komplekse dhe me pak burime njerëzore e Zyrës Mësimore dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës ngelen të paqarta përgjegjësitë dhe detyrat që ka secili anëtar. DVV VI.4.2.1 Rregullore e NJSBC
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Në dokumentat rregullatore për cilësinë e brendshme të institucionit janë të përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësinë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit. DVV Evidenca të munguara
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi	Përmes Evidencës Emailë të komunikimit me aktorë të tjerë për përgatitjen e RVB si dhe ashtu sikundër është përshkruar tek metodologjia e hartimit të RVB në hyrje të këtij raporti parashikohet përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në procese ciklike të vlerësimit bazuar mbi parimet e parashikuara në Kodin e Etikës së Institucionit si dhe duke



Prongolli

<p>apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>respektuar integritetin akademik dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie ndaj stafit apo studentëve.</p> <p>Urdhri i lëshuar nga dekan i Fakultetit të Muzikes për ngritjen e grupit të punës për realizimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, parashikon përfshirjen e përgjegjësit të Njësise Baze DI, kryetarëve të grupeve mësimore, përfaqësuesit të administratës dhe të një student. UART nuk ka asnjë rast të ngritur ose të regjistruar të diskriminimit apo pabarazise se ushtruar ndaj personelit ose studenteve.</p> <p>DVV VI.I.4.4.1. Urdhër i dekanit për ngritjen e grupit të vlerësimit</p>				
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Përfshirja e ekspertëve bashkëpunëtorëve të jashtëm si pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë dëshmohe vetëm me anë të sjelljes së evidencës së organizimit të masterklaseve me praninë e ekspertëve të jashtëm. Nga ana e GVV nuk prezantohen evidenca të tjera që dëshmojnë përfshirjen e aktorëve të jashtëm në fokus grupe mbledhjeje njësie bazë apo kryesore apo diskutime për përmirësimin e cilësisë së programit.</p> <p>Nëpërmjet zhvillimit të masterklaseve me pedagogë të huaj nga institucione të arsimit të lartë homologe nga Evropa apo më gjere, sigurohet ekspertiza e vlefshme për programin e studimit Master i Arteve ne "Trombon dhe Mesuesi" pasi është rasti të krahasohet metodologjia dhe propozimet e sugjerimet e ekspertit te huaj.</p> <table border="1" data-bbox="603 1178 1410 1272"> <tr> <td data-bbox="603 1178 730 1227">VI.4.5.1</td> <td data-bbox="738 1178 1410 1227"><i>Koncerte me artiste e diril{jentii tii huai(foto)</i></td> </tr> <tr> <td data-bbox="603 1229 730 1272">VI.4.5.2</td> <td data-bbox="738 1229 1410 1272"><i><u>Shkembimet Erasmus foto</u></i></td> </tr> </table>	VI.4.5.1	<i>Koncerte me artiste e diril{jentii tii huai(foto)</i>	VI.4.5.2	<i><u>Shkembimet Erasmus foto</u></i>
VI.4.5.1	<i>Koncerte me artiste e diril{jentii tii huai(foto)</i>				
VI.4.5.2	<i><u>Shkembimet Erasmus foto</u></i>				
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në politikat dhe procedurat e brendshme të garantimit cilësisë si dhe në dokumentet rregullatorë të UART parashikohet qartë përfshirja e aktorëve të brendshëm si stafi akademik dhe përgjegjësit e njësive bazë si dhe përfshirja studentore por nuk garantohe asgjekundi përfshirja e aktorëve të jashtëm, bashkëpunëtorëve të jashtëm, apo përfaqësuesve nga tregu i punës. Në dokumentat rregullatorë për cilësinë e brendshme të institucionit janë të përcaktuar qartë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët dhe studentët por nuk del e përcaktuar qartë përfshirja e bashkëpunëtorëve të jashtëm. Nga ana tjetër për nga struktura komplekse dhe me pak burime njerëzore e Zyrës Mësimore dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës ngelen të paqarta përgjegjësitë dhe detyrat që ka secili anëtar.</i></p> <p><i>Standardi përmbushet kryesisht</i></p>				





Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>UART bën publike dhe transparente me anë të Zyrës së Sekretarisë Mësimore me anë të faqes Web të institucionit dhe përmes rrjeteve sociale organizimin dhe veprimtaritë në kuadër të Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit. Kjo është e parashikuar edhe në statutin e UART</p> <p>Gjithashtu parashikohet publikimi i nje sere veprimtarish si: vendime te Senatit Akademik, te Bordit te Administrimit si dhe cdo veprimtari tjeter te njesive te tjera.</p> <p>DVV. Evid. Nr Statuti UART Neni 76 Evid. Nr. Faqja Web eUART http://www.uart.edu.al/media/Statuti_uart_2021.F'DFNeni_76</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të jashtme ashtu sikundër janë akreditimi institucional. Rezultatet e vlerësimeve të jashtme vihen në dispozicion nga zyra e sekretarisë mësimore të gjithë personave të interesuar si dhe publikohen në faqen zyrtare te UART duke respektuar lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p>DVV Evid. Nr. Faqja Web UART</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Institucioni i arsimit të lartë nuk ka vënë në dispozicion një plan masash që adreson dhe synon përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara. Asnjëra nga evidencat e sjella, as nuk përmbajnë plane masash dhe nuk përbëjnë evidenca të nevojshme për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri.</p> <p>DVV. Evid të munguara , të pafereuara</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në</p>	<p>Në DVV po ashtu edhe gjatë vizitës në institucion nuk është vënë në dispozicion asnjë evidencë e cila dëshmon për mënyrën si institucioni ndërhyr në përmirësimin e cilësisë në rastet kur konstatohen problematika</p>

<p>kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>në mbarëvatjen e programit të studimit qoftë gjatë një vlerësimi të brendshëm apo gjatë një vlerësimi të jashtëm të cilësisë. Nga konsultimi i dosjes DVV evidencat e sjella provojne në mënyrë të pjesshme mënyrën si ndërhyhet në rishikimin e syllabuseve në kuadër të një akreditimi programi. DVV. Evid të munguara , të pareferuara</p>		
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka bërë takime të vazhdueshme me studentët dhe stafin akademik për ti ndërgjegjësuar ato për rëndësinë e procesit të akreditimit të programit të studimit. Gjatë vizitës në institucion këto takime u quajtëm fokus grupe por nuk u shoqeruan me evidencat përkatëse. DVV. Evid të munguara , të pareferuara</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UART bën publike dhe transparente me anë të zyrës së Sekretarisë Mësimore me anë të faqes web të institucionit dhe përmes rrjeteve sociale organizimin dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të jashtme ashtu sikundër janë akreditimi institucional në faqen e institucionit. Institucioni I arsimit të lartë nuk ka vënë në dispozicion një plan masash që adreson dhe synon përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara. Gjatë vizitës në institucion nuk është vënë në dispozicion asnjë evidencë e cila dëshmon për mënyrën si institucioni ndërhyt në përmirësimin e cilësisë në rastet kur konstatohen problematika në mbarëvatjen e programit të studimit qoftë gjatë një vlerësimi të brendshëm apo gjatë një vlerësimi të jashtëm të cilësisë.</i> <i>Standardi përmbushet kryesisht</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		<p>X</p>	

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Arteve në “Trombon dhe Mësuesi” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Arteve”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi i studimit është i vetmi i llojit të tij që ofron formim universitar dhe njohuri dhe aftësim të avancuar artistik dhe pedagogjik në fushën e ngushtë të studimit Trombon dhe Mësuesi.
2. Të diplomuarit në këtë program studimi kanë kontribute me vlerë në orkestrën simfonike dhe të operës brenda dhe jashtë vendit. Alumni të këtij program janë artistë të njohur në Shqipëri dhe në mbarë botën. Mundësia e punësimit është më e madhe. Të diplomuarit me titull “Trombon dhe Mësuesi”, krahas punësimit artistik kanë të drejtë punësimi edhe në institucione të arsimit parauniversitar.
3. Fakulteti i Muzikës dëshmon të jetë i përfshirë aktivisht në projekte ndërkombëtare që ndihmojnë në shkëmbimin e përvojave, dhe nxisin mobilitetin për personelin akademik dhe studentët.
4. Fakulteti i Muzikës ka infrastrukturë dhe hapësira të mjaftueshme dhe është i pajisur me instrumente që ndihmojnë në organizimin e programit të studimit.
5. Fakulteti i Muzikës ka bibliotekë të pasur audio dhe literaturë e shkruar, si dhe pajisje PC me softëare të instaluar për dëgjimin dhe performimin e veprave muzikore, si dhe iu mundëson studentëve akses falas në disa katalogje online
6. Veprimtaritë formuese të këtij programi, ngërthejnë edhe lëndët metodologjike, ku krahas kreativitetit muzikor zhvillohet edhe aspekti metodik-pedagogjik.
7. Mundësi për realizimin e praktikave profesionale, ato artistike dhe mësimore.

Pika të dobëta

1. Studentët nuk përfshihen aktivisht në vendimmarrjet e organeve kolegjiale. **(Standardi V.5.Kriteri 3).**
2. Struktura e Sekretarisë Mësimore, Kurrikulës, Informimit të Studentëve dhe Gjurmimit të Alumni i ka jo qartë të përcaktuara sektorët në përbërje të saj dhe vuan nga një mungesë në burime njerëzore. **(Standardi V.6. Kriteri 1).**
3. Sigurimi i brendshëm i cilësisë bazohet në punën e një komisioni ad hoc për sigurimin e cilësisë, dhe nuk mbështetet mbi një njësi, strukturë permanente. **(Standardi VI.2. Kriteri 1).**
4. Në grupin e punës për hartimin e përmbajtjes së programit si dhe në grupet e punës për vlerësimin e vazhduar të cilësisë së brendshme të programit të studimit nuk përfshihen aktivisht ekspertë të jashtëm nga tregu punës ose anëtarë nga institucionet partnere, apo dhe studentët. **(Standardi VI.1 Kriteri 3 dhe Standardi VI.2 Kriteri 4).**
5. Institucioni nuk ka dalë me plan masash konkrete dhe detyra dhe përgjegjësi konkrete për njësitë e përfshira në ndjekjen e mbarëvajtjes së programit të studimit. **(Standardi VI.3, Kriteri 2 dhe Standardi VI.5 Kriteri 4).**

Rekomandime

1. Në grupin e punës për hartimin e përmbajtjes së programit si dhe në grupet e punës për vlerësimin e vazhduar të cilësisë së brendshme të programit të studimit duhet të ketë anëtarë ekspertë të jashtëm nga tregu punës ose anëtarë nga institucionet partnere.
2. Të ngrihet një Njësi e Posacme për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. Njësi e përhershme pasi sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë nuk mundësohet përmes komisioneve të përkohshme dhe të ngrihen në përputhje me parashikimet e ligjit për arsimin e lartë 80.2015 2 komisione të përhershme,
3. Të sigurohet një përfshirje më e gjerë aktive studentore ne organet kolegjiale vendimmarrëse të UART
4. Institucioni të dalë me plan masash konkrete dhe detyra dhe përgjegjësi konkrete për njësitë e përfshira në ndjekjen e mbarëvajtjes së programit të studimit.
5. Të bëhet një ndarje e qartë e detyrave dhe përgjegjësive të secilit sektor të Strukturës së Sekretarisë Mësimore, Kurrikulës, Informimit Studentor dhe ndjekjes së Alumni dhe të shtohen burimet njerëzore.
6. Në arsimin parauniversitar nga ana strukturore të ketë një rikonceptim të strukturës së shkollave të profilit artistik në arsimin parauniversitar në mënyrë që të rritet numri i maturantëve të interesuar për të ndjekur disa programe studimi jo shumë preferenciale dhe të cilat vuajnë nga një numër i ulët studentësh.




Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Arts Program in "Trombone and Teacher Education" provided by the Higher Education Institution "University of Arts", Faculty of Music

Strengths and affirmations

1. The study program is the only one of its kind that offers university training and advanced artistic and pedagogical knowledge and skills in the field of teacher education for trombone performers
2. The graduates and alumni of this study program have valuable contributions to the symphony and opera orchestra in Albania and abroad and are well-known artists in Albania and around the world. The employment opportunities for study program graduates are high. Graduates with the diploma in "Trombone and Teacher Education", in addition to the artistic employment opportunities have the right to employment in pre-university education institutions.
3. The Faculty of Music proves to be actively involved in international projects that help exchange experiences, and promote academic staff and student mobility.
4. The Faculty of Music has sufficient infrastructure and facilities and is equipped with the needed instruments that help organize the study program.
5. The Faculty of Music has a rich audio library and literature resources as well as PC equipment with installed software for listening and performing musical works, additionally it provides students with free access to several online catalogs
6. The formative activities of this program include the methodology-oriented courses, where, in addition to musical creativity, the methodological-pedagogical aspect and competences are also developed
7. There are many opportunities for professional, artistic and educational internships and professional praxis.

Weaknesses

1. Students are not actively involved in the decision-making of collegial bodies (**Standard V.5, Criterion 3**).
2. The structure/unit of Teaching Secretary, Curriculum, Student Information and Alumni Tracking Office has not clearly defined sectors in its composition and suffers from a lack of human resources. (**Standard V.6, Criterion 1**).
3. Internal quality assurance in the institution is based on the work of an ad hoc commission for quality assurance, and does not rely on a permanent unit /structure. (**Standard VI.2, Criterion 1**).
4. In the working groups for designing the content of the program as well as in the working groups for the continuous evaluation of the internal quality of the study program there have not been included external experts, members from the labor market or members from partner institutions. (**Standard VI.1, Criterion 3 and Standard VI.2, Criterion 4**).
5. The institution has not come up with an action plan consisting of concrete measurable activities, duties and responsibilities for the units involved in following up of the progress and internal quality assurance of the study program. (**Standardi VI.3, Kriteri 2 dhe Standardi VI.5 Kriteri 4**).



Recommendations

1. *There should be included external experts, members from the labor market or members from partner institutions in the working groups for designing the content of the program as well as in the working groups for the continuous evaluation of the internal quality of the study program.*
2. *A Special permanent Unit for Internal Quality Assurance as the Law on Higher Education 80/2015 foresees should be established. Quality assurance in higher education can not be a matter of temporary/ad hoc commissions. In accordance with the provisions of the law on higher education 80.2015 2 permanent commissions should be established*
3. *The institution should make possible and ensure a wider active involvement of students in the collegial decision-making bodies of UART.*
4. *The institution should come up with an action plan consisting of concrete measurable activities, duties and responsibilities for the units involved in following up of the progress and internal quality assurance of the study program.*
5. *There should be made a clear division of duties and responsibilities of each sector of the Structure of the Teaching Secretariat, Curriculum, Student Information and Alumni tracking accompanied with an increase in staffing and human resources.*
6. *There should be a structural reconceptualization of the artistic profile schools in pre-university education in order to increase the number of graduates interested in following some not very preferential study programs which suffer from a low number of students*

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përmbushjen e plotësisht	Përmbushjen kryesisht	Përmbushjen pjesërisht	Përmbushjen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT		X		
VLERËSIMI TËRËSOR				X